

KOMENTAR BIBLIK FALAS

TI MUND TA KUPTOSH BIBLËN!

Shpresë në Kohë të Vështira — Perdja e Fundit: Zbulesa

Nga Dr. Bob Utley, Profesori i Hermeneutikës (i dalë në pension)
(Interpretimi Biblik)

PËRMBAJTJE

Shkurtime të Përdorura në Këtë Komentar

Një Fjalë nga Autori: Si Mund t'ju Ndhim një Ky Komentar?

Një Udhëzues për një Lexim të Mirë Biblik: Një Kërkim Personal për të Vërtetën e Verifikueshme

Komentari:

Artikull Thelbësor Hyrës

Hyrje në Profecinë e Dhjatës së Vjetër

Hyrja në Zbulesë

Zbulesa 1
Zbulesa 2 & 3
Zbulesa 4 & 5
Zbulesa 6 & 7
Zbulesa 8 & 9
Zbulesa 10 & 11

Zbulesa 12-14
Zbulesa 15 & 16
Zbulesa 17 & 18
Zbulesa 19
Zbulesa 20
Zbulesa 21 & 22

Shtojca:

Shpjegime të Shkurtra të Strukturës Gramatikore

Kriticizëm Tekstual

Fjalor

Pohime Doktrinale

Figurë mbi Pikëpmajet Milenialiste: Faqe 1, 2, 3

Poema mbi Zbulesën

Copyright © 2012 [Bible Lessons International](http://www.freebiblecommentary.org). Të gjitha të drejtat e rezervuara. Çdo kopje apo shpërndarje e këtij materiali duhet të jepet pa asnjë kosto. Kopjet apo shpërndarjet e këtij materiali duhet t'i atribuohen Dr. Bob Utley dhe të përfshijnë një referencë tek www.freebiblecommentary.org

Teksti kryesor biblik i përdorur në këtë komentar është: New American Standard Bible (Botim, 1995) Copyright © 1960, 1962, 1963, 1968, 1971, 1972, 1973, 1975, 1977, 1995 nga Fondacioni Lockman, P. O. Box 2279, La Habra, CA 90632-2279.

SHKURTIME TË PËRDORURA NË KËTË KOMENTAR

AB	Anchor Bible Commentaries [Komentarë të Biblës Ankor], botim i William Foxwell Albright [Uilliam Foksuell Ollbraijt] dhe David Noel Freedman [Dejvid Noel Fridman]
ABD	Anchor Bible Dictionary [Fjalori i Biblës Ankor] (6 volume.), botim i David Noel Freedman [Dejvid Noel Fridman]
ABPS	American Baptist Publication Society [Shoqëria Amerikane Baptiste e Botimit]
AKOT	Analytical Key to the Old Testament [Çelësi Analitik për tek Dhjata e Vjetër] nga John Joseph Owens [Xhon Xhozef Ouens]
ANE	Ancient Near East [Lindja e Afërme Antike]
ANET	Ancient Near Eastern Texts [Tekste të Lindjes së Afërme Antike], James B. Pritchard [Xhejms Bi Pritçard]
ASV	American Standard Version [Versioni Standart Amerikan]
AV	Authorized Version [Versioni i Autorizuar]
BAGD	Një Leksikon Greqisht-Anglisht i Dhjatës së Re dhe Literaturës së Hershme të Krishterë, Walter Bauer [Uollter Bauer], botimi i dytë nga F. W. Gingrich [Ef Dabëllju Gringriç] dhe Fredrick Danker [Fredrik Denkër]
BDB	Një Leksikon i Hebraishtes dhe Anglishtes i Dhjatës së Vjetër nga F. Brown [Ef Braun] , S. R. Driver [Es Ar Drajvër] dhe C. A. Briggs [Si Ej Brigs]
BHS	Biblia Hebraica Stuttgartensia, GBS, 1997
DSS	Dead Sea Scrolls [Dorëshkrime të Detit të Vdekur]
EJ	Encyclopedia Judaica [Enciklopedia Judaike]
IDB	The Interpreter's Dictionary of the Bible [Fjalori i Interpretuesit të Biblës] (4 volume), botuar nga George A. Buttrick [Xhorxh Ej Batrik]
ISBE	International Standard Bible Encyclopedia [Enciklopedia Ndërkombëtare Standarte Biblike] (5 volume), botuar nga James Orr [Xhejms Orr]
JB	Jerusalem Bible [Bibla Jeruzalem]
JPSOA	Shkrimet e Shenjta sipas Tekstit Mazoretik: Një Përkthim i Ri (The Jewish Publication Society of America [Shoqëria Hebraike e Publikimit e Amerikës])
KB	Leksikoni Hebraik dhe Aramaik i Dhjatës së Vjetër nga Ludwig Koehler [Ludvig Koehler] dhe Walter Baumgartner [Uollter Baumgartner]
KJV	King James Version [Versioni i Mbretit Xhejms]
LAM	Bibla e Shenjtë nga Dorëshkrimet Antike Lindore (the Peshitta [Peshita]) nga George M. Lamsa [Xhorxh Em Lamsa]

LXX	Septuaginti (Greqisht-Anglisht) nga Zondervan, 1970
MOF	Një Përkthim i Ri i Biblës nga James Moffatt [Xhejms Mofat]
MT	Masoretic Hebrew Text [Tekst Hebraik Mazoretik]
NAB	New American Bible Text [Teksti i Biblës së Re Amerikane]
NASB	New American Standard Bible [Bibla sipas Standartit të Ri Amerikan]
NEB	New English Bible [Bibla e Re Angleze]
NET	NET Bible: New English Translation, Second Beta Edition [Bibla NET: Përkthimi i Ri Anglez, Botimi i Dytë Beta]
NIDNTT	New International Dictionary of New Testament Theology [Fjalori i Ri Ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Re] (4 volume), nga Colin Brown [Kolin Braun]
NIDOTTE	New International Dictionary of Old Testament Theology and Exegesis [Fjalori i Ri Ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Vjetër dhe Eksegjezës] (5 volume), botuar nga Willem VanGemeren [Uillëm Van Gemeren]
NIV	New International Version [Versioni i Ri Ndërkombëtar]
NJB	New Jerusalem Bible [Bibla e Re e Jeruzalemit]
NKJV	New King James Version [Versioni i Ri i Mbretit Xhejms]
NRSV	New Revised Standard Bible [Bibla e Re sipas Versionit të Rishikuar]
OTPG	Old Testament Passing Guide [Udhëzuesi i Kalimit të Dhjatës së Vjetër] nga Todd S. Beall [Tod Es Biëll], William A. Banks [Uilliam Ej Benks] dhe Colin Smith [Kolin Smith]
REB	Revised English Bible [Bibla Angleze e Rishikuar]
RSV	Revised Standard Version [Versioni Standart i Rishikuar]
SEPT	Septuaginti (Greqisht-Anglisht) nga Zondervan, 1970
TCNT	The Twentieth Century New Testament [Dhjata e Re e Shekullit të Njëzetë]
TEV	Today's English Version [Versioni Anglez i Sotshëm] nga United Bible Societies [Shoqëritë Biblike të Bashkuara]
UBS4	United Bible Societies' The Greek New Testament [Dhjata e Re Greke e Shoqërive Biblike të bashkuara, versioni i katërt i rishikuar]
YLT	Young's Literal Translation of the Holy Bible [Përkthimi fjalë-për-fjalë i Young i Biblës së Shenjtë] nga Robert Young [Robert Jang]
ZPEB	Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible [Enciklopedia Piktoriale Zondervan e Biblës] (5 volume), botimi i Merrill C. Tenney [Merril Si Tenej]

Një Fjalë Nga Autori: Si Mund t'ju Ndhimojë Ky Komentar?

Interpretimi biblik është një proces racional dhe shpirtëror i cili përpiqet të kuptojë një shkrimtar antik të frymëzuar në mënyrën të tillë që mesazhi nga Perëndia të mund të kuptohet dhe të zbatohet në kohën tonë.

Proçesi shpirtëror është thelbësor por i vështirë për t'u përkufizuar. Ai përfshin dorëzim tek Perëndia dhe hapje ndaj Perëndisë. Duhet të ketë një uri (1) për Të, (2) për ta njohur Atë dhe (3) për t'i shërbyer Atij. Ky proces përfshin lutjen, rrëfimin dhe gatishmërinë për të ndryshuar stilin e jetesës. Fryma është thelbësore në procesin interpretues, por arsyeja se pse të krishterët e sinqertë dhe të perëndishëm e kuptojnë Biblën në mënyra të ndryshme është një mister.

Proçesi racional është më i lehtë për t'u përshkruar. Ne duhet të jemi të qëndrueshëm dhe të drejtë ndaj tekstit dhe të mos ndikohemi nga paragjykimet tona personale apo denominacionale. Ne të gjithë kushtëzohemi historikisht. Asnjë nga ne nuk është interpretues objektiv dhe neutral. Ky komentar ofron një proces racional të kujdesshëm i cili përmban tre parime interpretimi të strukturuar për të na ndihmuar të tejkalojmë paragjykimet tona.

Parimi i Parë

Parimi i parë është të vëresh rrethanat historike në të cilat është shkruar libri biblik dhe situatën e veçantë historike për autorësinë e tij. Autori origjinal kishte një qëllim, një mesazh për të komunikuar. Teksti nuk mund të nënkuptojë për ne diçka që nuk ka pasur kurrë për qëllim që të nënkuptonte për autorin origjinal, antik dhe të frymëzuar. Qëllimi i tij, dhe jo nevoja jonë historike, emocionale, kulturore, personale apo denominacionale, është çelësi. Zbatimi është një partner integral për interpretimin, por interpretimi i saktë gjithmonë duhet të paraprijë zbatimin. Duhet të përsëritet e ripërsëritet që çdo tekst biblik ka një dhe vetëm një kuptim. Ky kuptim është ai që autori origjinal biblik kishte për qëllim përmes drejtimit të Frymës për të komunikuar në kohën e tij. Ky kuptim i vetëm mund të ketë shumë zbatime të ndryshme në kultura dhe situata të ndryshme. Këto zbatime duhet të lidhen me të vërtetën qëndrore të autorit origjinal. Për këtë arsye, ky komentar udhëzues studimi është projektuar që të japë një hyrje tek secili libër i Biblës.

Parimi i Dytë

Parimi i dytë është të identifikosh njësitë letrare. Çdo libër biblik është një dokument i unifikuar. Interpretuesit nuk kanë asnjë të drejtë të izolojnë një aspekt të së vërtetës duke përjashtuar aspektet e tjera. Prandaj ne duhet të synojmë të kuptojmë qëllimin e të gjithë librit biblik përpara se të interpretojmë njësitë individuale letrare. Pjesët individuale – kapitujt, paragrafët apo vargjet – nuk mund të nënkuptojnë diçka që e gjithë njësia nuk e nënkupton. Interpretimi duhet të lëvizë nga një përjasje deduktive e së gjithës në një përjasje induktive të pjesëve. Prandaj, ky komentar udhëzues studimi është dizenuar për të ndihmuar studentin të analizojë strukturën e secilës njësi letrare sipas paragrafëve. Ndarjet në paragrafë dhe kapituj nuk janë të frymëzuara, por ato na ndihmojnë për të identifikuar njësitë e mendimeve.

Të interpretosh në nivel paragrafi – jo nivel fjalie, pjese fjalie, fraze apo fjale – është çelësi për të ndjekur kuptimin që ka pasur për qëllim autori biblik. Paragrafët janë të bazuar mbi tema të unifikuar, të quajtura shpesh tematika apo fjali tematike. Çdo fjalë, frazë, pjesë fjalie apo fjali në paragraf lidhet në një mënyrë me këtë tematikë të unifikuar. Ato e limitojnë, zgjerojnë, shpjegojnë dhe / ose vënë në pyetje atë. Një çelës i vërtetë për interpretim të saktë është të ndjekësh mendimin e autorit origjinal paragraf-pas-paragrafi përmes njësive individuale letrare të cilat përbëjnë librin biblik. Ky komentar udhëzues studimi është dizenuar për të ndihmuar studentin që ta bëjë këtë duke krahasuar përkthime moderne në anglisht. Këto përkthime janë zgjedhur sepse ato zbatojnë teori të ndryshme përkthimi:

1. Teksti greqisht i United Bible Society [Shoqëria Biblike e Bashkuar] është botimi i katërt i rishikuar (UBS4). Ky tekst është ndarë në paragrafe nga studiues modernë të tekstit.
2. New King James Version (NKJV) [Versioni i Ri i Mbretit Xhejms] është një përkthim i drejtëpërdrejtë fjalë-për-fjalë i bazuar në traditën greke të dorëshkrimeve të njohur si Textus Receptus. Ndarjet e tij në paragrafe janë më të gjata se sa në përkthime të tjera. Këto njësi më të gjata ndihmojnë studentin të shohë temat e unifikuara.
3. New Revised Standard Version (NRSV) [Bibla sipas Versionit të Ri të Rishikuar] është një përkthim i modifikuar fjalë-për-fjalë. Ai formon një pikë të mesme midis dy versioneve të mëposhtme moderne. Ndarjet e tij në paragrafe janë mjaft ndihmëse në identifikimin e subjekteve.
4. Today's English Version (TEV) [Versioni Anglisht i Sotshëm] është një përkthim dinamik ekuivalent i publikuar nga Shoqëria Biblike e Bashkuar. Ai përpiket ta përkthejë Biblën në një mënyrë të tillë që lexuesi apo folësi modern i anglishtes të mund ta kuptojë tekstin grek. Shpesh, sidomos tek Ungjijtë, ai ndan paragrafët sipas folësit dhe jo sipas temës, në të njëjtën mënyrë sikurse NIV. Për qëllime të interpretuesit, kjo nuk është ndihmëse. Është interesante të vësh re se të dy versionet UBS4 dhe TEV janë publikuar nga i njëjti entitet, e megjithatë ndarja e tyre në paragrafë ndryshon.
5. Jerusalem Bible (JB) [Bibla Jeruzalem] është një përkthim ekuivalent dinamik i bazuar mbi një përkthim francez katolik. Është shumë ndihmës në krahasimin e paragrafëve nga një perspektivë europiane.
6. Teksti i printuar është botimi i vitit 1995 Updated New American Standard Bible (NASB) [Versioni i Përditësuar i Ri i Biblës Amerikane], i cili është një përkthim fjalë-për-fjalë. Komentet varg pas vargu ndjekin këtë ndarje në paragrafë.

Parimi i Tretë

Parimi i tretë është ta lexosh Biblën në përkthime të ndryshme në mënyrë që të rrokësh gamën më të gjerë të mundshme të kuptimit (fusha semantike) që fjalët apo shprehjet biblike mund të kenë. Shpesh një frazë apo fjalë në greqisht mund të kuptohet në mënyra të ndryshme. Këto përkthime të ndryshme japin këto mundësi dhe të ndihmojnë të identifikosh dhe të shpjegosh variacionet e dorëshkrimeve greke. Ato nuk ndikojnë mbi doktrinën, por na ndihmojnë që të përpiqemi t'i rikthehemi tekstit origjinal të shkruar nga autori antik i frymëzuar.

Ky komentar ofron një mënyrë të shpejtë që studenti të kontrollojë interpretimet e tij. Ai nuk ka për qëllim të jetë përcaktues, por më shumë informues dhe provokues mendimesh. Shpesh, interpretime të tjera të mundshme na ndihmojnë që të mos jemi shumë mendjengushtë, dogmatikë dhe denominacionalë. Interpretuesit kanë nevojë të kenë një gamë më të gjërë mundësish interpretimi që të mund të dallojnë se sa i paqartë mund të jetë teksti antik. Është befasuese se sa pak dakordësim ka midis të krishterëve të cilët pretendojnë se Bibla është burimi i tyre i së vërtetës.

Këto parime më kanë ndihmuar mua të tejkaloj shumë nga kushtëzimet e mia historike duke më detyruar që të përballem me tekstin antik. Shpresa ime është që ky të mund të jetë një bekim edhe për ju.

Bob Utley
27 qershor 1996

NJË UDHËZUES PËR LEXIM TË MIRË TË BIBLËS: NJË KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME

Materiali në vazhdim është një shpjegim i shkurtër i filozofisë hermeneutike të Dr. Bob Utley si dhe i procedurave të përdorura në komentaret e tij.

[Guide to Good Bible Reading Video -- 40 min.](#) [Udhëzues për Lexim të Mirë të Biblës Video – 40 minuta]

A mund ta njohim të vërtetën? Ku gjendet ajo? A mund ta verifikojmë atë nga ana logjike? A ka një autoritet përfundimtar? A ka të vërteta absolute të cilat mund të udhëzojnë jetët tona, botën tonë? A ka kuptim jeta? Pse jemi ne këtu? Ku po shkojmë ne? Këto pyetje, pyetje që të gjithë njerëzit racionalë bëjnë, e kanë munduar intelektin njerëzor që nga fillimi i kohërave (Predi. 1:13-18; 3:9-11). Mbaj mend kërkimin tim personal për një qendër integruese në jetën time. Unë u bëra besimtar në Krishtin në një moshe të re, bazuar kryesisht në dëshminë e njerëzve të mi të dashur në familjen time. Ndërsa u rrita, pyetjet për veten time dhe për botën time gjithashtu rriteshin. Klishetë e thjeshta kulturore dhe fetare nuk sillnin kuptim në eksperiencat për të cilat lexoja apo përjetoja. Ishte një kohë konfuzioni, kërkimi, dëshirimi dhe shpesh ndjesie për mungesë shprese në përballje me botën e pandjeshme dhe të vështirë në të cilën unë jetoja.

Shumë pretendonin se kishin përgjigje ndaj këtyre pyetjeve thelbësore, por pas kërkimeve dhe reflektimeve, unë arrita në përfundimin se përgjigjet e tyre bazoheshin në (1) filozofi personale, (2) mite antike, (3) përjetesa personale ose (4) projeksione psikologjike. Unë kisha nevojë për një shkallë verifikimi, disa prova, pak racionalitet mbi të cilin të bazoja pikëpamjen time për botën, qendrën time integruese, arsyen time për të jetuar.

Këto i gjeta në studimin tim të Biblës. Unë fillova të kërkoj për prova të vlefshmërisë së saj, të cilën e gjeta në (1) vlefshmërinë historike të Biblës të konfirmuar me arkeologjinë, (2) saktësinë e profecive të Dhjatës së Vjetër, (3) unitetin e mesazhit të Biblës përgjatë 1600 viteve nga prodhimi i saj dhe (4) dëshmitë personale të njerëzve, jetët e të cilëve u ndryshuan në mënyrë të përhershme nga kontakti me Biblën. Krishtërimi, si një sistem i unifikuar besimi, ka aftësinë të merret me pyetje komplekse për jetën njerëzore. Jo vetëm jepte kjo një strukturë racionale, por aspekti i përvojës së besimit biblik më solli gëzim dhe stabilitet emocional.

Unë mendoja se e kisha gjetur qendrën integruese për jetën time – Krishti, sikurse e kisha kuptuar përmes Shkrimeve. Ishte një eksperiencë e nxituar, një çlirim emocional. Megjithatë, unë ende e mbaj mend tronditjen dhe dhimbjen që ndjeva kur fillova të kuptoj se sa interpretime të ndryshme të këtij libri mbroheshin, ndonjëherë edhe brenda së njëjtave kisha apo shkollash mendimi. Të pranuarit e frymëzimit apo vlefshmërisë së Biblës nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Si t'i verifikoj apo refuzoj interpretimet e ndryshme dhe konfliktuese të shumë pasazheve të vështira në Shkrime me ato që pretendonin autoritetin dhe vlefshmërinë e tyre?

Kjo detyrë u bë qëllimi i jetës sime dhe pelegrimi i besimit tim. E dija se besimi im në Krishtin më kishte sjellë shumë paqe dhe gëzim. Mendja ime kishte etje për disa të vërteta absolute në mes të relativitetit të kulturës sime dhe të dogmatizmit të sistemeve fetare konfliktuese dhe arrogancës denominacionale. Në kërkimin tim për përjasje të vlefshme ndaj interpretimit të letërsisë antike, u befasona teksa zbulova paragjykimet e mia historike, kulturore, denominacionale dhe të përvojës. E kisha lexuar shpesh Biblën vetëm për të përforcuar pikëpamjet e mia. Unë e përdorja si një burim për dogmë për të sulmuar të tjerët ndërsa përforcoja pasigurinë dhe papërshtatshmëritë e mia. Sa e dhimbshme ka qënë të kuptoja të arrija në këtë konkluzion!

Megjithëse nuk mund të jem kurrë tërësisht objektiv, unë mund të bëhem një lexues më i mirë i Biblës. Unë mund të kufizoj paragjykimet e mia duke i identifikuar ato dhe duke pranuar që ato ekzistojnë. Unë nuk jam ende i lirë prej tyre, por unë jam përballur me dobësitë e mia. Interpretuesi shpesh është armiku më i keq i leximit të mirë të Biblës! Më lejoni të listoj disa nga presupozimet që unë sjell në studimin tim të Biblës në mënyrë që ju, lexuesi, të mund t'i analizoni ato së bashku me mua:

I. Presupozimet


1. Unë besoj se Bibla është e vetmja vetë-zbulesë e Perëndisë së vetëm të vërtetë. Prandaj, duhet të interpretohet në dritën e qëllimit të autorit origjinal hyjnor përmes një shkrimtari njerëzor në një rrethanë specifike historike.
2. Unë besoj se Bibla është shkruar për njerëzit e zakonshëm – për të gjithë njerëzit! Perëndia e vendosi Vetveten për të na folur qartazi brenda një konteksti historik dhe kulturor. Perëndia nuk fsheh të vërtetën – Ai dëshiron që ne ta kuptojmë! Prandaj, duhet të interpretohet në dritën e ditës kur është shkruar, dhe jo kohës sonë. Bibla nuk duhet të nënkuptojë për ne diçka që nuk ka pasur kurrë për qëllim të nënkuptojë për personat e parë që e lexuan apo dëgjuan atë. Ajo është e kuptueshme për mendjen njerëzore normale dhe përdor forma dhe teknika komunikimi normale njerëzore.
3. Unë besoj se Bibla ka një mesazh dhe qëllim të unifikuar. Ajo nuk e kundërshton vetveten, edhe pse përmban pasazhe të vështira dhe paradoksikale. Prandaj, interpretuesi më i mirë i Biblës është vetë Bibla.
4. Unë besoj se çdo pasazh (duke përjashtuar profecitë) ka një dhe vetëm një kuptim të bazuar në qëllimin e autorit origjinal dhe të frymëzuar. Edhe pse nuk mund të jemi kurrë të sigurtë plotësisht për qëllimin e autorit origjinal, shumë tregues të shpien në këtë drejtim:
 - a. Zhanri (lloji letrar) i zgjedhur për të shprehur mesazhin
 - b. Rrethana historike dhe / ose ndodhia specifike që nxjerr shkrimin
 - c. Konteksti letrar i të gjithë librit ashtu sikurse dhe çdo njësie letrare
 - d. Forma (skica) tekstuale e njërive letrare ndërsa ato lidhen me të gjithë mesazhin
 - e. Karakteristikat specifike gramatikore të zbatuara për të komunikuar mesazhin
 - f. Fjalët e zgjedhura për të prezantuar mesazhin

Studimi i secilës prej këtyre zonave bëhet objekti i studimit tonë të një pasazhi. Përpara se unë të shpjegoj metodologjinë time për një lexim të mirë të Biblës, me lejoni të përshkruaj disa nga metodat e papërshtatshme të përdorura sot të cilat kanë shkaktuar shumë diversitet në interpretim, dhe për pasojë duhet të shmangen:

II. Metoda të papërshtatshme

1. Shpërfillja e kontekstit letrar të librave të Biblës dhe përdorimi i çdo fjalie, pjese fjalie apo edhe fjalëve individuale si pohime të së vërtetës të palidhura me qëllimin e autorit apo kontekstin më të madh. Kjo shpesh quhet “proof-texting”.
2. Shpërfillja e rrethanave historike të librave duke zëvendësuar një rrethanë historike të supozuar e cila ka pak ose aspak mbështetje nga vetë teksti.
3. Shpërfillja e rrethanave historike të librave dhe leximi i saj si një gazetë e mëngjesit e qytetit e shkruar kryesisht për të krishterët individualë modernë.
4. Shpërfillja e rrethanave historike të librave duke e alegorizuar tekstin në një mesazh filozofik / teologjik tërësisht të palidhur me lexuesit e parë dhe qëllimin e autorit origjinal.
5. Shpërfillja e mesazhit origjinal duke zëvendësuar sistemin e vet teologjik, doktrinën vetiake apo çështje kontemporane të palidhura me qëllimin e autorit origjinal dhe mesazhin e pohuar. Ky fenomen shpesh ndjek leximin fillestar të Biblës si një mënyrë për të themeluar autoritetin e folësit. Kjo shpesh i referohet si “reagimi i lexuesit” (interpretimi “çfarë-teksti-më-thotë-mua”).

Të paktën tre përbërës mund të gjenden në të gjitha komunikimet njerëzore të shkruara:



Në të shkruarën, teknika të ndryshme të leximit janë fokusuar në një nga tre përbërësit. Por për të pranuar vërtetë frymëzimin unik të Biblës, një diagram më e modifikuar është më e përshtatshme:



Në të vërtetë të tre përbërësit duhet të përfshihen në procesin e interpretimit. Për qëllime verifikimi, interpretimi im fokusohet në dy përbërësit e parë: autori dhe teksti origjinal. Unë me shumë mundësi po reagoj ndaj abuzimeve që kam vënë re (1) duke alegorizuar ose spiritualizuar tekstet dhe (2) interpretimi i “reagimit të lexuesit” (çfarë-teksti-më-thotë-mua). Abuzimi mund të ndodhë në secilën nga etapat. Ne duhet gjithmonë të kontrollojmë motivet, paragjykimet, teknikat dhe aplikimet tona. Por si t’i kontrollojmë ato nëse nuk ka kufij për interpretimet, nuk ka limite, nuk ka kritere? Këtu struktura e qëllimit të autorit dhe të tekstit më japin mua disa kritere për të kufizuar gamën e interpretimeve të mundshme të vlefshme.

Mbi bazë të këtyre teknikave të papërshtatshme të leximit, cilat janë disa përjasje të mundshme për lexim dhe interpretim të mirë të Biblës të cilat ofrojnë një shkallë verifikimi dhe qëndrueshmërie?

III. Përjasje të mundshme për lexim të mirë të Biblës

Në këtë pikë nuk po diskutoj teknikat unike të interpretimit të zhanreve specifike por parime të përgjithshme hermeneutike të vlefshme për të gjitha llojet e teksteve biblike. Një libër i mirë për përjasje specifike për zhanërin është *How To Read The Bible For All Its Worth [Si Ta Lexosh Biblën Për Gjithë Vlerën E Saj]* nga Gordon Fee [Gordën Fi] dhe Douglas Stuart [Dagllas Stjuart], të publikuar nga Zondervan.

Metodologjia ime përqëndrohet fillimisht tek lexuesi duke lejuar Frymën e Shenjtë që të ndriçojë Biblën përmes katër ciklesh personale të leximit. Kjo e bën Frymën, tekstin dhe lexuesin parësorë dhe jo dytësorë. Kjo gjithashtu e mbron lexuesin nga të qëniti i ndikuar padrejtësisht nga komentatorët. Unë kam dëgjuar të thuhet: “Bibla hedh shumë dritë mbi komentaret.” Kjo që them nuk ka për qëllim të jetë një koment zhvlerësues për ndihmësit e studimit, por më shumë një lutje për një përdorim në kohën e duhur të tyre. Ne duhet të jemi të aftë të mbështesim interpretimet tona nga vetë teksti. Pesë zona na sigurojnë të paktën verifikime të kufizuara:

1. Rrethanat historike
2. Konteksti letrar
3. Strukturat gramatikore (sintaksa)

4. Përdorimi bashkëkohor i fjalëve
5. Pasazhe paralele të lidhura
6. Zhanri

Ne kemi nevojë të mund të japim arsytet dhe logjikën që qëndron pas interpretimeve tona. Bible është burimi ynë i vetëm për besimin dhe zbatimin. Është e trishtë se të krishterët shpesh nuk bien dakord për atë që ajo mëson apo pohon. Katër ciklet e leximit janë projektuar për të siguruar njohuritë e mëposhtme interpretuese:

1. Cikli i parë i leximit

- a. Lexojeni librin të tërin njëherëshi. Lexojeni atë sërish në një përkthim tjetër, mundësisht nga një teori tjetër përkthimi
 - (1) Fjalë-për-fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - (2) Ekuivalent dinamik (TEV, JB)
 - (3) Perifrazim (Living Bible, Amplified Bible)
- b. Kërkoni qëllimin qëndror të të gjithë shkrimit. Identifikoni tematikën e tij.
- c. Izoloni (nëse është e mundur) një njësi letrare, një kapitull, një paragraf ose një fjali e cila qartazi shpreh këtë qëllim apo temë qëndrore.
- d. Identifikoni zhanrin letrar dominues
 - (1) Dhjata e Vjetër
 - a) Narrative hebraike
 - b) Poezia hebraike (literatura e urtësisë, psalmet)
 - c) Profecia hebraike (proza, poezia)
 - d) Kodikët e ligjit
 - (2) Dhjata e Re
 - a) Narrativat (Ungjijtë, Veprat e Apostujve)
 - b) Shëmbëlltyrat (Ungjijtë)
 - c) Letrat
 - d) Literatura apokaliptike

2. Cikli i dytë i leximit

- a. Lexoni të gjithë librin sërish, përpiquni të identifikoni temat apo subjektet kryesore.
- b. Skiconi temat kryesore dhe shkurtimisht përmbledhni përmbajtjen e tyre në një fjali të thjeshtë.
- c. Kontrolloni pohimin tuaj të qëllimit dhe skicën e përgjithshme me materiale ndihmuese studimi.

3. Cikli i tretë i leximit

- a. Lexoni të gjithë librin sërish, përpiquni të identifikoni rrethanat historike dhe rastet specifike për shkrimin nga vetë libri i Biblës.
- b. Listoni pjesët historike që përmenden në librin e Biblës
 - (1) autori
 - (2) data
 - (3) marrësi
 - (4) arsyeja specifike pse është shkruar
 - (5) aspektet e rrethanave kulturore që lidhen me qëllimin e shkrimit
 - (6) referencat ndaj njerëzve apo ndodhjeve historike

- c. Zgjeroni skicën tuaj në nivel paragrafi për atë pjesë të librit biblik që po interpretoni. Gjithmonë identifikoni dhe skiconi njësinë letrare. Kjo mund të jetë disa kapituj ose paragrafë. Kjo ju mundëson të ndiqni logjikën e autorit origjinal dhe projektimin e tekstit.
- d. Kontrolloni rrethanat historike të identifikuar nga ju me materiale ndihmëse studimi.

4. Cikli i katërt i leximit

- a. Lexojeni njësinë specifike letrare sërish në disa përkthime
 - (1) Fjalë-për-fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - (2) Ekuivalent dinamik (TEV, JB)
 - (3) Perifrazim (Living Bible, Amplified Bible)
- b. Kërkoni për strukturat letrare apo gramatikore
 - (1) Fraza të përsëritura, Efes. 1:6,12,14
 - (2) Struktura gramatikore të përsëritura, Rom. 8:31
 - (3) Koncepte kontrastuese
- c. Listoni pjesët e mëposhtme
 - (1) Terma të rëndësishëm
 - (2) Terma të pazakontë
 - (3) Struktura të rëndësishme gramatikore
 - (4) Veçanërisht fjalë, pjesë fjali dhe fjali të vështira
- d. Kërkoni për pasazhe paralele të lidhura
 - (1) Kërkoni pasazhin më të qartë të mësimit mbi temën tuaj duke përdorur a) libra të “teologjisë sistematike”, b) Bibla referencash, c) konkordanca (lista alfabetike).
 - (2) Kërkoni për një çift të mundshëm paradoksikal në brendësi të subjektit tuaj. Shumë të vërteta biblike janë të pranishme në çifte dialektike; shumë konflikte denominacionale kanë ardhur nga *proof-texting** i zbatuar mbi gjysmën e një pasazhi biblik. E gjithë Bibla është e frymëzuar dhe ne duhet të përpiqemi të gjejmë mesazhin e saj të plotë në mënyrë që të japë një ekuilibër shpirtëror për interpretimin tonë.
 - (3) Kërkoni për paralelizma brenda të njëjtit libër, i njëjti autor ose i njëjti zhanër; Bibla është interpretuesi më i mirë i saj sepse ka vetëm një autor, Frymën.
- e. Përdorni materiale ndihmëse studimi për të kontrolluar vëzhgimet tuaja të rrethanave dhe ndodhive historike
 - (1) Bibla studimi
 - (2) Enciklopedi, manuale dhe fjalorë biblikë
 - (3) Hyrje në Bibël
 - (4) Komentarë biblikë (në këtë pikë në studimin tuaj, lejoni komunitetin e besimit, të shkuar dhe të tashëm, që t’ju ndihmojnë dhe t’ju korrigjojnë studimin tuaj personal.)

IV. Zbatimi i Interpretimit Biblik

Në këtë pikë kalojmë tek zbatimi. Ju keni investuar kohë për të kuptuar tekstin dhe rrethanat e tij origjinale; tani duhet ta zbatoni atë në jetën tuaj, në kulturën tuaj. Unë e përkufizoj autoritetin biblik si “të kuptosh atë që autori origjinal biblik ka qënë duke iu thënë bashkëkohësve të tyre dhe ta zbatosh atë në ditët tona.”

* Shkëputja e një pasazhi nga Bibla dhe nxjerrja nga konteksti. (Shënim i përkthyesit)

Zbatimi duhet të ndjekë interpretimin e qëllimit të autorit origjinal si në kohë dhe në logjikë. Ne nuk mund të zbatojmë një pasazh biblik në ditët tona deri në momentin që nuk e dimë se çfarë po i komunikonte dëgjuesve të ditës kur është shkruar! Një pasazh biblik nuk duhet të nënkuptojë kurrë diçka që nuk ka pasur kurrë për qëllim që ta nënkuptojë!

Skica juaj e detajuar, në nivel paragrafi (lexoni ciklin tre të leximit), do të jetë udhëzuesi juaj. Zbatimi duhet të bëhet në nivel paragrafi, dhe jo në nivel fjale. Fjalët kanë kuptim vetëm në kontekst; pjesët e fjalive kanë kuptim vetëm në kontekst; fjalitë kanë kuptim vetëm në kontekst. I vetmi person i frymëzuar i përfshirë në procesin interpretues është autori origjinal. Ne vetëm mund të ndjekim udheheqjen e tij nga ndriçimi i Frymës së Shenjtë. Por ndriçimi nuk është frymëzim. Që të themi: “kështu thotë Zoti,” ne duhet të qëndrojmë në qëllimin e autorit origjinal. Zbatimi duhet të lidhet specifikisht me qëllimin e përgjithshëm të të gjithë shkrimit, njësinë specifike letrare dhe nivelin e paragrafit për të zhvilluar mendime.

Mos lejoni çështjet e ditëve tona të interpretojnë Biblën; lejoni Biblën të flasë! Kjo mund të na kërkojë që të vendosim disa parime nga teksti. Kjo vlen nëse teksti mbështetet mbi një parim. Fatkeqësisht, shumë herë parimet tona janë thjesht ato, parimet “tona”, jo parimet e tekstit.

Në zbatimin e Biblës, është e rëndësishme të mbajmë mend se (përveçse në profeci) një dhe vetëm një kuptim vlen për një tekst specifik biblik. Ai kuptim lidhet me qëllimin origjinal të autorit ndërsa ai i drejtohet një krize apo nevojë në ditën e tij. Shumë zbatime të mundshme mund të nxirren nga ky kuptim. Zbatimi do të bazohet në nevojat e marrësve por duhet të lidhet me kuptimin e autorit origjinal.

V. Aspekti Shpirtëror i Interpretimit

Derimë tani kam diskutuar procesin logjik të përfshirë në interpretim dhe zbatim. Tani më lejoni të diskutoj shkurtimisht aspektin shpirtëror të interpretimit. Lista e mëposhtme e kontrolleve ka qënë ndihmëse për mua:

1. Lutuni për ndihmën e Frymës së Shenjtë (shih I Kor. 1:26-2:16).
2. Lutuni për falje personale dhe pastrim nga mëkati që dini (shih I Gjoni 1:9).
3. Lutuni për një dëshirë më të madhe për ta njohur Perëndinë (shih Psa. 19:7-14; 42:1 e në vazhdim.; 119:1 e në vazhdim).
4. Zbatoni menjëherë në jetën tuaj çdo zbulesë të re.
5. Qëndroni i përlurur dhe me dëshirë për të mësuar.

Është kaq e vështirë të mbash një ekuilibër midis procesit logjik dhe drejtimit shpirtëror të Frymës së Shenjtë. Citimet e më poshtme më kanë ndihmuar mua që të ekuilibroj këto të dyja:

1. Nga James W. Sire [Xhejms Dabëllju Sajër], Kthimi i Shkrimeve, fq. 17-18:
“Iluminimi vjen në mendjet e popullit të Perëndisë – jo thjesht tek një elitë frymore. Nuk ka një klasë gurush në krishtërimin biblik, nuk ka “iluminati”, nuk ka njerëz përmes të cilëve të vijnë të gjitha interpretimet e sakta. Dhe gjithashtu, ndërsa Fryma e Shenjtë na jep dhunti të veçanta urtësie, njohurie dhe dallimi frymor, Ai nuk na i cakton këta të krishterë me dhunti që të jenë të vetmit interpretues me autoritet të Fjalës së Tij. Varet nga secili person i popullit të Tij për të mësuar, për të gjykuar dhe për të dalluar me referencë ndaj Biblës se cila qëndron si autoritet edhe ndaj atyre që Perëndia iu ka dhënë aftësi të veçanta. Për ta përmbledhur, supozimi që unë po bëj përgjatë gjithë librit është se Bibla është zbulesa e vërtetë e Perëndisë ndaj gjithë njerëzimit, është autoriteti ynë vendimtar mbi të gjitha çështjet për të cilat ajo flet, nuk është një mister total por mund të kuptohet në mënyrë të përkorë nga njerëz të zakonshëm në çdo kulturë.”

2. Mbi Kierkegaard [Kirkegardin], gjendur tek Bernard Ramm [Bernard Ram], Interpretime Biblike Protestante, fq. 75:
Sipas Kierkegaard [Kirkegardit], studimi gramatik, leksikor dhe historik i Biblës ishte i nevojshëm së pari për një lexim të vërtetë të Biblës. “Për të lexuar Biblën si Fjala e Perëndisë, ne duhet ta lexojmë atë me zemrën e etur, në majë të gishtave, me pritshmëri të etur, në bisedë me Perëndinë. Të lexosh Biblën pa e menduar ose në mënyrë të shkujdesur ose në mënyrë akademike apo profesionale nuk është të lexosh Biblën si Fjala e Perëndisë. Nëse e lexon atë si një letër dashurie, atëherë vërtetë e lexon atë si Fjala e Perëndisë.”
3. H. H. Rowley [Ejç Ejç Roullej] në Lidhja e Biblës, fq. 19:
“Asnjë i kuptuar thjesht intelektual i Biblës, sado i plotë, nuk mund të marrë të gjithë thesaret e saj. Ai nuk përçmon këtë të kuptuar, sepse është thelbësor për një të kuptuar të plotë. Por duhet që të drejtojë për tek një i kuptuar frymor i thesareve shpirtërore të këtij libri nëse duhet të jetë i plotë. Dhe për këtë të kuptuar frymor nevojitet diçka më shumë se sa vigjilencë intelektuale. Gjërat frymore dallohen frymërisht dhe studenti i Biblës ka nevojë për një qëndrim shpirtëror marrës, një etje për të gjetur Perëndinë që ai të mund t’i nënshtrohet Atij, nëse dëshiron që të shkojë përtej studimit të tij shkencor për tek trashëgimia më e pasur e librit më të madh nga të gjithë librat.”

VI. Metoda e Këtij Komentari

Komentari Udhëzues i Studimit është dizenuar për të ndihmuar procedurat tuaja interpretuese në mënyrat e mëposhtme:

1. Një skicë e shkurtër historike bën hyrjen në çdo libër. Pasi keni bërë “ciklin tre të leximit”, kontrolloni këtë informacion.
2. Gjenden njohuri kontekstuale në fillim të çdo kapitulli. Kjo do t’ju ndihmojë të shihni se si është e strukturuar njësia letrare.
3. Në fillim të çdo kapitulli apo njësie të rëndësishme letrare, jepen ndarjet në paragrafë apo titujt e tyre përshkrues nga disa përkthime moderne:
 - a. Teksti grek i United Bible Society (UBS4) [Shoqërisë Biblike të Bashkuar], botimi i katërt i rishikuar
 - b. New American Standard Bible (NASB) [Bibla sipas Standartit të Ri Amerikan], përditësim i vitit 1995
 - c. New King James Version (NKJV), [Versioni i Ri i Mbretit Xhejms]
 - d. New Revised Standard Version (NRSV), [Bibla sipas Versionit të Ri të Rishikuar]
 - e. Today’s English Version (TEV), [Versioni Anglisht i Sotshëm]
 - f. New Jerusalem Bible (NJB), [Bibla e Re e Jeruzalemit]

Ndarjet në paragrafë nuk janë të frymëzuara. Ato duhet të konstatohen nga konteksti. Duke krahasuar disa përkthime modern nga teori të ndryshme përkthimi dhe perspektiva të ndryshme teologjike, ne jemi të aftë të analizojmë strukturën e supozuar të mendimit të autorit origjinal. Çdo paragraf ka një të vërtetë kryesore. Kjo është quajtur “fjalja e temës” ose “ideja qëndrore e tekstit”. Ky mendim unifikues është çelësi për interpretim të saktë historik dhe gramatikor. Askush nuk duhet të interpretojë, predikojë ose japë mësim në më pak se një paragraf! Gjithashtu mbani mend se çdo paragraf lidhet me paragrafët e tij pararendës ose vijues. Kjo është arsyeja pse skicimi në nivel paragrafi i të gjithë librit është kaq i rëndësishëm. Ne duhet të jemi të aftë të ndjekim logjikën e subjektit që është adresuar nga autori origjinal i frymëzuar.

4. Shënimet e Bob-it ndjekin një përjasje varg-pas-vargu ndaj interpretimit. Kjo na përcakton që të ndjekim mendimin e autorit origjinal. Shënimet japin informacion nga disa zona:
 - a. Konteksti letrar
 - b. Njohuri historike, kulturore
 - c. Informacion gramatikor
 - d. Studime fjalësh
 - e. Pasazhe paralele të lidhura
5. Në pika të caktuara në komentar, teksti i printuar i New American Standard Version [Bibla sipas Standartit të Ri Amerikan] (përditësim i vitit 1995) do të plotësohet nga përkthimet e disa versioneve të tjera moderne:
 - a. New King James Version (NKJV), [Versioni i Ri i Mbretit Xhejms] i cili ndjek një dorëshkrim tekstual të “Textus Receptus.”
 - b. New Revised Standard Version (NRSV), [Bibla sipas Versionit të Ri të Rishikuar], e cila është një rishikim fjalë-për-fjalë nga Këshilli Kombëtar i Kishave të Versionit Standard të Rishikuar.
 - c. Today’s English Version (TEV), [Versioni Anglisht i Sotshëm], i cili është një përkthim dinamik ekuivalent nga Shoqëria Amerikane Biblike.
 - d. Jerusalem Bible (JB), [Bibla e Jeruzalemit], i cili është një përkthim në anglisht i bazuar mbi një përkthim ekuivalent dinamik katolik francez.
6. Pë rata që nuk e lexojnë greqishten, të krahasosh përkthimet në anglisht mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve në tekst:
 - a. Variacionet e dorëshkrimeve
 - b. Kuptimet alteranative të fjalëve
 - c. Struktura dhe tekstet e vështira gramatikore
 - d. Tekstet e paqarta

Edhe pse përkthimet në anglisht nuk mund t’i zgjidhin këto probleme, ato synojnë të jenë vende për studim më të thellë dhe më të hollësishëm.

Në fund të çdo kapitulli ka pyetje diskutimi të lidhura të cilat përpiqen që të adresojnë çështjet më të mëdha interpretuese të atij kapitulli.

HYRJA NË ZBULESË

POHIME HYRËSE

- A. Në pjesën më të madhe të jetës sime* akademike / teologjike unë kam supozuar se ata që besojnë tek Bibla, e marrin atë “fjalë për fjalë” (dhe kjo është patjetër e vërtetë për ngjarjet historike). Megjithatë, për mua është bërë gjithnjë e më e qartë se që të marr profecinë, poezinë, shëmbëlltyrat dhe literaturën apokaliptike fjalë për fjalë do të thotë që të humbas thelbin e tekstit të frymëzuar. Qëllimi i autorit, dhe jo marrja fjalë për fjalë e librit, është çelësi për një të kuptuar të mirë të Biblës. Për ta bërë Biblën që të thotë më shumë (specifika doktrinale) është po aq e rrezikshme dhe çorientuese sa ta interpretosh atë në një mënyrë që të thotë më pak nga çfarë kishte për qëllim shkruesi origjinal dhe i frymëzuar. Fokusi duhet të jetë konteksti i madh, rrethanat historike dhe qëllimi që autori ka shprehur në vetë tekstin dhe zgjedhja e tij e zhanrit. Zhanri është një kontratë letrare midis autorit dhe lexuesit. Nëse humbasim këtë lidhje, me siguri do të shkojmë në keqinterpretim!

Libri i Zbulesës është patjetër i vërtetë, por nuk është një narrativë historike, nuk duhet marrë fjalë për fjalë. Vetë zhanri na e kërkon këtë duke na e bërë të qartë nëse do ta dëgjojmë. Kjo nuk do të thotë se libri nuk është i frymëzuar apo i vërtetë; është thjesht figurativ, lakonik, simbolik, metaforik dhe imagjativ. Hebrejtë dhe të krishterët e shekullit të parë ishin të familiarizuar me këtë lloj literature, por ne nuk jemi! Simbolika e krishterë në *The Lord of the Rings* [Zoti i Unazave] apo *Chronicles of Narnia* [Kronikat e Narnias] mund të jenë paralelizma modernë.

- B. Zbulesa është një zhanër letrar, apokaliptik hebraik. Shpesh përdorej në kohëra të mbushura me tension (p.sh., Izraeli i sunduar nga fuqi johebraike) për të shprehur bindjen se Perëndia kishte nën kontroll historinë dhe do të sillte çlirim tek populli i Tij. Ky lloj letërsie karakterizohet nga
1. një sens i fortë i sovranitetit universal të Perëndisë (monoteizëm dhe determinizëm)
 2. një luftë midis së mirës dhe së keqes, kësaj kohe të keqe dhe kohës së dretësisë e cila do të vijë (dualizëm)
 3. përdorimi i fjalëve sekrete të kodifikuara (zakonisht nga Dhjata e Vjetër ose letërsia apokaliptike hebraike e shkruar midis dy Dhjatave)
 4. përdorimi i ngjyrave, kafshëve dhe ndonjëherë kafshëve / njerëzve
 5. përdorimi i numrave simbolikë (p.sh., 4, 6, 7, 10, 12)
 6. përdorimi i ndërmjetësimeve ëngjëllore me anë të vegjimeve dhe ëndrrave, por zakonisht përmes interpretimit ëngjëllor
 7. përqëndrimet kryesore në ndodhitë klimatike dhe të ardhshme të kohëve të fundit (epoka e re)
 8. përdorimi i një grupi të caktuar simbolesh, dhe jo realitetin, për të komunikuar mesazhin e fundit të kohërave nga Perëndia
 9. disa shembuj të këtij lloji zhanri janë:
 - a. Dhjata e Vjetër
 - (1) Isaia 13-14; 24-27; 56-66
 - (2) Ezekieli 1; 26-28; 33-48
 - (3) Danieli 7-12
 - (4) Joeli 2:28-3:21
 - (5) Zakaria 1-6, 12-14
 - b. Dhjata e Re
 - (1) Mateu 24, Marku 13, Luka 21 dhe 1 e Korintasve 15 (në disa mënyra)
 - (2) 2 Thesalonikasve 2 (në shumë mënyra)
 - (3) Zbulesa (kapitujt 4-22)
 - c. Danieli 7-12 dhe Zbulesa 4-22 janë shembujt klasikë të këtij zhanri në Bibël

* Në moshë madhore (shënim i përkthyesit).

10. Librat jokanonikë (marrë nga D.S. Russell, *The Method and Message of Jewish Apocalyptic*, pp. 37-38 [D.S. Rasëll, *Metoda dhe Mesazhi i Veprave Apokaliptike Hebraike*, fq. 37-38])
 - a. I Enoch, II Enoch (the Secrets of Enoch) [Eunuku I, Eunuku II (Sekretet e Eunukëve)]
 - b. The Book of Jubilees [Libri i Jubileut]
 - c. The Sibylline Oracles III, IV, V [Orakujt Profetikë III, IV, V]
 - d. The Testament of the Twelve Patriarchs [Dhjata e Dymbëdhjetë Patriarkëve]
 - e. The Psalms of Solomon [Psalmet e Solomonit]
 - f. The Assumption of Moses [Supozimet e Moisiut]
 - g. The Martyrdom of Isaiah [Martirizimi i Isaia]
 - h. The Apocalypse of Moses (Life of Adam and Eve) [Apokalipsi i Moisiut (Jeta e Adamit dhe Evës)]
 - i. The Apocalypse of Abraham [Apokalipsi i Abrahamit]
 - j. The Testament of Abraham [Dhjata e Abrahamit]
 - k. II Esdras (IV Esdras) [Ezdra II (Ezdra IV)]
 - l. II & III Baruch [Baruku II dhe III]
11. Ekziston një sens dualiteti në këtë zhanër. Ai e sheh realitetin si një seri dualizmesh, kontrastesh apo tensionesh (diçka që është kaq e zakonshme në shkrimet e Gjonit) midis:
 - a. Tokës – qiellit
 - b. Epokës së keqe (njerëzve të këqij dhe ëngjëjve të këqij) – epokës së re të drejtësisë (njerëzve të perëndishëm dhe ëngjëjve të perëndishëm)
 - c. Ekzistencës aktuale – ekzistencës së ardhshme

Të gjitha këto lëvizin drejt një plotësimi të sjellë nga Perëndia. Kjo nuk është bota që Perëndia kishte në plan, por Ai vazhdon të planifikojë, punojë dhe të projektojë vullnetin e Tij për një restaurim të marrëdhënies intime të nisur në Kopështin e Edenit. Ndoghia e Krishtit është çasti vendimtar i planit të Perëndisë, por dy ardhjet kanë sjellë dualizmin aktual.

- C. Këto vepra apokaliptike nuk janë prezantuar kurrë gojarisht; ato kanë qënë gjithmonë të shkruara. Ato janë vepra letrare tejet të strukturuar. Struktura është thelbësore për një interpretim të saktë. Një pjesë e konsiderueshme e strukturës së planifikuar të librit të Zbulesës janë shtatë njësitë letrare, të cilat janë në paralel me njëra-tjetrën në një farë mase (p.sh., shtatë vulat, shtatë trumpetat dhe shtatë enët). Në çdo cikël, gjykimi rritet: vulat, 1/4 shkatërrim; trumpetat, 1/3 shkatërrim; enët, shkatërrim total. Brenda çdo njësie letrare Ardhja e Dytë e Krishtit ose një ndodhi eskatologjike ndodh: (1) vula e gjashtë, Zbu. 6:12-17; (2) trumpeta e shtatë, Zbu. 11:15-18; një gjykim i kohërave të fundit nga ëngjëlli në Zbu. 14:14-20; (3) ena e shtatë, Zbu. 16:17-21 dhe sërish në Zbu. 19:11-21 dhe përsëri në Zbu. 22:6-16 (dhe gjithashtu vini re titullin e trefishtë për Perëndinë në Zbu. 1:4,8 dhe Krishtin në Zbu. 1:17,18, “që është dhe që ishte dhe që do të vijë,” vini re aspektin e së ardhmes të lënë jashtë në Zbu. 11:17 dhe Zbu. 16:5 që do të thotë se e ardhmja ka ardhur [dmth, ardhja e dytë]). Kjo tregon se libri nuk ndjek rrjedhën kronologjike, por është një pjesë teatrale me disa akte e cila parasheh të njëjtën periudhë kohore në motivet e dhunës në rritje të gjykimit në Dhjatën e Vjetër (shih James Blevins, *Revelation as Drama* and “The Genre of Revelation” in *Review and Expositor*, Sept. 1980, pp. 393-408 [Xhejms Blevins, *Zbulesa si Pjesë Teatrale* dhe “Zhanri i Zbulesës” në *Rishikim dhe ekspozitor*, Shtator 1980, fq. 393-408]).

Ka shtatë seksione letrare plus një prolog dhe një epilog

1. Prologu, Zbu. 1:1-8
2. Zbu. 1:9-3 (Krishti dhe shtatë kishat)
3. Zbu. 4-8:1 (qielli dhe shtatë vulat [Zbu. 2:1-17 ndërthurje midis vulës së gjashtë dhe të shtatë])
4. Zbu. 8:2-11 (shtatë ëngjëjt me trumpeta [Zbu. 10:1-11:13 ndërthurje midis trumpetës së gjashtë dhe të shtatë])
5. Zbu. 12-14 (dy komunitetet dhe udhëheqësit e tyre)
6. Zbu. 15-16 (shtatë ëngjëjt me enë)
7. Zbu. 17-19 (Babilonia dhe gjykimi i saj)
8. Zbu. 20-22:5 (gjykimi dhe qielli i ri dhe toka)
9. Epilogu, Zbu. 22:6-21

Një tjetër autor që besonte në teorinë e rikapitullimit është William Hendriksen [Uilliam Hendriksen]. Në librin e tij, *More Than Conquerors [Më shumë se fitimtarë]*, ai e skicon librin në këtë mënyrë:

1. Zbu. 1-3 (Krishti në mes të Shtatë Shandanëve)
2. Zbu. 4-7 (Libri me Shtatë Vulat)
3. Zbu. 8-11 (Shtatë Trumpetat e Gjykimit)
4. Zbu.12-14 (gruaja dhe fëmija i persekutuar nga Dragoi dhe Ndhmuesit e Tij [Bisha dhe Harloti])
5. Zbu. 15-16 (Shtatë Enët e Zemërimit)
6. Zbu. 17-19 (rënia e Harlotit të Madh dhe e Bishave)
7. Zbu. 20-22 (gjykimi mbi Dragoin (Satanin) i ndjekur nga Qielli dhe Toka e Re, Jeruzalemi i Ri), fq. 28

Në librin *More Than Conquerors [Më Shumë Se Fitimtarë]*, William Hendriksen [Uilliam Hendriksen] thotë se Zbulesa ka shtatë seksione: Zbu. 1-3, 4-7; 8-11; 12-14; 15-16; 20-22 dhe se secili nga këto është paralel dhe mbulon periudhën midis ardhjes së parë të Krishtit dhe ardhjes së Tij të dytë. Secili përfundon me disa aspekte të lidhura me gjykimin dhe me Ardhjen e Dytë (fq. 22-31).

Edhe pse sigurisht jam dakord me paralelizmin dramatik të vulave, trumpetave dhe enëve, gjithashtu më tërheqin mjaft kapitujt 17-19 të cilët janë në paralel me kapitujt 20-22 (ardhja e dytë është në Zbu. 19:11-21 dhe një ardhje tjetër e dytë në Zbu. 22:6-15; vini re veçanërisht v. 15; e keqja nuk është hequr ende, dmth Zbu. 19:14-15), nuk mund të shoh se ku përfundon secili nga shtatë seksionet në *Parousia* [Ardhja e dytë e Jezusit], veçanërisht kapitujt 1-3, vetëm nëse ka një aspekt gjykimi i cili shihet si një ndodhi eskatologjike (shih Zbu. 2:5,7,11,16-17,25-26; 3:5,10,12,18-21). Megjithatë, për mua, ky rikapitullim i shtatë-fishtë bëhet gjithnjë e më shumë një mundësi për të kuptuar strukturën paralele të të gjithë librit.

D. Është e dukshme se numri “shtatë” luan një rol të rëndësishëm në strukturën e librit siç mund të shihet nga shtatë kishat, shtatë vulat, shtatë trumpetat, dhe shtatë enët. Disa shembuj të tjerë të “shtatës” janë:

1. 7 bekimet, Zbu. 1:3; 14:13; 16:15; 19:9; 20:6; 22:7,14
2. 7 shandanët, Zbu. 1:12
3. 7 frymërat e Perëndisë, Zbu. 1:4; 3:1; 4:5; 5:6
4. 7 yjet, Zbu. 1:16,20; 2:1
5. 7 llambat e zjarrit, Zbu. 4:5
6. 7 vulat e dorëshkrimeve, Zbu. 5:1
7. 7 brirët, 7 sytë e qengjit, Zbu. 5:6
8. 7 atributet e Jezusit të lavdëruar, Zbu. 5:12
9. 7 shenjat në natyrë, Zbu. 6:12-14
10. 7 llojet e njerëzve, Zbu. 6:15
11. 7 atributet e Perëndisë të lavdëruar, Zbu. 7:12
12. 7 ëngjëjt e Perëndisë, Zbu. 8:2,6
13. 7 trumpetat e mbajtura nga shtatë ëngjëjt, Zbu. 8:6 (Zbu. 15:1,6,7,8; 17:1; 21:9)
14. 7 shenjat, Zbu. 12:1,3; 13:13,14; 15:1; 16:14; 19:20
15. 7 kokat, 7 diademat e dragoit të kuq, Zbu. 12:3
16. 7 kokat e bishës së detit, Zbu. 13:1; 17:3,7
17. 7 ëngjëjt, Zbu. 14:6-20
18. 7 plagët, Zbu. 15:1; 21:9
19. 7 kodrat, Zbu. 17:9
20. 7 mbretërit Zbu. 17:10
21. 7 gjërat që nuk janë më në kapitujt 21-22 (Zbu. 21:1,4[katër herë]; Zbu. 21:25; 22:3)

E. Interpretimi i librit është mbi baza teologjike dhe të çënueshme. Supozimet e lexuesit drejtojnë interpretimin e detajeve të paqarta. Këto supozime teologjike funksionojnë mbi disa nivele:

1. Origjina e simboleve
 - a. Aludimet e Dhjatës së Vjetër
 - (1) Tematikat e Dhjatës së Vjetër si krijimi, rënia, përmbytja, eksodi, Jeruzalemi i restauruar
 - (2) Qindra aludime (jo citime të drejtpërdrejta) nga profetët e Dhjatës së Vjetër

- b. Letërsi hebraike e shkruar midis dy Dhjatave (I Enoch, II Baruch, Sibylline Oracles, II Esdras [Eunuku I, Baruku III, Orakujt Profetikë, II Ezdra])
 - c. Bota Greko-Romake e shekullit të parë
 - d. Rregjistrimet kosmologjike të krijimitë antik të Lindjes së Afërme (sidomos Zbu. 12)
2. Hapësira kohore e librit
- a. Shekulli i parë
 - b. Çdo shekull
 - c. Brezi i fundit
3. Linja teologjike sistematike (shih përkufizimin në faqen 14, "Historical Theories of Interpretation," C; a good summary, *Four Views on the Book of Revelation*, ed. C. Marvin Pate ["Teoritë Historike të Interpretimit," C; një përmbledhje e mirë, *Katër Këndvështrimet e Librit të Zbulesës*, botues C.Marvin Pate])
- a. preterist
 - b. historicist
 - c. futurist
 - d. idealist
4. Pozicionet teologjike të kapitullit 20 (shih grafikun në faqen 193; "Historical Theories of Interpretation," C; a good summary, *Four Views on the Book of Revelation*, ed. C. Marvin Pate [përmbledhje të mira: (1) *Kuptimi i Milleniumit: Katër Pikëpamje*, botues Robert G. Kllauz] dhe *Three Views of the Millennium and Beyond*, ed. Darrell L. Bock [*Tre Këndvështrimet e Milleniumit dhe Përtej*, botim Darell L. Bok])
- a. një mijëvjeçar
 - b. pas mijëvjeçarit
 - c. para mijëvjeçarit
 - d. dispensational para mijëvjeçarit

Në perspektivën e divergjencës hermeneutike (përfaqset e ndryshme ndaj interpretimit) dhe dogmatizmave të pasakta (qëndrimi që "unë i di të gjitha"), si duhet të vazhdojë një interpretues?

1. Le ta pranojmë se të krishterët modernë perëndimorë nuk e kuptojnë zhanrin dhe nuk i njohin aludimet historike që të krishterët e shekullit të parë do t'i kishin kuptuar menjëherë.
 2. Le të pranojmë se çdo brez i të krishterëve e ka vendosur me forcë Zbulesën në rrethanat e veta historike dhe të gjithë kanë gabuar deri më tani.
 3. Le të lexojmë Biblën përpara se të lexojmë sistemet teologjike. Kërkoni kontekstin letrar të secilit vizion / orakull dhe pohoni të vërtetën qendrore në një fjali shpallëse. E vërteta qendrore do të jetë e njëjta për çdo brez besimtarësh ndërkohë që specifika e detajeve mund të jetë e aplikueshme vetëm për brezin e parë dhe / ose të fundit të besimtarëve. Detajet mund të lidhen, por historia, dhe jo teologjia, do të zbulojnë përmbushjen e tyre.
 4. Le të mbajmë mend se ky libër është kryesisht një fjalë ngushëlluese dhe inkurajuese për besnikërinë e besimtarëve në mes të persekutimit nga jo besimtarët. Ky libër nuk ka për qëllim që t'i përgjigjet kuriozitetit të çdo brezi besimtarësh, as të skicojë një plan të detajuar të ndodhive të kohëve të fundit.
 5. Jemi të sigurtë që mund të pohojmë se shoqëria njerëzore e rënë është në një rrjedhë përplasjeje me mbretërinë e Perëndisë. Në fillim do të duket sikur bota ka fituar (si në Kalvar), por prisni; Perëndia është sovran, Ai ka nën kontroll historinë, të jetës dhe të vdekjes. Populli i Tij është fitimtar në Të!
- F. Përveç vështirësisë dhe paqartësisë së interpretimit, ky libër ka një mesazh dhe është një fjalë të frymëzuar nga Perëndia për popullin e Tij në çdo epokë. Ia vlen që të bësh përpjekjet shitesë që nevojiten për të studjuar këtë libër unik. Pozicionimi i tij strategjik në librin kanonik të Dhjatës së Re flet për mesazhin e tij themeltar. Alan Johnson, *The Expositor's Bible Commentary* [Alen Xhonson, *Komentari i Biblës së Ekspozitorit,*] vol. 12 thotë:

“Në të vërtetë, mund të jetë që, me përjashtim të Ungjijve, Apokalipsi përmban mësimin më të thellë dhe më prekës të doktrinës dhe dishepullizimit të krishterë të gjendur ndonjëherë në Shkrimet e Shenjta. As fanaticizmi i disave të cilët e kanë fiksuar vëmendjen e tyre tek profecia dhe jo tek Krishti, dhe as larmishmëria e pikëpamjeve interpretuese nuk duhet të na dekurajojnë nga të kërkuarit e së vërtetës së krishterë në këtë libër të mrekullueshëm” (fq. 399).

Mbani mend, këto janë me të vërtetë fjalët e fundit të Jezusit ndaj kishës së Tij! Kisha moderne nuk duhet të guxojë t’i shpërfillë apo t’i minimizojë ato! Ato janë për të përgatitur besimtarët për persekutimin dhe konfliktin nën dritën e sovranitetit të Perëndisë (monoteizëm), realitetit të të ligut (dualizëm i kushtëzuar), rezultateve të vazhdueshme të rënies (rebelimit njerëzor) dhe premtimeve të Perëndisë për të shpenguar njerëzimin (besëlidhje e pakushtëzuar, shih Zan. 3:15; 12:1-3; Eksod. 19:5-6; Gjon 3:16; 2 Kor. 5:21).

AUTORI

- A. Prova të brendshme për autorësinë e apostullit Gjon
 1. Autori e quan veten e tij katër herë Gjon (shih Zbu. 1:1,4,9; 22:8)
 2. Ai gjithashtu e quan veten e tij
 - a. Një shërbëtor i vet (shih Zbu. 1:1, 22: 6)
 - b. Një vëlla dhe një pjesëtar në pikëllim (shih Zbu. 1:9)
 - c. Një profet (shih Zbu. 22:9) dhe ai e quan librin e tij një profeci (shih Zbu. 1:3, 22:7,10,18,19)
 3. Ai e njuh Dhjatën e Vjetër (nuk përdor LXX, por Targumet) dhe gjithashtu edhe periudhën e endjes në shkretëtirë, procedurat e Tabernakullit dhe të Sinagogës së atëherëshme.
- B. Prova të jashtme për autorësinë e apostullit Gjon nga autorë të hershëm të krishterë
 1. Apostulli Gjon, biri i Zebedeut
 - a. Justin Martyr (Rome A.D. 110-165) in *Dialogue with Trypho* 81.4 [Justin Martir (Romë 110-165 pas Krishtit) në *Dialog me Trifo* 81.4]
 - b. Irenaeus (Lyons A.D. 120-202) in *Against Heresies* IV.14.2; 17.6; 21.3; V.16.1; 28.2; 30.3; 34.6; 35.2 [Ireneasi (Lions 120-202 pas Krishtit) në *Kundër Heresive* IV.14.2; 17.6; 21.3; V.16.1; 28.2; 30.3; 34.6; 35.2]
 - c. Tertullian (North Africa A.D. 145-220) in *Against Praxeas* 27 [Tertuliani (Afrika e Veriut 145-220 pas Krishtit) në *Kundër Prakseasit* 27]
 - d. Origen (Alexandria A.D. 181-252) in [Origen (Aleksandri 181-252 pas Krishtit) në
 - (1) *On the Soul*, L:8:1 [*Mbi Shpirtin*, L:8:1]
 - (2) *Against Marcion*, II:5 [*Kundër Marcionit*, II:5]
 - (3) *Against Heretics*, III:14, 25 [*Kundër Heresive*, III:14, 25]
 - (4) *Against Celsus*, VI:6, 32; VIII:17 [*Kundër Celsiusit*, VI:6, 32; VIII:17]
 - e. The Muratorian Canon (Rome A.D. 180-200) [Kanoni Muratorian (Romë 180-200 pas Krishtit)]
 2. Kandidatë të tjerë
 - a. Gjon Marku – Ky u përmend për herë të parë nga Dionisi, Peshkopi i Aleksandrisë (247-264 pas Krishtit), i cili mohoi autorësinë e Apostullit Gjon por ende i qëndroi mendimit se vepra është kanonike. Ai e bazoi kundërshtimin e tij mbi fjalorin dhe stilin sikurse dhe mbi natyrën anonime të shkrimeve të tjera të Gjonit. Ai bindi Eusebiusin e Cesareas.
 - b. Gjoni nga pleqësia – Kjo vjen nga një citim në Eusebius të Papias (*Eccl. His.* 3.39.1-7 [Pred. His. 3.39.1-7]). Megjithatë, citimi i Papias me shumë mundësi përdori këtë titull për Apostullin Gjon në vend që të hamendësonte për një autor tjetër.
 - c. Gjon Pagëzori – (me shtesa të tjera të mëvonshme editoriale) është sugjeruar nga J.Massyngberde Ford [J. Mesingberd Ford] në komentarin Anchor Bible [Bibla Spirancë], bazuar kryesisht në përdorimin e Gjon Pagëzorit të “qengjit” për Jezusin. I vetmi rast tjetër kur përmendet ky titull gjendet në Zbulesë.
- C. Dionisi, peshkopi i Aleksandrisë (247-264 pas Krishtit) dhe studenti i Origenit, ishte i pari i cili shprehu dyshime (libri i tij është humbur, por ai është cituar nga Eusebiusi i Cesareas, i cili ra dakord me të) mbi autorësinë e Apostullit Gjon, bazuar mbi

1. Apostulli Gjon nuk i referohet vetes së tij si Gjoni në Ungjill apo në letrat e tij, por Zbulesa është nga “Gjoni”
 2. Struktura e Zbulesës është e ndryshme nga Ungjilli dhe letrat
 3. Fjalori i Zbulesës është i ndryshëm nga Ungjilli dhe letrat
 4. Stili gramatikor i Zbulesës është i një cilësie më të ulët në krahasim me Ungjillin dhe letrat
- D. Me shumë mundësi sfida më serioze moderne e bërë ndaj autorësisë së Apostullit Gjon vjen nga R. H. Charles në *Saint John*, Vol. I p.xxxixff [R. H. Çarls në *Shën Gjoni*, Vol.I p.xxxixff].
- E. Pjesa më e madhe e studiuesve modernë kanë refuzuar autorësinë tradicionale të shumë prej librave të Dhjatës së Vjetër. Një shembull i mirë i këtij trendi lidhur me autorësinë e Zbulesës mund të jetë Raymond E. Brown [Rejmond E. Braun], një studiues i njohur katolik i Gjonit. Volumi hyrës i serisë së Komentareve të Anchor Bible [Biblës Spirancë] thotë: “shkruar nga një profet jude i krishterë i quajtur Gjon i cili nuk ishte as Gjoni, biri i Zebedeut, as shkruesi i Ungjillit apo i letrave të Gjonit” (fq.774).
- F. Në shumë mënyra autorësia është e pasigurtë. Ka disa paralelizma të habitshme me shkrimet e tjera të Apostullit Gjon dhe gjithashtu disa ndryshime të habitshme. Çelësi për të kuptuar këtë libër nuk është autorësia e tij njerëzore por autorësia e tij Hyjnore! Autori besonte se ishte një profet i frymëzuar (shih Zbu. 1:3; 22:7,10,18,19).

DATA

- A. Kjo është me siguri e lidhur në mënyrë të integrueshme me autorësinë dhe perspektivën e interpretimit (shih Teoritë Historike C.).
- B. Disa data të mundshme
 1. Data tradicionale është gjatë sundimit Domician (81-96 pas Krishtit) sepse ajo i përshtatet provës së persekutimit
 - a. Ireneasi (cituar nga Eusebiusi) në *Against Heresies* [*Kundër Heresive*], 5.30.3. “Ai (ky persekutim) nuk u pa shumë kohë më parë, pothuajse në brezin tonë, në më të afërtën gjatë sundimit të Domicianit.”
 - b. Klementi i Aleksandrisë
 - c. Origeni i Aleksandrisë
 - d. Eusebiusi i Caseares, *Church History*, iii.23.1 [*Historia e Kishës*, iii.23.1]
 - e. Victorinus, *Apocalypse* x.11 [*Apokalipsi* x.11]
 - f. Jeromi
 2. Epifanius, një shkrimtar i shekullit të tretë, në *Haer*, 51.12, 32, thotë se Gjoni e shkroi atë nga Patmos i cili ishte gjatë sundimit të Claudius (41-54 pas Krishtit).
 3. Të tjerë kanë supozuar se u bë gjatë sundimit të Nero-s (54-68 pas Krishtit) për shkak të:
 - a. Rrethanave të dukshme të persekutimit të kultit të Perandorit
 - b. *Caesar Nero* [*Cezar Nero*], shkruar në hebraisht, është i njëjtë me numrin e bishës, 666
 - c. Nëse preteristët janë të saktë që Zbulesa e Gjonit i referohet shkatërrimit të Jeruzalemit, atëherë që libri të jetë profeci, duhet të jetë shkruar përpara vitit 70 pas Krishtit

DËGJUESIT

- A. Nga Zbu. 1:4 është e qartë që dëgjuesit e parë ishin shtatë kishat në provincën romake të Azisë. Këto kisha adresohen në një mënyrë të tillë që nënkupton shtegun e udhëtimit të mbajtësit të letrës.
- B. Mesazhi i Zbulesës në mënyrë unike lidhet me të gjitha kishat dhe besimtarët që janë duke përjetuar persekutim nga një sistem i një bote të rënë.
- C. Si konkluzioni kanonik për Dhjatën e Re ky libër është një mesazh përmbushjeje për të gjithë besimtarët e të gjitha kohërave.

SHKAKU

- A. Rrethanat ishin persekutimi i shkaktuar nga ndarja e kishave lokale nga mbrojtja ligjore që Roma i jepte judaizmit. Kjo ndarje ndodhi zyrtarisht në vitin 70 pas Krishtit kur rabinët nga Jamnia themeluan një formulë betimi e cila kërkonte që anëtarët e sinagogës lokale të mallkonin Jezusin e Nazaretit.

- B. Dokumentet romake tregojnë se adhurimi i perandorit u bë një konflikt kryesor me kishën nga sundimi i Neros (54-68 pas Krishtit) deri tek ai Domicianit (81-96 pas Krishtit). Megjithatë, nuk ka asnjë dokumentacion të një persekutimi zyrtar në mbarë perandorinë. Me sa duket, Zbulesa reflektonte masën e madhe të adhurimit nga kultet ndaj perandorit në provincat lindore të Perandorisë Romake (shih “Rishikimi Arkeologjik Biblik,” Maj/Qershor 1993 fq. 29-37).

SINTAKSA

- A. Ka shumë problemet gramatikore në tekstin grek.
- B. Disa shkaqe të mundshme të këtyre problemeve
1. Mënyra e të menduarit të Gjonit në gjuhën aramaike.
 2. Ai nuk kishte asnjë skrib në Patmos që të shkruante për të.
 3. Ngazëllimi prej vegimeve ishte shumë i madh.
 4. Ato janë bërë qëllimisht për efekt.
 5. Zhanri (apokaliptik) ishte tejet figurativ.
- C. Veçanti të ngjashme gramatikore gjenden në shkrimet e tjera hebraike apokaliptike. Prandaj Zbulesa nuk është shkruar në një stil të mangët gramatikor, por në një zhanër me veçanti gramatike.

KANONICITETI

- A. U refuzua nga kisha lindore e hershme; libri nuk shfaqet në Peshita (versioni i sirian i shekullit të pestë).
- B. Në fillim të shekullit të katërt Eusebiusi, duke ndjekur Dionisin e Aleksandrisë në fund të shekullit të tretë, thoshte që Zbulesa nuk është shkruar nga Apostulli Gjon. Ai e listonte atë si një nga librat “e debatuar” por e përfshinte atë në listën e tij të librave kanonikë (shih *Ecclesiastical History [Historia Ekleziastike]*, III.24.18; III.25.4; dhe III.39.6).
- C. Këshilli i Laodicesë (rreth vitit 360 pas Krishtit) e hoqi atë nga lista e librave kanonikë. Jeromi e refuzoi atë si kanonik, por Këshilli i Kartagës (viti 397 pas Krishtit) e përfshiu atë. Zbulesa u pranua me anë të një kompromisi midis kishave të lindjes dhe të perëndimit me anë të së cilit u përfshinë letra e Hebrenjve dhe Zbulesa në librin kanonik të Dhjatës së Re.
- D. Ne duhet ta pranojmë atë si një supozim besimi të besimtarëve që Fryma e Shenjtë e ka udhëhequr procesin historik të zhvillimit të një libri kanonik të krishterë.
- E. Dy teologët kryesorë të Reformacionit Protestant e refuzuan vendin e tij në doktrinën e krishterë
1. Martin Luther [Martin Luteri] nuk e quajti atë as profetik dhe as apostolik, duke refuzuar në thelb frymëzimin e tij.
 2. John Calvin [Xhon Kalvin], i cili shkroi një komentari mbi çdo libër të Dhjatës së Re përveç Zbulesës, në thelb refuzoi rëndësinë e tij.

TEORI HISTORIKE TË INTERPRETIMIT

- A. Ka qënë dukshëm i vështirë për t’u interpretuar; prandaj, dogmatizmi është i papërshtatshëm!
- B. Simbolet nxirren nga
1. Pasazhet apokaliptike të Dhjatës së Vjetër tek
 - a. Danieli
 - b. Ezeieli
 - c. Zakaria
 - d. Isaia
 2. Letërsia hebraike apokaliptike e shkruar midis dy Dhjatave
 3. Rrethanat historike greko-romake të shekullit të parë (sidomos Zbulesa 17)
 4. Rregjistrimet e lashta mitologjike të Lindjes së Afërme në lidhje me krijimin (sidomos Zbulesa 12)
- C. Në përgjithësi ka katër rrjete interpretuese ose supozime
1. PRETERIST – ky grup e sheh librin si kryesisht ose ekskluzivisht të lidhur me kishat e shekullit të parë në provincën romake të Azisë. Të gjitha detajet dhe profecitë u përmbushën në shekullin e parë (shih John L. Bray, *Matthew 24 Fulfilled* [Xhon L. Brej, *Mateu 24 i Përmbushur*]).
 2. HISTORICIST – ky grup e sheh librin si një përbledhje historike, kryesisht të qytetërimit perëndimor dhe në një farë kuptimi të kishës katolike. Shpesh letrat ndaj shtatë kishave të kapitujve 2 dhe 3 përdoren si një përshkrim i caktuar i periudhave të kohës. Disa i shohin ato si përkohësisht të sinkronizuara dhe të tjerë si kronologjikisht vijuese.

3. FUTURIST – ky grup e sheh librin si t'i referohej ndodhive të menjëhershme pararendëse dhe pasuese të *Parousia* (Ardhja e Dytë e Krishtit) e cila do të përmbushet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe historike (shih *Progressive Dispensationalism*, nga Craig A. Blaising dhe Darrell L Bock [*Dispensacionalizmi Progresiv*, nga Kreig A. Blleising dhe Darell L. Bok]).
4. IDEALIST – ky grup e sheh librin si tërësisht simbolikë të luftës midis së mirës dhe së keqes në të cilën nuk ka asnjë referencë historike (shih Ray Summers, *Worthy Is the Lamb* [Rej Samërs, *I Denjë Është Qengji*; William Hendriksen, *More Than Conquerors* [Uilliam Hendriksen, *Më Shumë se Fitimtarë*]).

Të gjitha këto kanë pak vlefshmëri, por ato e humbasin paqartësinë e qëllimtë të zgjedhjes së zhanrit dhe të figurave nga Gjoni. Problemi është ekuilibri, jo se cila prej tyre është e saktë.

QËLLIMI I LIBRIT

- A. Qëllimi i Zbulesës është që të tregojë sovranitetin e Perëndisë në histori dhe premtimin e arritjes së kulmit në të gjitha gjërat tek Ai. Besnikët duhet të qëndrojnë në besim dhe shpresë në mes të persekutimit dhe agresionit të sistemit të kësaj bote të rënë. Fokusi i librit është persekutimi (adhurimi i Perandorit në provincën lindore) dhe besnikëria (mësuesit e rremë dhe kompromisi kulturor) e besimtarëve në shekullin e parë dhe në çdo shekull (shih 2:10). Mbani mend, profetët folën për të ardhmen duke u përpjekur që të reformojnë të tashmen. Zbulesa nuk ka të bëjë vetëm me se si do të përfundojë, por edhe se si po ecën. Në artikullin e tij *The Expositors Bible Commentary*, Vol. I i titulluar, "The Eschatology of the Bible," Robert L. Sancy [*Komentari i Biblës së Ekspozitorit*, Vol. I i titulluar "Eskatologjia e Biblës", Robert L. Sancy] thotë:

“profetët biblikë nuk ishin të shqetësuar kryesisht me kohën dhe me sistemimin kronologjik të ndodhive të së ardhmes. Për ta gjendja shpirtërore e bashkëkohësve të tyre ishte pika më e rëndësishme dhe vizita madhështore eskatologjike e Perëndisë për gjykimin e të padrejtëve dhe bekimin e besimtarëve ndërkallej për ndikimin etik në të tashmen” (fq. 104).
- B. Qëllimi i përgjithshëm përmbledhet mirë në hyrjen e shkurtër për tek përkthimet TEV dhe NJB
 1. TEV, fq.1122: “Zbulesa ndaj Gjontit është shkruar në një kohë kur të krishterët po persekutoheshin për shkak të besimit të tyre në Jezus Krishtin si Zot. Shqetësimi kryesor i shkrimtarit është që t’ju japë shpresë dhe inkurajim lexuesve të tij dhe që t’i nxisë ata që të qëndrojnë besnikë gjatë kohëve të vuajtjeve dhe persekutimit.”
 2. NJB, fq.1416, “Bibla përmbledhet në mesazhin e shpresës dhe të simbolikës së pasur të këtij libri. Është një vizion i shpëtimit nga provat të cilat mësyjnë popullin e Perëndisë, dhe një premtim për një të ardhme të lavdishme. Mesazhi shprehet me anë të imazheve të cilat tërheqin të gjithë Biblën, në mënyrë të tillë që çdo karakteristikë, kafshë, ngjyrë, numër, është ndjellëse dhe plot me mbitonë për një lexues që është i njohur me Dhjatën e Vjetër. Në këtë mënyrë ajo është një zbulesë sekrete dhe aludive e asaj që do të vijë, edhe pse simbolizmi natyror i veprave të mëdha të adhurimit dhe të vegimit final të madhështisë mesianike të Qytetit të Ri të Shenjtë janë mjaftueshëm të qarta. Ishte një traditë për shkrime të tilla në Judaizëm nga Danieli e në vazhdim, që të forconin popullin e Perëndisë që gjendej në persekutim duke iu dhënë sigurinë për çlirim dhe triumf përfundimtar.”
- C. Është thelbësore që interpretuesi t’i japë temës së shpengimit prioritet.
 1. Perëndia ka sjellë shpëtim individual, korporativ dhe kozmik përmes Krishtit.
 2. Shpengimi i Perëndisë është shpirtëror dhe fizik. Kisha u shpëtua, por ajo nuk është në rrethana të sigurta! Një ditë ajo do të jetë e tillë!
 3. Perëndia ende e do njerëzimin e rënë, rebel dhe të vetë-qendëruar. Zemërimi i Perëndisë në vulat dhe trumpetat është për shpengim (shih Zbu. 9:20-21; 14:6-7; 16:9,11; 21:6b-7; 22:17).
 4. Perëndia jo vetëm restauron njerëzimin e rënë, por edhe krijimin e rënë (shih Rom.8:18-25). E keqja në çdo nivel do të spastrohet!
Përpjekja e vazhdueshme e Perëndisë për të arritur njerëzimin e humbur me ungjillin lavdëron karakterin e hirshëm të Perëndisë. Gjykimet e enëve janë rezultat i së keqes kokëforte, jo të një Perëndie jodashës. Perëndia vetëm gjykon dhe izolon të keqen kur ajo refuzon sërish e sërish që të pendohet. Në shumë mënyra libri justifikon gjykimin e Perëndisë mbi njerëzimin e rënë dhe të papajtueshëm. Libri përfundon me një ftesë ungjilli (shih Zbu.22:17).

- D. Ky libër nuk duhet të shihet si një diagramë kronologjike e ndodhive, kohëve dhe mënyrave të Ardhjes së Dytë. Ai shpesh është interpretuar si “sekreti” i historisë perëndimore (shtatë kishat shihen si epoka). Çdo brez ka imponuar historitë e veta në simbolet apokaliptike; deri tani të gjithë kanë gabuar. Detajet e këtyre profecive do të jenë shumë më të dukshme ndaj vuajtjeve të brezit të fundit të besimtarëve nën Anti-Krishtin (shih 2 Thesalonikasve 2). Një interpretim fjalë për fjalë ka bërë që ky libër të shpërfilllet nga disa (Calvin [Kalvini]), nënvlerësohet nga të tjerë (Luther [Luteri], “as apostolik , as profetik”) dhe të mbitheksohet nga të tjerët (milenialistët).

ÇELËSAT E BOBIT PËR INTERPRETIMIN

- A. Ne kemi nevojë që të marrim parasysh aspektin e Dhjatës së Vjetër
1. Zhanri apokaliptik i Dhjatës së Vjetër është një lloj tejet simbolik letrar.
 2. Aludime të numërta janë nxjerrë nga Dhjata e Vjetër (disa vlerësojnë se nga 404 vargje 275 përfshijnë aludime ndaj teksteve të Dhjatës së Vjetër); kuptimi i këtyre simboleve është riinterpretuar nën dritën e situatës romake të shekullit të parë.
 3. Paralajmërimi profetik përdor ndodhitë aktuale për të paralajmëruar ndodhitë eskatologjike. Shpesh këto përmbushje historike të shekullit të parë tregojnë për përmbushjet finale historike të kohëve të fundit.
- B. Struktura e përgjithshme e librit na ndihmon të shohim qëllimin e autorit
1. Vulat, trumpetat dhe enët mbulojnë në thelb të njëjtën periudhë kohore (kapitujt 6-16). Zbulesa është një dramë me akte vijuese.
 2. Ekziston mundësia që kapitujt në Zbu.17-19 të jenë paralel me Zbu. 20-22. Pjesë të kapitullit 19 (p.sh., Zbu.19:11-21) janë të përmbledhura tek Zbu.20:7-10.
 3. Shih shtatë njësitë letrare tek Pohimet Hyrëse, C.
- C. Konteksti historik duhet të merret parasysh në çdo interpretim të librit
1. Prania e adhurimit të perandorit
 2. Persekutimi lokal në provincat lindore
 3. Bibla nuk mund të thotë atë që nuk ka pasur kurrë për qëllim të thotë. Interpretimi i Zbulesës duhet të lidhet me ditën e parë të Gjonit. Mund të ketë përmbushje apo aplikime të shumëfishta, por ato duhet të themelohen në shekullin e parë.
- D. Kuptimi i disa prej termave lakonikë është humbur për shak të rrethanave tona kulturore, gjuhësore dhe ekzistenciale. Me shumë mundësi vetë ndodhitë e fundit të kohërave do të hedhin dritë tek interpretimi i duhur i këtyre simboleve. Kini kujdes që të mos shihni të gjitha detajet e kesaj drame apokaliptike. Interpretuesit modernë duhet të kërkojnë të vërtetën kryesore në secilin nga këto vegime.
- E. Me lejoni të përmbledh disa nga elementët kyç interpretues
1. Origjinat historike të simbolizmit
 - a. Temat e Dhjatës së Vjetër, aludimet e Dhjatës së Vjetër
 - b. Mitologjia antike e Lindjes së Afërme
 - c. Letërsia apokaliptike e shkruar midis dy Dhjatave
 - d. Rrethanat greko-romake të shekullit të parë
 2. Mënyrat e autorit për të përkufizuar simbolizmin e tij
 - a. Bisedat me udheheqësit ëngjëllor
 - b. Himni i korit qiellor
 - c. Vetë autori pohon kuptimin
 3. Struktura e librit (paralelizmi dramatik)
- F. Ndihmë e mëtejshme
1. Dy komentatorët e mi të preferuar mbi Zbulesën janë George Eldon Ladd [Xhorxh Elldon Led] dhe Alan F. Johnson [Allan F. Xhonsion]. Ata nuk bien dakord. Ka shumë mosdakordësim midis studiuesve të perëndishëm, të edukuar, të sinqertë saqë nevojitet një fjalë paralajmërimi. Më lejoni të citoj Alan Johnson [Allan Xhonsion] në librin e tij *Commentary on Revelation [Komentarin mbi Zbulesën]* të publikuar nga Zondervan:
 “Nën dritën e përdorimit të përpunuar të imazheve dhe të vegimeve nga Zbu. 4:1 deri në fund të librit të Zbulesës dhe pyetja është se si ky material lidhet me kapitujt 1-3, nuk është e habitshme që komentatorët ndryshojnë shumë në mënyrën e tyre të trajtimit të këtyre kapitujve. Një problem është ai i interpretimit: *Çfarë* domethënie kanë imazhet dhe vizionet? Një problem tjetër përfshin

kronologjinë: *Kur* ndodhin këto ngjarje? Me tej, a i interpreton Gjoni imazhet e tij të shpeshta të Dhjatës së Vjetër në përputhje të plotë me ato të burimeve të tyre të Dhjatës së Vjetër, apo i interpreton ai këto imazhe në mënyrë të lirë? Çfarë është simbolike dhe çfarë është e drejtëpërdrejtë? Përgjigje për pyetje të tilla do të përcaktojnë përqsjen e interpretuesit. Duke qënë se pak nga këto pyetje janë përgjigje të mundshme dogmatike, ka nevojë për tolerancë në përqsjet divergjente duke shpresuar që Fryma të mund të përdorë diskutimet me mendje të hapura për të na drejtuar edhe më tej tek kuptimi i Apokalipsit” (fq.69).

2. Për një hyrje të përgjithshme tek marrëdhënia e Zbulesës me Dhjatën e Vjetër, unë rekomandoj librat e John P. Milton *Prophecy Interpreted* [Xhon P. Millton *Profecia e Interpretuar*] dhe John Bright *The Authority of the Old Testament* [Xhon Brajt *Autoriteti i Dhjatës së Vjetër*]. Për një diskutim të mirë të marrëdhënies së Zbulesës me Palin, unë rekomandoj librin e James S. Stewart *A Man In Christ* [Xhejms S. Stjuart *Një Njeri në Krishtin*].

CIKLI NJË I LEXIMIT (nga “[A Guide to Good Bible Reading](#)” [Një Udhëheqës për Lexim të Mirë Biblik])

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Prandaj lexoni të gjithë librin biblik përnjëherësh. Shprehni me fjalët tuaja tematikën qendrore të të gjithë librit.

1. Tematika e gjithë librit
2. Lloji i letërsisë (zhanri)

CIKLI DY I LEXIMIT (nga “[A Guide to Good Bible Reading](#)” [Një Udhëheqës për Lexim të Mirë Biblik])

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Prandaj lexoni të gjithë librin biblik përnjëherësh për një herë të dytë. Skiconi subjektet kryesore dhe shprehni secilin subjekt në një fjali të vetme.

1. Subjekti i njësisë së parë letrare
2. Subjekti i njësisë së dytë letrare
3. Subjekti i njësisë së tretë letrare
4. Subjekti i njësisë së katërt letrare
5. Etj.

ZBULESA 1:1-20

NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË*

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Hyrje dhe Përshëndetje	Hyrje dhe Bekime	Prologu	Hyrje	Prologu
1:1-3	1:1-3	1:1-2 1:3	1:1-3	1:1-3
	Përshëndetje Shtatë Kishave	Përshëndetje Hyrëse	Përshëndetje Shtatë Kishave	Adresim dhe Përshëndetje
1:4-5a	1:4-8	1:4-5a	1:4-5a	1:4-8
1:5b-7		1:5b-7	1:5b-6 5:7	
5:8		5:8	5:8	
Një Vegim i Krishtit	Vegimi i Birit të Njeriut	Vegimi Përgatitës	Një Vegim i Krishtit	Vegimi Paraprak
1:9-11	1:9-20	1:9-11	1:9-11	1:9-16
1:12-16		1:12-16	1:12-20	
1:17-20		1:17-20		1:17-20

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

* Edhe pse ato nuk janë të frymëzuara, ndarjet e paragrafëve janë kyç për të kuptuar dhe ndjekur qëllimin fillestar të autorit. Çdo përkthyes modern ka ndarë dhe përmbledhur paragrafë. Çdo paragraf ka një temë, të vërtetë apo mendim qëndror. Çdo version e mbërthen atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Ndërsa lexoni tekstin, pyeteni veten tuaj se cili përkthim i përshtatet më së miri të kuptuarit tuaj të ndarjes së subjektit dhe të vargjeve. Në çdo kapitull duhet të lexojmë Biblën së pari dhe të përpiqemi të identifikojmë subjektet e ndryshme të saj (paragrafët), dhe më pas të krahasojmë të kuptuarin tonë me versionet moderne. Vetëm pasi ne e kuptojmë qëllimin origjinal të autorit duke ndjekur logjikën dhe prezantimin e tij ne mund të kuptojmë vërtet Biblën. Vetëm autori origjinal është i frymëzuar – lexuesit nuk kanë asnjë të drejtë për të ndryshuar apo tjetërsuar mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë përgjegjësi në aplikimin e të vërtetës të frymëzuar në ditën dhe jetën e tyre.

Vini re se të gjitha termat dhe shkurtime teknike shpjegohen plotësisht në dokumentet e mëposhtme: [Brief Definitions of Greek Grammatical Structure](#) [Shpjegime të Shkurtra të Strukturës Gramatikore të Gjuhës Greke], [Textual Criticism](#) [Kriticizëm Tekstual], and [Glossary](#) [Fjalor].

NJOHURI KONTEKSTUALE PËR ZBULESËN 1:1-3:22

- A. Zbu.1:1-3 formon një prolog ndaj të gjithë profecisë. Tre vargjet e para na prezantojnë autorin, kohën, zhanrin dhe bekimin.
1. Autori është Gjoni (një emër i zakonshëm hebraik).
 2. Koha është së shpejti (Zbu.1:1b,3c).
 3. Mesazhi është komunikim në vegime, interpretuar nga ndërmjetësime ëngjëllore dhe i quajtur një “profeci” (Zbu.1:3). Tre kapitujt e parë janë shumë të ngajshëm me stilin normal të letrave të shekullit të parë.
 4. Bekimi është për ata që e dëgjojnë leximin e tij dhe i binden nxjitjes së tij për besnikëri në mes të persekutimit.
- B. Katër vargjet në vazhdim (4-7) i drejtohen dëgjuesve me anë të shtatë kishave (Zbu.1:11) dhe shtatë frymërave të tyre (shih Zbu. 1:4,20; 3:1; 4:5; 5:6). Ky seksion shenjohe nga
1. Karakterizimi i YHWH (Zbu.1:4)
 2. Karakterizimi i Jezusit (Zbu. 1:5,6b,7)
 3. Karakterizimi i besimtarëve (Zbu.1:6a)
 4. YHWH duke folur (Zbu.1:8)
- C. Vargjet 1:9-3:22 janë fjalët e fundit të Jezusit ndaj Kishës/Kishave të tij. Në Zbu.1:9-20 dhe në fillim të fjalës ndaj secilës nga shtatë kishave, Jezusi karakterizohet nga titujt e Dhjatës së Vjetër dhe përshkrimet e përdorura për YHWH.

STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 1:1-3

¹Zbulesa e Jezus Krishtit, që Perëndia ia dha për t’u treguar shërbëtorëve të tij gjërat që duhet të ndodhin për së shpejti dhe e bëri të ditur, duke ia dërguar nëpërmjet ëngjëllit të tij, shërbëtorit të vet Gjoni, ²i cili dëshmoi fjalën e Perëndisë dhe dëshminë e Jezus Krishtit, dhe të gjitha gjërat që pa. ³Lum ai që lexon dhe lum ata që dëgjojnë fjalët e kësaj profecie dhe që ruajnë ato që janë shkruar në të, sepse koha është afër.

1:1 “Zbulesa” Ky term grek *apocalypsis* gjendet vetëm këtu në libër. Ai e ka prejardhjen nga dy terma grek të cilët do të thonin “nga një vend i fshehur” ose “për të zbuluar diçka.” Është përdorur në disa kuptime (BAGD fq.92).

1. Zbulesa e së vërtetës – Luka 2:32; Rom. 16:25; 1 Kor. 14:6,26; Gal. 1:12; Efe. 1:17
2. Një sekret i bërë i njohur – Efe. 2:11-3:13
3. Një zbulesë nga vizion / ëndërr – 2 Kor. 12:1,7; Gal. 2:2
4. Sekrete të lidhura me fundin e kohërave – Luka 17:30; 1 Kor. 1:7; 2 Thess. 1:7; 1 Pjet. 1:7,13; 4:13; 5:1

Në këtë libër fjala Zbulesë do të thotë e vërtetë nga Perëndia përmes Jezus Krishtit e ndërmjetësuar përmes vegimeve dhe interpretimeve ëngjëllore. Ai fokusohet tek e tashmja e keqe dhe fitorja e ardhshme e drejtësisë përmes ndërhyrjes së mbinatyrshme të Perëndisë. Perëndia do t’i bëjë gjërat siç duhen!

☐ **“e Jezus Krishtit”** Kjo është ose një rasë gjinore objektive e lidhur me mesazhin për Jezus Krishtin (shih Gal.1:12), ose një rasë gjinore subjektive e lidhur me mesazhin e dhënë nga Jezus Krishti.

☐ **“Jezus”** Ky emër hebraik do të thoshte “YHWH shpëton”, “YHWH është shpëtim”, “YHWH sjell shpëtim”. Është i njëjti emër si në Dhjatën e Vjetër “Joshua [Jozue]”. “Jezus” vjen nga fjala në hebraisht për shpëtim “*hosea*”, e prapashtuar ndaj emrit të Perëndisë për besëlidhjen, “YHWH” (shih [Special Topic: Names for Deity](#), D

[Tema të veçanta: Emra për Perëndinë, D]. Ishte emri i destinuar nga Perëndia përmes një engjëlli të Perëndisë (shih Mat.1:21).

▣ **“Krisht”** Ky ishte ekuivalenti grek i termit hebraik *“messiah”*, që do të thoshte “një i vajosur”. Ai nënkuptonte “i thirrur dhe i pajisur nga Perëndia për një detyrë specifike.” Në Dhjatën e Vjetër tre grupe drejtuesish vajoseshin: priftërinjtë, mbretërit dhe profetët. Jezusi i përmbushi të tre këto tituj vajosjeje (shih Hebrenjve 1:2-3). Shih Special Topic: Messiah [Tema të veçanta: Mesia] më poshtë.

SPECIAL TOPIC: MESSIAH

▣ **“që Perëndia ia dha”** Jezusi as nuk mësoi dhe as nuk bëri diçka pa zbulesë apo leje nga Ati (shih Gjoni 3:11-13, 31-36; 4:34; 5:19-23,30; 6:38; 7:16; 8:26,28-29,40; 12:49-50; 14:10,24; 15:15). Nga ana teologjike kjo është karakteristikë e shkrimeve të Gjonit.

▣ **“për t’u treguar shërbëtorëve të tij gjërat që duhet të ndodhin për së shpejti”** Vini re se si ky paragraf hyrës reflektohet në Zbu.22:6-21. Kjo ishte një teknikë letrare (*inclusio*) e shekullit të parë.

NASB, NKJV **“gjërat të cilat duhet të ndodhin për së afërmi”**
NRSV **“ato që duhet të ndodhin së shpejti”**
TEV **“ato që duhet të ndodhin shumë shpejt”**
NJB **“ato që do të ndodhin së shpejti”**

Elementi i kohës është shumë i rëndësishëm për interpretimin e të gjithë librit sepse ai specifikisht pohon se mesazhi i Gjonit kishte një lidhje për ditën e tij dhe gjithashtu për të ardhmen. Termi “duhet” (*dei*) do të thoshte “ajo që është e lidhur, që është moralisht e nevojshme, që është e përshtatshme, apo e pashmangshme” (shih Zbu. 22:6). Shih Special Topic: Soon Return [Tema të veçanta: Rikthimi i shpejtë] më poshtë.

SPECIAL TOPIC: SOON RETURN

▣ **“e bëri të ditur”** Kjo është në të vërtetë “e shenjzuar” (*semainō*) (shih NKJV). “Shenjat” janë një nga strukturat letrare që Gjoni përdor për të komunikuar mesazhin e tij në Ungjill (*semeion*, shih Zbu.12:33; 18:32; 21:19). Kjo mund të ketë një lidhje me Dhjatën e Vjetër dhe profetët e Dhjatës së Vjetër (shih Isa. 7:11,14; 8:18; 19:20; 20:3; 37:30; 38:7,22; 55:13; 66:19; Jer. 10:2; 32:20-21; 44:29 dhe Ezek. 4:3; 14:8; 20:12,20). Fakti që ky libër është quajtur “një zbulesë” përmes “shenjave” dhe “profecive” na jep një ide për zhanrin letrar të këtij libri. Termi letrar modern “apokaliptik” i përdorur për të përshkruar një zhanër ishte i panjohur për Gjonin.

▣ **“tek shërbëtorët e Tij”** Titulli ka disa përdorime në libër.

1. Në këtë varg hyrës, kjo frazë i referohet autorit apostolik të librit.
2. Në vendet e tjera në libër përdoret shumësi për profetët / lajmëtarët / predikuesit e Perëndisë (shih Zbu. 10:7; 11:18; 22:6).
3. Megjithatë, në vende të tjera në libër titulli përdoret për të gjithë besimtarët (shih Zbu.7:3; 19:2,5; 22:3), i cili nënkupton se të gjithë besimtarët duhet të jenë dëshmitarë (shih Mat. 28:18-20; Kol. 4:6; 2 Tim. 2:24-25; 1 Pjet. 3:15). Jezusi është modeli që duhet ndjekur (shih Zbu. 1:5; 3:14; Gjoni 20:21)! Shumë do të vriten, ashtu siç Jezusi u vra (shih Zbu. 6:9; 12:17; 17:6; 18:24; 20:4). Kujtoni se tematika e librit është të qënurit besnik deri në vdekje! Unë (Jezusi) e kam mposhtur!

Special Topic: My Servant [Tema të veçanta: Shërbëtori im]

▣ **“Gjoni”** Ndryshe nga pjesa më e madhe e autorëve apokaliptik, Gjoni e identifikoi veten dhe e strukturoi hapjen e dëshmisë së tij profetike në formën e shtatë letrave (kapitujt 1-3). Disa e kanë mohuar autorësinë apostolike të librit të Zbulesës për shkak se ai është anonim në shkrimet e tij të tjera (ai e quan veten “dishepulli i dashur” në ungjillin e tij dhe “plaku” në letrën e II dhe të III të Gjonit), por e thërret veten e tij me emër tek Zbu.1:4, 9; 22:8.

1:2 “dëshminë e Jezus Krishtit” Si tek Zbu.1:1, kjo mund të jetë ose një rasë gjinore objektive, dëshmi për Jezusin, ose një rasë gjinore subjektive, dëshmi e dhënë nga Jezusi. Ndonjëherë tëk shkrimet e Gjonit ka një paqartësi të qëllim të cila i kombinon të dy domethëniet.

1:3 “Lum” Ky është bekimi i parë nga shtatë bekimet në këtë libër (shih Zbu. 1:3; 14:13; 16:15; 19:9; 20:6; 22:7,14). Fakti që ata që do ta lexojnë do të jenë të lumë e të bekuar tregon jo vetëm natyrën e frymëzuar të librit, por edhe lidhjen e tij me njerëzit e asaj kohe dhe të çdo kohe.

[Special Topic: Blessing \(OT\)](#) [Tema të veçanta: Bekimet (Dhjata e Vjetër)]

▣ **“ai që lexon”** Versioni i përkthimit NRSV shton “me zë të lartë”, duke nënkuptuar një lexim publik (shih 1 Tim. 4:13). Leximi i Shkrimeve në kongregacion bëhej fillimisht nga anëtarë të trajnuar në mënyrë të veçantë të kishës si në sinagoga (*cantor*). Kisha përshtati format e adhurimit të sinagogës së hershme (shih Luka 4:15; Veprat e Apostujve 13:15; Kol. 4:16; 1 Thes. 5:27). Ne kemi një konfirmim historik të leximit në publik të Shkrimeve nga Justin Martyr [Justin Martiri], viti 167 pas Krishtit, i cili përmendi se kisha lexonte një pjesë të Ungjijve dhe një pjesë nga Profetët.

▣ **“dhe lum ata që dëgjojnë... dhe që ruajnë”** Ky dëgjim dhe bërje (të dyja janë në kohë të tashme) janë thelbi i termit në hebraisht “*Shema*” (shih Ligji i Përtërirë 5:1; 6:4-6; 9:1; 20:3; 27:9-10; Luka 11:28). Vini re natyrën e kushtëzuar të bekimit. Ata të cilët e dëgjojnë duhet të përgjigjen. Kjo formë beslidhjeje e pohimit “nëse... atëherë” gjendet si në Dhjatën e Vjetër ashtu edhe në Dhjatën e Re. Bekimi lidhet jo vetëm me njohurinë por edhe me stilin e jetesës.

▣ **“fjalët e kësaj profecie”** Ky term i drejtohet edhe përbërjes hyjnore të këtij libri edhe zhanrit të tij letrar. Ky libër është një kombinim i një letre (kapitujt 1-3), një prezantimi apokaliptik (vulat, trumpetat, enët) dhe një profecie (shih Zbu. 22:7,10,18,19). Është e rëndësishme të mbajmë mend se “profecia” kishte dy qëllime:

1. T’i adresohet dëgjuesve aktual me mesazhin nga Perëndia
 2. Të tregonte se si ndikonte besimi aktual tek ndodhitë e së ardhmes
- Profecia është edhe proklamata edhe parashikim. Shih Artikuj Hyrës.

▣ **“sepse koha është afër”** Kjo sërish tregon lidhjen e profecisë me ditën e saj (shih Zbu. 22:10, një shembull tjetër është tek Romakëve 16:20).

[Special Topic: Soon Return](#) [Tema të veçanta: Rikthimi i shpejtë]

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 1:4-7

⁴ Gjoni, shtatë kishave që janë në Azi: hir për ju dhe paqe nga ana e atij që është dhe që ishte dhe që do të vijë: edhe nga të shtatë frymërat që janë përpara fronit të tij, ⁵ dhe nga Jezu Krishti, dëshmitar besnik, i parëlinduri prej së vdekurish dhe Princ i mbretërve të dheut. ⁶ Atij që na deshi dhe na lau nga mëkatet tona në gjakun e tij, dhe na bëri mbretër dhe priftër për Perëndinë dhe Atin e tij, atij i qoftë lavdi dhe pushtet në shekuj të shekujve. Amen. ⁷ Ja, ai vjen me retë dhe çdo sy do ta shohë, edhe ata që e tejshpuan; dhe të gjitha fiset e dheut do të vajtojnë për të. Po, amen.

1:4 “shtatë kishave” Arsyeja e saktë pse adresohen vetëm shtatë kisha nuk është e sigurtë. Ka disa teori:

1. Disa kanë pohuar se këto ishin kishat me të cilat Gjoni kishte një marrëdhënie të veçantë shërbese
2. Të tjerë kanë pohuar se ato formojnë një udhë postare në provincën romake të Azisë
3. Numri shtatë kishte një domethënie të madhe për Hebrenjtë, sidomos në literaturën apokaliptike ndërbiblike

Ishte një numër perfeksioni që nga përdorimi i tij në kohën e Zanafillës 1. Prandaj, është përdorur me shumë mundësi si në kuptimin e drejtëpërdrejtë – Gjoni iu shkroi disa kishave të cilat formonin udhën postare romake në

Azinë e Vogël – dhe në mënyrë simbolike si një mënyrë referimi ndaj të gjitha kishave të të gjitha ditëve apo kohëve. Shih Temat e veçanta më poshtë:

[SPECIAL TOPIC: SYMBOLIC NUMBERS IN SCRIPTURE](#) [Tema të veçanta: Numra simbolikë në Bibël]
[SPECIAL TOPIC: CHURCH \(EKKLESIA\)](#) [Tema të veçanta: Kisha (Eklezia)]

▣ **“në Azi”** Kjo i referohet pjesës së fundme perëndimore të shtetit të Turqisë në ditët e sotme, e cila ishte, në një pjesë të madhe, shteti i vjetër i Frigjisë, i cili u bë provinca romake e “Azisë së Vogël.”

▣ **“hir në ju dhe paqe”** Kjo ishte forma tradicionale e përshëndetjes e cila shfaqet kaq shpesh tek shkrimet e Palit. Shumë studiues pohojnë se të krishterët kanë ndryshuar mënyrën tradicionale greke letrare të të përshëndeturit nga “*charein*” (shih Jakobi 1:1) në përshëndetjen e krishterë që tingëllon në mënyrë të ngjashme “*charis*”, që do të thoshte “hir”.

“Paqe” mund t’i referohet termit hebraik “*shalom*”, duke kombinuar në këtë mënyrë përshëndetjet në gjuhën greke dhe hebraike për t’u lidhur me të dy grupet e njerëzve në kishat. Megjithatë, ky është vetëm një spekulim.

▣ **“nga ana e atij që është dhe që ishte dhe që do të vijë”** Ky është dukshëm një titull për Perëndinë e pandryshueshëm të Besëlidhjes (shih Ps. 102:7; Mal. 3:6; Jakobi 1:17). Forma e tij gramatikore është e çuditshme në gjuhën greke por mund të reflektojë prejardhjen nga gjuha aramaike. Faza e drejtëpërdrejtë është “nga Ai që është, nga Ai që ishte, dhe nga Ai që do të vijë” (shih Zbu. 4:8). Kjo frazë reflekton titullin e besëlidhjes së Dhjatës së Vjetër “Unë jam” (YHWH, shih Eksodi 3:14, shih [SPECIAL TOPIC: NAMES FOR DEITY](#) [Tema të veçanta: Emra të Perëndisë]). Kjo frazë përdoret për Perëndinë At tek Zbu. 1:4 dhe 8, dhe për Jezus Krishtin tek Zbu. 1:17 dhe 18 (shih Heb. 13:8). Transferimi i qëllimit të titujve nga YHWH tek Jezusi ishte një nga mënyrat që autorët e Dhjatës së Re pranuan Hyjësinë e Jezusit.

Kjo frazë e trefishtë e Perëndisë si e shkuar, e tashme dhe e ardhme modifikohet tek Zbu. 11:17 (p.sh., trumpetat) dhe 16:5 (p.sh., enët), që është Ardhja e Dytë në fund të trumpetave, për të justifikuar të tashmen dhe të shkuarën sepse e ardhmja (fundi i kohërave) po agon.

▣ **“dhe nga Jezu Krishti, dëshmitar besnik”** Kjo është fraza e parë nga tre frazat që përshkruajnë Jezus Mesian. Vargjet hyrëse janë paralele me Zbu. 20:6-21. “Besnik” kishte një domethënie të lidhur me Dhjatën e Vjetër për dikë që është besnik, i vërtetë dhe i besueshëm (shih Isa. 55:3-5). Duke qënë se Fjala e shkruar e Perëndisë (Bibla) është e besueshme, po kështu është edhe zbuluesja e tij e fundit, Fjala e Gjallë, Jezusi (shih Zbu. 3:14). Ungjilli është një mesazh për t’u besuar, që një person ta pranojë dhe që jeta e atij personi të jetohet. Faza në greqisht, “dëshmitar besnik” mund të nënkuptojë

1. “Dëshmitari im, Besniku im” – si dy fraza, shih zbu. 2:13 (duke shtuar përemrin vector)
2. “Dëshmitari besnik dhe i vërtetë”, shih Zbu. 3:14 (duke shtuar “dhe i vërtetë”)

▣ **“i parëlinduri prej së vdekurish”** Shih [SPECIAL TOPIC: FIRSTBORN](#) [Tema të veçanta: I parëlinduri]

▣ **“dhe Princi i mbretërve të dheut”** Kjo frazë, ashtu sikurse fraza paraardhëse, është një aludim për Ps. 89:27 (shih Ps. 72:11; Isa. 48:23), i cili flet për Jezusin si Mesia i premtuar. Ai gjithashtu reflekton reagimin e Gjonit ndaj

1. Adhurimit ndaj perandorit në provincat lindore të Perandorisë Romake
2. Përdorimit të frazës mbretërore mesopotamiane “Mbret i mbretërve” (shih Zbu. 11:15; 17:14; 19:16)

[Special Topic: Old Testament Titles of the Special Coming One](#) [Tema të veçanta: Tituj të Dhjatës së Vjetër për Të Veçantin që Do të Vijë]

▣ **“Atij që na do (NASB)”** Kjo është në një kohë të tashmen, duke nënkuptuar që “Jezusi vazhdon të na dojë.” Ky pranim është shumë i rëndësishëm nën dritën e dobësive dhe dështimeve të pesë prej shtatë kishave (shih kapitujt 2-3).

▣ **“dhe na çliroi nga mëkatet tona (NASB)”** Kjo është në të shkuarën. Versionet Vulgate dhe Coptic, dhe gjithashtu disa dorëshkrimeve të vogla greke, dhe versioni King James (Mbretit Xhejms) kanë foljen “lau” (*louō*)

e cila shqiptohet ekzaktësisht sikurse fjala çliroi (*luō*). Skribët antikë prodhonin tekste të Dhjatës së Re duke pasur një person që e lexonte me zë të lartë ndërkohë që të tjerët e shkruanin.

Termi “çliroi” (me shtesat) shafqet në dorëshkrimet e greqishtes së lashtë P¹⁸, κ* (me parashtesë), xi², A, dhe C, ndërsa “lau” gjendet vetëm në dorëshkrimet e mëvonshme uniciales, P (shekulli i gjashtë) dhe 046, gjithashtu edhe në disa dorëshkrime të vogla (skripte të greqishtes së kohës). Prandaj, “çliruar” apo “liruar” është termi që preferohet në lexim. Versioni UBS⁴ i jep termin “çliruar” një shkallëzim “të caktuar.”

[Special Topic: Textual Criticism](#) [Tema të veçanta: Kriticizëm tekstual]

▣ **“në gjakun e tij”** Ky është dukshëm një aludim ndaj pajtimit sakrifikues (shih Levetiku 1-7) dhe të dërguar të Jezus Krishtit (shih Zbu. 5:9; 7:14; 12:11; Marku 10:45; 2 Kor 5:21; Isa. 52:13-53:12). “Me anë të gjakut të Tij” është një e vërtetë e përsëritur në ungjijtë (shih Rom. 3:25; Efe. 1:7; 2:13; Kol. 1:20; 1 Pjet. 1:18-19). Në një mënyrë, në misterin e Perëndisë, drejtësia dhe mëshira e tij për të gjithë njerëzimin e rënë u takuan në vdekjen zëvendësuese të Jezusit (shih Heb. 9:11-28). Shih tema të veçanta më poshtë.

[SPECIAL TOPIC: THE KERYGMA OF THE EARLY CHURCH](#) [Tema të veçanta: *Kerygma* e kishës së hershme]

1:6 “na bëri” Kjo është një formë aoriste aktive treguese. Ashtu sikurse Jezusi na ka çliruar nga mëkatet (Zbu. 1:5), Ai gjithashtu na ka bërë një mbretëri priftërinjsh për të përfaqësuar Atë!

NASB “një mbretëri, priftër për Perëndinë e Tij”

NKJV “mbretër dhe priftër për Perëndinë e Tij”

NRSV “një mbretëri, priftër që i shërbejnë Perëndisë së Tij”

TEV, NJB “një mbretëri priftërinjsh për t’i shërbyer Perëndisë së Tij”

Ky është një aludim për termat e përdorur në Dhjatën e Vjetër për Izraelin tek Eksod. 19:6 dhe Isa. 61:6, ku kombi konsiderohej të ishte një mbretëri priftërinjsh. Perëndia zgjodhi Abrahamin, më pas zgjodhi Izraelin, më pas zgjodhi një botë të humbur (shih Zan. 3:15; 12:3). Izraeli duhej të ishte një komb dëshmtarësh (dmth, priftërinjsh) por ata dështuan në këtë detyrë të përzgjedhur ungjillore për ta (shih Ezek. 36:22-38). Prandaj, Perëndia zgjodhi Kishën për të arritur botën (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8). Të njëjtat fraza të cilat u përdorën për Izraelin tanimë përdoren për Kishën (shih Gal. 3:29; 6:16; Fili. 3:3; 1 Pjet. 2:5,9; Zbu. 1:6; 5:10; 20:6).

Është e rëndësishme të vëmë re theksin biblik të bashkësisë tek “priftëria e besimtarëve.” Krishtërimi Perëndimor e ka mbitheksuar vendin dhe rolin e individit dhe ka nënvlerësuar bashkësinë biblike. Metafora e Dhjatës së Re e trupit të Krishtit (shih 1 Korintasve 12) është një metaforë e ngjashme. Titulli në Dhjatën e Vjetër nuk ka qënë kurrë një justifikim që besimtarët të mbrojnë liritë e tyre individuale. Ky theksim zhvillohet nga vështirësitë historike të hasura midis Martin Luterit dhe Kishës Katolike të kohës së Tij. Fokusi i këtij konteksti është ungjillizimi (shih Zbu. 1:7), duke përfshirë çdo besimtar, duke u përpjekur të arrijë çdo qenie njerëzore të humbur dhe në nevojë, njeri i krijuar në shëmbëlltyrën e Perëndisë dhe për të cilin Krishti vdiq (shih Gjoni 3:16; 1 Tim. 2:4; 2 Pet. 3:9; 1 John 2:2; 4:14). Shih Tema të veçanta më poshtë.

[SPECIAL TOPIC: CHRISTIANITY IS CORPORATE](#) [Tema të veçanta: Krishtërimi është i përbashkët]

▣ **“për Perëndinë dhe Atin e Tij”** Kjo frazë mund të duket se e ul vlerën e hyjnësisë së plotë të Birit, por ajo është një mënyrë e të pranuarit të nënshtrimit të Jezusit ndërkohë që ishte i mishëruar. E njëjta frazë përdoret nga Pali tek Rom. 15:6. Ndjesia e barazisë mund të shihet në Zbu. 3:21; 14:1.

[Special Topic: The Trinity](#) [Tema të veçanta: Triniteti]

[Special Topic: The Fatherhood of God](#) [Tema të veçanta: Atësia e Perëndisë]

▣ **“Atij i qoftë lavdi dhe pushtet”** Termi “lavdi” është një term komercial në Dhjatën e Vjetër (që përdorej për të matur në blerje) që do të thoshte “të ishte i rëndë” (psh. ari) ishte e çmuar. Termi u përdor për shkëlqimin, madhështinë, shenjtërinë e Perëndisë, nga *Shekinah* Reja e Lavdisë tek Eksodi. Lavdia shpesh i atribuohet

Perëndisë At në Dhjatën e Re (shih Rom.11:36, 6:27; Efe. 3:21; Fili. 4:20; 1 Tim. 1:17; 2 Tim. 4:18; 1 Pjet. 4:11; 5:11; 2 Pjet. 3:18; Juda 25; Zbu. 1:6; 5:13; 7:12). Shih [Special Topic: Glory \(doxa, NT\)](#) [Tema të veçanta: Lavdia (*doxa*, DhjR)].

Termi “pushtet” që i adresohet Perëndisë At, është teologjikisht i ngjashëm me nënshtrimin e Birit (shih Gjoni 17). Jezusi është agjenti i Atit në të gjitha gjërat, por qëllimi i tij është përlëvdimi i plotë i Atit (shih 1 Kor. 15:27-28).

▣ **“në shekuj të shekujve”[†]** Kjo fjalë për fjalë është “në kohërat e kohërave”. Ky përdorim i dyfishtë i *aiōnos*, NJËJËS dhe më pas SHUMËS, është i zakonshëm tek Zbulesa (shih Zbu. 1:18; 4:9,10; 5:13; 7:12; 10:6; 11:15; 15:7; 19:3; 20:10; 22:5). Është e habitshme që dëshmitarët e hershëm grekë e hiqnin pjesën e dytë (MSS P¹⁸, A, P). UBS⁴ nuk mund të vendosë se cili është leximi original. Shih Tema të veçanta më poshtë.

[SPECIAL TOPIC: FOREVER \(GREEK IDIOM\)](#) [Tema të veçanta: Përgjithmonë (Shprehje në greqisht)]

[SPECIAL TOPIC: FOREVER \('OLAM\)](#) [Tema të veçanta: Përgjithmonë ('*olam*)]

▣ **“Amen”** Kjo është një formë e fjalës në hebraisht në Dhjatën e Vjetër për “besim” (shih Hab. 2:4). Etimologjia e saj origjinale ishte “të jësh i vendosur ose i sigurtë”. Megjithatë, nënkuptimi ndryshoi në pranim (shih 2 Kor. 1:20). Ajo përdorej metaforikisht për dikë që ishte besnik, i besueshëm, i qëndrueshëm (një titull për Jezusin tek Zbu. 3:14, shih 2 Kor. 1:20). Shih Tema të veçanta më poshtë.

[SPECIAL TOPIC: AMEN](#) [Tema të veçanta: Amen]

1:7 “Ja, Ai vjen me retë” Ky varg mund të ketë qënë një thirrje nga engjëlli i Zbu. 1:1. Është dukshëm një reference për Ardhjen e Dytë të Krishtit. Shih Tema të veçanta më poshtë.

[SPECIAL TOPIC: COMING ON THE CLOUDS](#) [Tema të veçanta: Ardhja mbi retë]

▣ **“dhe çdo sy do ta shohë”** Kjo duket se nënkupton rikthimin trupor, fizik, të dukshëm dhe universal të Krishtit, jo një rrëmbim sekret të besimtarëve. Sipas mendimit tim, Bibla nuk na mëson kurrë për një rrëmbim apo ardhje sekrete. Ato vargje tek Ungjijtë (shih Mat. 24:37-44; Luka 17:22-37) që shpesh përdoren për të mbështetur një rrëmbim sekret, në mënyrë kontekstuale lidhen me një krahasim me ditët e Noeut. Këto tekste paraqesin papritshmërinë e paparashikuar të ardhjes së Tij. Në ditën e Noeut, ai që u mor u shkatërrua! Bëni kujdes teksta vërtetoni tekstin në pasazhe të shkurtra të Biblës duke i nxjerrë nga rrethanat origjinale të frymëzuara dhe i përdorni ato për të mbështetur sistemin tuaj të presupozuar teologjik eskatologjik!

▣ **“edhe ata që e tejshpuan; dhe të gjitha fiset e dheut do të vajtojnë për Të”** Ky është një aludim për Zak. 12:10,12 (shih Gjoni 19:37). Ky është një shembull i mirë se si Gjoni ripunoi tekste të Dhjatës së Vjetër për t'i përshtatur ato me situatat romake (një ri-interpretim i llojit hebraik i quajtur *peshet*). Teksti i Zakarias është një pedanë kërcimi për aplikimin e ri të Gjoni. Tek Zakaria, teksti i referohet banorëve të Jeruzalemit të cilët vajtojnë mbi “të tejshpuarin”, por këtu Gjoni e përdor për drejtuesit Romakë dhe Hebrenj të cilët kryqëzuan Krishtin (shih Gjoni 19:37). Përemri “ata” në tekstin hebraik mazoretik ndryshohet në “të gjithë fiset e tokës” (shih Mat. 24:30, kjo frazë nuk është nga Septuaginti). Gjithashtu, “vajtojnë”, në kontekstin e pasazhit të Zakarias shpesh interpretohet si i lidhur me Romakëve 11, ku Hebrenjtë pendohen dhe i besojnë Jezus Mesias. Megjithatë, në Zbu. 1:7 vajtimi nuk është për pendesë, por për shkak se gjykimi i Perëndisë ka rënë mbi jobesimtarët e të gjithë fiseve (shih Mate. 24:30). Konteskti tek Zakaria aludon për gjykimin e kohëve të fundit të kombeve duke përmendur “rrafshinën e Megiddo-s,” që në hebraisht quhet Armageddon (shih Zak. 12:11; 2 Kron.35:22 dhe Psalmi 2; Zbu. 16:16), vendi i betejës së fundit të kohërave midis Perëndisë dhe popullit të Tij dhe Satanit dhe popullit të tij, kombeve jobesuese. Shih Tema të veçanta më poshtë.

[SPECIAL TOPIC: GRIEVING RITES](#) [Tema të veçanta: Rite vajtimi]

[†] Përkthimi në anglisht është “përgjithmonë”. (Shënim i përkthyesit)

▣ “Kështu u bëftë, Amen[‡].(NASB)” Kjo është fjala në greqisht për pranim (*nai*) dhe në hebraisht për pranim (*amen*) të vendosura krahas për krahas për t’i theksuar (shih Zbu. 22:20).

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 1:8

⁸“Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi,” thotë Zoti “që është dhe që ishte dhe që vjen, i Plotfuqishmi.”

1:8 Vetë YHWH fletë në këtë varg, duke mbrojtur të vërtetën e pohimeve të mëparshme mbi Jezusin. Këtu kombinohen katër titujt për Të me një aludim ndaj një titulli të pestë ose edhe të gjashtë. Me sa duket, tek Zbu. 1:8 ishte Perëndia teksa jepte mbështetjen e Tij personale ndaj pohimit të mësipërm të këtyre emrave madhështorë.

1. “Unë jam,” që është një aludim për emrin e besëlidhjes YHWH (shih Eksod. 4:14), një formë foljeje “të jesh”. Jezusi e përdori këtë për veten e Tij (shih Gjoni 8:56-59).
2. “Alfa dhe Omega” janë gërma e parë dhe e fundit e alfabetit grek që nënkupton se Perëndia është fillimi dhe mbarimi, një kontrollues i historisë (shih Isa. 44:6; Zbu. 21:6); ky titull gjithashtu përdoret për Jezusin tek Zbu. 1:17 dhe 22:13.
3. “Zoti” është përkthimi modern i YHWH (titulli “Zoti” [*kurios*] në Dhjatën e Re reflekton këtë titull të Dhjatës së Vjetër).
4. “Perëndia” tek Zan. 2:4, YHWH, dhe *Elohim* kombinohen (ZOTI Perëndi) si emër për hyjësinë. *El* është një emër i përgjithshëm për perëndi në Lindjen e Afërme, nga rrënja “të jesh i fortë.”
5. “Ai që është dhe që ishte dhe që vjen” është një frazë e përdorur më herët tek Zbu. 1:4, e cila flet për Perëndinë e pandryshueshëm dhe të përjetshëm (shih Ps. 102: 27; Mal. 3:6; Jakobi 1:17). Kjo frazë përdoret për Perëndinë At, YHWH, tek Zbu. 1:4 dhe 8 dhe për Jezusin, Perëndinë Bir tek Zbu. 1:17,18 dhe 22:13 (shih Heb. 13:8).
6. “I plotfuqishmi” i cili ishte një term në Dhjatën e Vjetër (a) “*El-Shaddai*,” emri patriarkal për Perëndinë (shih Eksod. 6:3) ose (b) “YHWH *Sabaoth*,” nga LXX's “Zoti Perëndi i Plotfuqishëm”. Ai gjendet shpesh në këtë libër (p.sh., *pantokratōr*, shih Zbu. 4:8; 11:17; 15:3; 16:7,14; 19:6,11; 21:22), por vetëm një herë në librat e tjerë të Dhjatës së Re (p.sh., 2 Kor. 6:18). Shih [Special Topic: Shaddai](#) [Tema të veçanta: Shaddai]

Një dorëshkrim i hershëm grek, aleph (א*), dhe disa dorëshkrime të tjera shtojnë frazën “fillimi dhe mbarimi” pas “Alfa dhe Omega.” Skribët e vendosën atë nga Zbu. 21:6, por me shumë mundësi nuk është pjesë origjinale e tekstit origjinal në greqisht të frymëzuar. UBS⁴ e klasifikon përjashtimin e tij si “të sigurtë.” Shih Tema të veçanta më poshtë.

[SPECIAL TOPIC: NAMES FOR DEITY](#), [Tema të veçanta: Emra për Perëndinë] C. dhe D.

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 1:9-11

⁹Unë, Gjoni, që jam edhe vëllai juaj dhe pjestar bashkë me ju në pikëllimin, në mbretërinë dhe në durimin e Jezu Krishtit, isha në ishullin që quhet Patmos, për fjalën e Perëndisë dhe për dëshminë e Jezu Krishtit. ¹⁰Isha në Frymë ditën e Zotit dhe dëgjova pas meje një zë të madh si nga një bori, ¹¹që thoshte: “Unë jam Alfa dhe Omega, i pari dhe i fundit, dhe çfarë sheh, shkruaji në një libër dhe ua dërgo shtatë kishave që janë në Azi: në Efes, në Smirnë, në Pergam, në Tiatirë, në Sardë, në Filadelfi dhe në Laodice.”

1:9-20 Ky është vizioni i parë i Gjoni për Krishtin e ringjallur, të ngritur lart, të përlevduar. Të njëjtat përshkrime përdoren për t’iu drejtuar shtatë kishave (kapitujt 2-3). Gjoni tregon identifikimin e tij me lexuesit duke (1)

[‡] Në versionin në shqip përkthimi është: Po. Amen. (Shënim i përkthyesit)

përdorur termin “vellai juaj” dhe (2) duke përmendur eksperiencën e tij të vuajtjes, mbretërisë dhe durimit. Këto terma kyçe – trazira, mbretëria dhe këmbëngulja – gjithashtu janë shembuj të jetës së Jezusit të cilën lexuesit, sikurse dhe Gjoni, duhet ta imitojnë (shih Gjoni 16:33; Veprat e Apo. 14:22; Rom. 8:17).

Një arsye pse interpretuesit modern nuk e kuptojnë Zbulesën është sepse ne nuk e kemi përjetuar kurrë persekutimin dhe sfidat e botës romake të shekullit të parë. Zbulesa është një fjalë për besimtarët që janë duke kaluar dhimbje, vdekje dhe frikë.

1:9 “pjestar bashkë me ju në pikëllim” Shih shënimin tek Zbu. 7:14.

[Special Topic: Tribulation](#) [Tema të veçanta: Pikëllimi]

▣ “mbretërinë” Shih [SPECIAL TOPIC: THE KINGDOM OF GOD](#) [Tema të veçanta: Mbretëria e Perëndisë]

▣ “durimin” Kjo fjalë përdoret tek Zbu. 2:2,3,19; 3:10; 13:10; 14:12.

[SPECIAL TOPIC: PERSEVERANCE](#) [Tema të veçanta: Durimi]

▣ “në ishullin që quhet Patmos” Romakët i përdornin këta ishuj të vegjël në afërsi të bregut të Azisë së Vogël për të dëbuar të burgosurit politikë (shih Tacitus’ *Annals* [*Kronikat e Tasitit*], 3.68; 4.30; 15.71). Me sa duket, Gjoni ishte dëbuar në këtë ishull të vogël, 37 milje nga Miletusi. Ishulli kishte një formë gjysëm hëne, ishte përballë me lindjen, dhjetë milje i gjatë dhe gjashtë milje i gjerë.

▣ “për fjalën e Perëndisë dhe për dëshminë e Jezu Krishtit” Ka dy interpretime të mundshme në këtë frazë. Ajo mund t’i referohet (1) predikimit të Gjoni me ungjillin ose (2) Gjoni teksa merr zbulesën. Ne kemi disa referenca historike ndaj dëbimit politik të Gjoni.

1. Tertuliani, *On the Prescription of Heretics* [Mbi Porosinë e Heretikëve], 36
2. Origeni, *Homilies on Matthew* [Predikime mbi Mateun]
3. Klementi i Aleksandrisë, *The Rich Man's Salvation* [Shpëtimi i Pasanikut], 47
4. Eusebiusi, *Ecclesiastical History* [Historia Ekleziastike], III.20.8-9; dhe (4) Jeromi, *Concerning Illustrious Men* [Në Lidhje me Njerëzit e Sëmurë] 9.

1:10 “Isha në Frymë” Kjo është një frazë e veçantë që ndan vegimet e ndryshme që mori Gjoni (shih Zbu. 1:10; 4:2; 17:3; 21:10). Duket se i referohet një gjendjeje si në ekstazë gjatë së cilës u dha zbulesa (shih Veprat e Apo. 10:10; 22:17; 2 Kor. 12:1 e në vazhdim). Kjo është një karakteristikë e letërsisë apokaliptike hebraike.

[Special Topic: Spirit \(pneuma\) in the NT](#) [Tema të veçanta: Fryma (pneuma) në Dhjatën e Re]

▣ “ditën e Zotit” Kjo është e vetmja referencë në Bibël, që i referohet të dielës, e cila përdor këtë frazë. E diela konsiderohej si “dita e parë e javës” tek Gjoni 20:19; Veprat e Apo. 20:7 dhe 1 Kor. 16:2.

▣ “një zë të madh si nga një bori” Kjo frazë përdoret në kontekstin e Perëndisë teksa jep Dhjetë Urdhërimet mbi malin Sinai (shih Eksod. 19:16). Megjithatë, për shkak të Zbu. 1:12a dhe 4:1, mund t’i referohet zërit të një ëngjëlli. Meditimi ëngjëllor është karakteristikë e letërsisë apokaliptike hebraike. Zbulesa flet më shumë për ëngjëjt se sa çdo libër tjetër në Dhjatën e Re.

[SPECIAL TOPIC: HORNS USED BY ISRAEL](#) [Tema të veçanta: Bori të përdorura nga Izraeli]

1:11 “në një libër” Ky është termi grek *biblion*. Ai përdoret në kuptimin e një libërthi apo dorëshkrimi. Më vonë u bë një term për një libër kodesh apo libër. Gjoni u urdhërua që të mbante shënim vegimet e tij. Ato janë një vetëzbulesë e Hyjesisë. Ato nuk janë për përfitim personal të Gjoni, por për kishën. Një karakteristikë e letërsisë apokaliptike është se ajo është shkruar në një zhanër tejet të strukturuar, nuk është dhënë gojarisht, sikurse profecitë e Dhjatës së Vjetër. Një libër apo dorëshkrim shfaqet në mënyrë të përsëritur në letërsinë apokaliptike hebraike si një mënyrë për të transmetuar mesazhin tek lexuesit e së ardhmes.

▣ **“ua dërigo shtatë kishave”** Urdhëri për këto kisha ndiqte një shteg postar romak i cili nisi dhe përfundoi në Efes. Libri qarkor i Palit i njohur si “Efesianëve” mund të ketë udhëtuar nëpër të njëjtin shteg. Zbulesa e Perëndisë nuk është kurrë vetëm për një individ, por për popullin e Perëndisë, për trupin e Krishtit!

[Special Topic: Symbolic Numbers in Scripture](#), [Tema të veçanta: Numra simbolik në Bibël] #4

▣ Përkthimi King James [i Mbretit Xhejms] shton frazën “unë jam Alfa dhe Omega” sërish, por nuk ka asnjë dorëshkrim në greqishten e lashtë që të mbështesë këtë shprehje në këtë varg.

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 1:12-16

¹²Dhe u solla të shoh zërin që foli me mua. Dhe, si u solla, pashë shtatë shandanë ari ¹³dhe, në mes të shtatë shandanëve, një të ngjashëm me një Bir njeriu, të veshur me një petk të gjatë deri te këmbët dhe ngjeshur me një brez ari në gjoks. ¹⁴Dhe kryet e tij dhe flokët e tij ishin të bardhë si lesh i bardhë, si bora, dhe sytë e tij e ngjanin një flakë zjarri. ¹⁵Dhe këmbët e tij ngjanin me bronz të kulluar, si të skuqur në furrë dhe zëri i tij si zë shumë ujërash. ¹⁶Dhe kishte në dorën e tij të djathtë shtatë yje dhe nga goja e tij dilte një shpatë e mprehtë, me dy tehe, dhe fytyra e tij si dielli që ndrin me forcën e tij.

1:12 “pashë shtatë shandanë ari” Kjo nuk i referohet Menores (shtatë shandanët – candelabrum) të cilët ishin në Tabernakull (shih Eksod. 25:31-40) dhe as dhe as shandanëve të Zak. 4:2. Këta shandanë të ndarë dhe të veçuar ishin një mënyrë simbolike për t’iu referuar shtatë kishave (shih Zbu. 1:20, 2:1).

[Special Topic: Seven Spirits in Revelation](#) [Tema të veçanta: Shtatë Frymërat në Zbulesë]

1:13-18 Në këtë përshkrim të Jezusit me shumë figura, ka dy prejardhje të mundshme nga Dhjata e Vjetër: (1) YHWH, por edhe (2) ëngjëlli i Danielit 10.

1:13

NASB “një të ngjashëm me Birin e Njeriut”

NKJV “Një të ngjashëm me Birin e Njeriut”

NRSV “një të ngjashëm me një Biri Njeriu”

TEV “ngjasonte si një qenie njerëzore”

NJB “një të ngjashëm me një Biri Njeriu”

Vini re variacionin që ekziston në gërmat kapitale. Arsyeja është paqartësia e këtij termi. Në Dhjatën e Vjetër ishte një shprehje përshkruese për një qenie njerëzore (shih Ps. 8:4; Ezek. 2:1 dhe shumë të tjera). Megjithatë, gjithashtu është përdorur tek Dan. 7:13 dhe me shumë mundësi tek Ezek. 1:26 për t’iu referuar një Mesie njerëzor, hyjësia e të cilit (shih Zbu. 2:18, ku ky personazh quhet “Bir i Njeriut”) nënkuptohet sepse

1. Ai shfaqet përpara Perëndisë
2. Ai vjen mbi retë e qiellit
3. Atij i është dhënë mbretëria e përjetshme.

Jezusi përdori këtë term për t’iu referuar Vetvetes sepse nuk kishte asnjë përdorim rabinik, asnjë nënkuptim nacionalist apo ushtarak. Ky term kombinonte aspektin njerëzor dhe atë hyjnor të personit të Jezusit (shih 1 Gjonit 4:1-3; Gjoni 1:1-2,14).

Vini re se NKJV dhe NRSV kanë “me Birin e Njeriut” ndërsa NASB, TEV dhe JB kanë “me një Bir Njeriu”. Në tekstin në greqisht nuk ka asnjë parashtesë të shquar (shih Dan. 7:13; Heb. 1:2; 3:6; 5:8; 7:28). Megjithatë, fakti që është një titull e bën atë në trajtën e shquar. Paqartësia mund të jetë e qëllimshme (një aspekt i shkrimeve të Gjonit). Jezusi është një qenie njerëzore e vërtetë dhe gjithashtu Mesia Hyjnor.

[Special Topic: Son of Man](#) [Tema të veçanta: Biri i Njeriut]

▣ **“të veshur me një petk të gjatë deri te këmbët dhe ngjeshur me një brez ari në gjoks”** Kjo frazë është kuptuar në disa mënyra.

1. Si një referencë ndaj Priftit të Lartë (shih Eksod. 28:4; 29:5; Lev. 16:4 dhe Zak. 3:4)
2. Si një referencë ndaj një personi mbretëror dhe të pasur (shih 1 Sam. 18:24; 24:12 dhe Ezek. 26:16)
3. Si një vizion i ëngjëllit të lavdishëm interpretues te Dan. 10:5-21, i cili mund të përfaqësojë Jezusin teksa sjell mesazhin e Perëndisë.
4. Josefus, në librin e tij, *Antiquities of the Jews* [Antikitete të Hebrenjve] III.7.2,4, thotë se Prifti i Lartë vishej me një brez të thurur me ar. Prandaj, Jezusi është Prifti i Lartë (shih Ps. 110:4-7; Zakaria 3) i vendit të shenjtë qiellor (shih Heb. 8:1-13; Psalm 110).

1:14 “dhe kryet e tij dhe flokët e tij ishin të bardha si lesh i bardhë” Ky është një aludim ndaj Ditëve të Lashta tek Dan. 7:9. Ky është një shembull se si autorët e Dhjatës së Re i japin Jezusit tituj dhe përshkrime të YHWH, duke theksuar në këtë mënyrë hyjësinë e Jezusit.

▣ **“sytë e tij ngjanin me një flakë zjarri”** Kjo simbolizonte njohurinë e tij depërtuese (shih Dan. 10:6; Zbu. 2:18; 19:12).

1:15

NASB “si bronz i ndezur, që është bërë të shkëlqejë në një furrë”

NKJV “si tunxh i kulluar, si të ishte rafinuar në një furrë”

NRSV “si bronz i ndezur, i rafinuar në një furrë”

TEV “si tunxh që është rafinuar dhe lëmuar”

NJB “si bronzi i ndezur kur është rafinuar në një furrë”

Kjo fjalë e përdorur për bronzin (*chalkolibanon*) është e pasigurtë. Tunxh është një term i lidhur, *chalkos* (shih Mate. 10:9; 1 Kor. 13:1; Zbu. 18:22). Është përdorur tek Ezek. 1:7 për këmbët e kerubimit dhe tek Dan. 10:6 për lajmëtarin ëngjëllor. Këmbët e Jezusit përshkruhen me të njëjtat terma (shih Zbu. 1:15; 2:18) për të treguar origjinën e Tij qiellore ose karakterin e tij madhështor.

NASB, NKJV, NRSV “zëri ishte si zëri i shumë ujërave”

TEV “zëri tingëllonte si një ujëvarë që gjëmon”

NJB “zëri si tingulli i oqeanit”

Kjo është përdorur për:

1. YHWH tek Ezek. 1:24; 43:2
2. Krahët e kerubimit tek Ezek. 1:24
3. Lajmëtarin ëngjëllor (të mundshëm) tek Dan. 10:6

Me sa duket, është një simbol i zërit të personit në qiell që ka autoritetin (shih Zbu. 14:2; 19:6).

1:16 “kishte në dorën e tij të djathtë shtatë yje” Kjo frazë përsëritet tek Zbu. 1:16,20; 2:1; 3:1. Kjo tregon kujdesin personal të Jezusit për kishat e tij lokale.

▣ **“dhe nga goja e Tij dilte një shpatë e mprehtë, me dy tehe”** *Hromphaia* i referohet Tracianit të madh, shpatës së gjerë që mbanin ushtarët romakë. Kjo metaforë shfaqet në Dhjatën e Vjetër tek Isa. 11:4; 49:2. Ajo simbolizon të dyja

1. Luftë (shih Zbu. 2:16; 6:8)
2. Fuqinë e fjalës së Perëndisë, sidomos të gjykimit (shih Zbu. 2:12; 19:15,21; 2 Thes. 2:8).
3. Hebrenjve 4:12 përdor një tjetër lloj shpate (*machaira*), por të njëjtën ide – fuqia e fjalës së Perëndisë.

▣ **“fytyra e tij si dielli që ndrin me forcën e tij”** Një shprehje e ngjashme është përdorur për të përshkruar lajmëtarin ëngjëllor të Dan. 10:6 dhe Zbu. 10:1. Tek Dan. 12:3 (shih Mate. 13:43) ishte një simbol i të drejtit të ringjallur. Jezusi përshkruhet me terma të ngjashëm në shpërftyrimin e Tij (shih Mate. 17:2).

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 1:17-20

17Dhe kur e pashë, rashë para këmbëve të tij si i vdekur. Dhe ai vuri dorën e tij të djathtë mbi mua, duke më thënë: “Mos u tremb! Unë jam i pari dhe i fundit,¹⁸ dhe i gjalli; isha i vdekur, por ja, jam i gjallë në shekuj të shekujve, amen; dhe unë i kam çelësat e vdekjes e të Hadesit. ¹⁹Shkruaj, pra, gjërat që pe, ato që janë dhe ato që do të ndodhin pas atyre,²⁰ misterin e të shtatë yjeve që ti pe në të djathtën time, dhe të shtatë shandanëve prej ari. Të shtatë yjet janë ëngjëjt e shtatë kishave, dhe të shtatë shandanët që pe janë shtatë kishat.”

1:17 “rashë para këmbëve të tij si i vdekur” Ky lloj zbulose ka shkaktuar gjithmonë shtangie tek njerëzit që e kanë marrë (shih Dan. 8:17; 10:9; Ezek. 1:28; 3:23; II Baruch [Baruku] 21:26; IV Ezra [Esdra] 5:14). Është diçka e mrekullueshme teksa një realitet frymor i mbinatyrshëm i zbulohet një qenie njerëzore.

▣ **“ai vuri dorën e tij të djathtë mbi mua”** Ky gjest tregon kujdesin dhe vëmendjen e Jezusit ndaj popullit të Tij (shih Dan. 8:18; 10:10, 18).

▣ **“Mos u tremb”** Kjo është një formë urdhërore në të tashmen me një artikull mohues, zakonisht duke nënkuptuar që të ndalosh një veprim që është tanimë në proces. Njerëzit kanë frikë nga realiteti i mbinatyrshëm (shih fjalët e Jezusit tek Mateu 14:27; 17:7; 28:10; Marku 6:50; Luka 5:10; 12:32; Gjoni 6:20 dhe fjalët e ëngjëllit tek Mate. 28:5; Luka 1:13,30; 2:10).

▣ **“Unë jam i pari dhe i fundit”** Kjo është zakonisht një referencë ndaj YHWH (shih Isa. 41:4; 44:6; 48:12), por këtu përdoret për Krishtin e lartësuar (shih Zbu. 1:8; 2:8; 22:13). Ky është një ekuivalent me frazën “Alfa dhe Omega.” Shih shënimet tek Zbu. 1:4 dhe 8.

1:18

NASB, NRSV “i Gjalli”

NKJV “Ai që jeton”

TEV “unë jam i gjalli”

NJB “unë jam i Gjalli”

Ky është një aludim për emrin e Perëndisë të besëlidhjes, YHWH, i cili vjen nga folja në hebraisht “të jesh” (shih Eksod. 3:14). Ai është i Vetmi i përhershëm, i gjallë (shih Dan. 12:7; Gjoni 5:26). Sërish, ky është përdorimi i autorit të Dhjatës së Re të një titulli të Dhjatës së Vjetër për Perëndinë për të përshkruar Jezusin. Kjo ngjason shumë me momentin kur Jezusi përdori emrin e YHWH për veten e tij tek Gjoni 8:58.

[Special Topic: Names for Deity](#), [Tema të veçanta: Emra për Hyjësinë], D.

▣ **“isha i vdekur, por ja, jam i gjallë në shekuj të shekujve,”** Ringjallja ishte:

1. Vula aprovuese e Perëndisë (shih Veprat e Apos. 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 4:24; 10:9; 1 Kor. 6:14; 15:15; Efe. 1:20; Kol. 2:12; Heb. 13:20; 1 Pjet. 1:21)
2. Një demonstrim i fuqisë së Frymës (shih Rom. 8:11)
3. Një demonstrim i fuqisë personale të Jezusit (shih Gjoni 10:11,15,17,18)

Kjo referencë ndaj vdekjes së Jezusit gjithashtu mund të ketë qënë një mënyrë për të penguar mësuesit e rremë gnostik të cilët mohanin që Jezusi ishte njeri.

▣ “**unë i kam çelësat e vdekjes e të Hadesit**” Hebrejntë e shihnin vdekjen si një burg me dyer (shih Job 38:17; Ps. 9:13; 107:18; Isa. 38:10; Mate. 16:19). Çelësat janë një metaforë për autoritetin. Kjo është një simbolikë për autoritetin e Jezusit mbi vdekjen për Vetveten dhe për ndjekësit e Tij (shih Zbu. 5:9-10; 1 Kor. 15).

NASB, NKJV, NRSV, NJB “Hades”

TEV “bota e të vdekurve”

Versioni King James (Mbretit Xhejms) e përkthen këtë si “ferr”, por ky është një ngatërrim i përkthimit në anglisht të fjalëve në greqisht, *Hades* dhe *Gehenna*. *Hades* i korrespondon fjalës në Dhjatën e Vjetër *Sheol* (shih Zbu. 6:8; 20:13-14). Në Dhjatën e Vjetër njerëzit përfytyroheshin si të zbrisnin në tokë ku atje mblidheshin në familje. Ishte një ekzistencë e ndërgjegjshme por pa gëzim. Dalëngadalë Perëndia filloi t’ju zbulojë shumë e më shumë (zbulesë progresive) për jetën pas vdekjes. Rabinët mbronin idenë se kishte një ndarje mes të drejtëve (Parajsa) dhe të këqijëve (Tartarusi) në *Sheol* (shih Luka 23:43). Bibla nuk jep hollësira mbi detajet e jetës pas vdekjes. Ajo flet me metafora për qiellin (psh. rrugët e arit, qyteti i 1500 milje kubike, asnjë portë të mbyllur etj.) dhe për ferrin (zjarr, errësirë, krimba etj.)

SPECIAL TOPIC: Where Are the Dead?, [Tema të veçanta: Ku janë të vdekurit] I. B. dhe II. B.

1:19 Kjo frazë është përdorur si modeli i interpretimit të librit të Zbulesës. Ajo shihet si një vizion i dyfishtë ose i trefishtë. Frazja në greqisht është një përkthim i dyfishtë i asaj që është e tashme dhe asaj që do të ndodhë. Gjoni po i fliste kohëve të tij ashtu sikurse dhe të ardhmes. Ky libër kombinon të dy aspektet në sensin profetik tradicional të ndodhive të tashme teksa paralajmërojnë ndodhi eskatologjike. Ky libër i drejtohet persekutimit të ditëve të Gjoni dhe persekutimit në çdo epokë por gjithashtu edhe persekutimit të kohëve të fundit nga anti-Krishti (shih Dan. 9:24-27; 2 Thesalonikasve 2).

1:20 “misteri i yjeve” Ky term (*mustērion*) përdoret në disa kuptime nga Pali, por të gjitha lidhen me të përjetshmen, por plani i Perëndisë për shpëtimin e njerëzve, i cili beson se hebrejntë dhe johebrejntë do të bashkohen në një trup të ri në Krishtin (shih Efes.2:11-3:13). Megjithatë, këtu, duket se përdoret në lidhje me shtatë kishat të cilave Jezusi iu drejtohet në kapitujt 2 dhe 3. Nga vargu 20 është e dukshme se shtatë frymërat, shtatë yjet, shtatë shandanët e artë dhe shtatë ëngjëjt janë të gjithë simbolikë në një mënyrë të shtatë kishave. Ky term është përdorur në një mënyrë të ngjashme për një kuptim të fshehur si simbol tek Zbu. 17:7. Shih shënimet dhe [Special Topic: Mystery](#) [Tema të veçanta: Misteri].

▣ “**ëngjëjt**” Termat në greqisht (*aggelos*) dhe hebraisht (*malak*) mund të përkthehen në “lajmëtarë” ose “ëngjëj”. Ka disa teori për identitetin e tyre.

1. Disa thonë se ata ishin shtatë frymërat që përmenden në vargun 4.
2. Të tjerë mendojnë se ata ishin pastorë të këtyre kishave (shih Mal. 2:7)
3. Të tjerë thonë se iu referohen ëngjëllit rojësar të këtyre kishave (shih Dan. 10:13,20,21)

Duket se mënyra më e mirë është se ata i referohen një personifikimi të kishave në tërësi, qoftë simbolizuar në një pastor apo një ëngjëll.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. A jep kapitulli 1 ndonjë ide se si duhet të interpretohet libri i Zbulesës? Nëse po, cilat janë ato?
2. A është libri i Zbulesës kryesisht për ditët kur është shkruar apo ditët e fundit? Pse?

3. Pse bëri Gjoni kaq shumë aludime ndaj Dhjatës së Vjetër por kurrë nuk citoi drejtpërsëdrejti prej saj?
4. Pse ka kaq shumë tituj të ndryshëm të përdorur për Perëndinë në këtë kapitull?
5. Pse përdoren përshkrimet e Zbu. 1:12-20 për të prezantuar secilën nga shtatë kishat e kapitujve 2 dhe 3?
6. Pse përshkruhet Jezusi i përlëvduar aq ngjashëm me ëngjëllin e Danielit 10?

ZBULESA 2 – 3

NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Mesazhi ndaj Efesit 2:1a 2:1b-7	Kisha pa dashuri 2:1-7	Letra e parë 2:1 2:2-7	Mesazhi ndaj Efesit 2:1a 2:1b-7a 2:7b	Efesi 2:1-7
Mesazhi ndaj Smirnës 2:8a 28b-11	Kisha e persekutuar 2:8-11	Letra e dytë 2:8 2:9-11	Mesazhi ndaj Smirnës 2:8a 2:8b-10 2:11a 2:11b	Smirna 2:8-11
Mesazhi ndaj Pergamës 2:12a 2:12b-17	Kisha kompromentuese 2:12-17	Letra e tretë 2:12 2:13-17	Mesazhi ndaj Pergamës 2:12a 2:12b-16 2:17a 2:17b	Pergama 2:12-13 2:14-17
Mesazhi ndaj Tiatirës 2:18a 2:18b-29	Kisha e korruptuar 2:18-29	Letra e katërtë 2:18 2:19-29	Mesazhi ndaj Tiatirës 2:18a 2:18b-23 2:24-28 2:29	Tiatira 2:18-29
Mesazhi ndaj Sardës 3:1a 3:1b-6	Kisha e vdekur 3:1-6	Letra e pestë 3:1a 3:1b-6	Mesazhi ndaj Sardës 3:1a 3:1b-5 3:6	Sarda 3:1-6
Mesazhi ndaj Filadelfisë 3:7a 3:7b-13	Kisha besnike 3:7-13	Letra e gjashtë 3:7 3:8-13	Mesazhi ndaj Filadelfisë 3:7a 3:7b-12 3:13	Filadelfisë 3:7-13
Mesazhi ndaj Laodicesë 3:14 3:14b-22	Kisha e vakët 3:14-22	Letra e shtatë 3:14 3:15-22	Mesazhi ndaj Laodicesë 3:14a 3:14b-21	Laodicea 3:14-22

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[A Guide to Good Bible Reading](#)” [Një guidë për një lexim të mirë të Biblës])

DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

SFONDI I PËRGJITHSHËM

- A. Kjo njësi letrare (kapitujt 2-3) lidhet me titujt e Dhjatës së Vjetër për YHWH të përdorura për Mesian (shih Zbu. 1:12-20). Kjo është një mënyrë se si autorët e Dhjatës së Re e mbronin hyjësinë e Jezusit. Zbulesa e Gjonit i transferon titujt e Dhjatës së Vjetër dhe veprimet e YHWH tek Jezusi, Mesia i ngritur lart dhe i përlëvduar.
- B. Qëllimi i tij është të tregojë nevojat frymore të këtyre kishave të shekullit të parë, dhe me anë të analogjisë së saj, të gjitha kishave (prandaj përdoret numri shtatë). Shërbesa e Gjonit në moshën e tij madhore ishte në Azinë e Vogël, sidomos në Efes. Gjoni ishte dukshëm i njohur mirë me këto kisha dhe qytete. Këto letra tregojnë aspektin etik të krishtërit. Ato janë një thirrje për besnikëri dhe perëndishmëri. Kisha do të gjykohej gjithashtu (shih 2 Kor. 5:10).
- C. Kishte shumë kisha në provincën romake të Azisë së Vogël në kohën e Gjonit. Pse i shkruan autori vetëm shtatë prej tyre?
 1. Ky është numri biblik për të shenjuar perfeksionin (shih Zanafilla 1). Ka struktura letrare të shumta të shtatave në profecitë e Gjonit.
 2. Këto kisha formonin një shteg udhëtimi, duke filluar në Efes dhe duke përfunduar në Laodice. Kjo ndoshta ishte udha postare e perandorisë.
 3. Ato janë në një farë mase përfaqësuese të llojeve të kishave të gjendura në çdo epokë dhe kulturë.
- D. Cila është rëndësia e kësaj njësie letrare për ne sot?
 1. Disa i interpretojnë këto kisha si përshkrime profetike të historisë perëndimore nga Pentakosti deri në Ardhjen e Dytë
 - a. Efes = Periudha Apostolike, 33-100 pas Krishtit (nga Pentakosti tek Gjoni)
 - b. Smirna = Periudha e Persekutimit, 100-313 pas Krishtit (nga Gjoni tek Kostandini)
 - c. Pergama = Periudha e Kostandinit, 313-590 pas Krishtit (nga Kostandini tek Gregori)
 - d. Tiatura = Roma papnore, 590-1517 pas Krishtit (nga Gregori tek Luteri)
 - e. Sarda = Reformacioni, 1517-1792 pas Krishtit (nga Luteri tek Karei)
 - f. Filadelfia = Lëvizja Moderne Misionare, 1792-1914 pas Krishtit (Karei deri në rrëmbim)
 - g. Laodicea = Periudha e Braktisjes, 1914 pas Krishtit deri në Parusi (Lufta e parë botërore deri tek Parusia)

Kjo është një skicë relativisht e re interpretuese, e cila ka karakterizuar “Para-mijëvjeçarizmin dispensacional” (i cili zakonisht e sheh Mateun 13 si një paralelizëm ndaj 7 kishave). Megjithatë, nuk ka asgjë në vetë tekstin që të ngrejë lart këtë pikëpamje. Megjithatë disa aspekte të historisë perëndimore i përshtaten kësaj skeme, disa të tjera nuk e bëjnë. Është arrogante të mbrosh idenë se Bibla është shkruar ekskluzivisht për të adresuar vetëm kulturën perëndimore. Një skemë e tillë do të kishte qënë e pakuptimtë ndaj dëgjuesve të shekullit të parë.

2. Disa i interpretojnë këto kisha si një pjesë përfaqësuese të llojit të kishave që gjenden në të gjitha epokat dhe kulturat.
- E. Një nga librat që më ka ndihmuar mua të interpretoj profecinë / shkrimet apokaliptike është D. Brent Sandy, *Plowshares and Pruning Hooks: Rethinking the Language of Biblical Prophecy and Apocalyptic*. [D. Brent Sendi, Parmenda dhe Drapërit: Duke Rimenduar Gjuhën e Profecisë dhe Shkrimeve

Apokaliptike Biblike]. Ai arrin në një konkluzion teologjik interesant mbi të gjitha premtimet e bëra ndaj besimtarëve besnikë në kapitujt 2-3 (fq. 22-32). Ai i rendit premtimet si më poshtë:

1. Pema e jetës
2. Kurora e jetës
3. Guri i bardhë
4. Autoriteti mbi kombet
5. Ylli i Mëngjesit
6. I veshur në të bardhë
7. Një kolonë në tempullin e Perëndisë
8. Emri i Perëndisë
9. Emri i Jeruzalemit
10. Ulur mbi fronin e Perëndisë

Ai thotë se ato nuk duhet të interpretohen fjalë për fjalë apo individualisht, por si një përmbushje në bashkësi, siç shihet tek Zbu. 21:3. Unë mendoj se kjo është një përjasje e saktë hermeneutike ndaj këtij zhanri.

UNITETI STRUKTUROR I SHTATË LETRAVE

- A. Shumë komentatorë shohin një strukturë shtatë elementëshe të pranishme në pjesën më të madhe të letrave, edhe pse jo të shtatë janë të pranishëm në secilën nga kishat.
1. Referimi i zakonshëm i Jezusit “ndaj ëngjëllit të kishës që i shkruante...” (shih Zbu. 2:1,8,12,18; 3:1,7,14).
 2. Përshkrimi i Jezusit i marrë nga Zbu. 1:12-20, të cilët janë tituj dhe veprime të YHWH, prezantojnë çdo mesazh.
 3. Njohja e Jezusit për kishat, qoftë pozitive apo negative, “Unë e di...” (shih Zbu. 2:2, 9,13,19; 3:1,8,15).
 4. Jezusi i adresohet kishave individuale dhe mundësive të tyre kulturore, gjeografike dhe shpirtërore.
 5. Jezusi flet për ardhjen e Tij të shpejtë dhe të papritur, ose në gjykimin e tij të përkohshëm ose në Ardhjen e Tij të Dytë, (shih Zbu. 1:1,3; 2:5,16,25; 3:3,11).
 6. Jezusi paralajmëron të dëgjuar dhe të kuptuar frymor, (shih Zbu. 2:7,11,17,29; 3:6,13,22). Jezusi përdor “Ai që ka një vesh, le të dëgjojë” në Ungjijt (shih Mate. 11:15, 13:9, 43; Mark 4:24.)
 7. Jezusi premtim një shpërblim për ndjekësit besnikë (shih Zbu. 2:7,11,17,25-26; 3:4-5,11-12,21). Këto shtatë hapa nuk përputhen në secilën letër. Radha ndryshon dhe disa elementë nuk janë në disa prej kishave, por në tërësi kjo strukturë tregon një nga disa strukturat letrare të shtatë-fishta të Gjonit.

QYTETET TË CILAVE IU DREJTOHEN LETRAT

A. Efesi

1. Ishte qyteti më i madh në provincën romake të Azisë së vogël. Nuk ishte një kryeqytet, edhe pse guvernatori romak jetonte atje. Ishte një qendër tregtie për shkak të portit të vet natyror të shkëlqyer.
2. Ishte një qytet i lirë, i cili lejonte të kishte qeverisje lokale dhe shumë liri, duke përfshirë faktin që nuk kishte asnjë garnizon të ushtarëve romakë.
3. Ishte i vetmi qytet i cili lejonte të mbante lojëra aziatike dy herë në vit.
4. Ishte vendi i Tempullit për Artemisin (Diana në latinisht), i cili ishte një nga shtatë mrekullitë e botës së asaj dite. Ishte rreth 130m x 70m me 127 kolona të cilat ishin 20m të larta; 86 prej tyre ishin të veshura me ar (shih *Hist. Nat.* 36:95 e më pas të Plinit). Imazhi i Artemisë mendohej se

- kishte qënë një meteor i cili i shëmbëllente një figurë femërore me shumë gjinj. Kjo do të thoshte se kishte shumë prostituta kultike të pranishme në qytet (shih Vep. Apost. 19). Ishte një qytet multikulturor mjaft i pamoralshëm.
5. Pali qëndroi në këtë qytet për më shumë se tre vjet (shih Vep. Apost. 18:18 e më pas; 20:13).
 6. Tradicionalisht pranohet që ky qytet u bë shtëpia e Gjonit pas vdekjes së Marisë në Palestinë.

B. Smirna

1. Supozohej të ishte themeluar nga një Amazonë (një grua e fortë drejtuese) e quajtur Smirna. Në ditët e Gjonit ishte një qytet me rreth 200,000 banorë.
2. Shtrihej përgjatë detit Egje. Kishte një port natyror ideal dhe prandaj ishte një qendër tregtare e tejkaluar vetëm nga Efesi në Azinë e Vogël. Ishte një qytet shumë i pasur.
3. U shkatërrua nga Lidianët rreth vitit 600 para Krishtit, por u rindërua nga Lysimicus (Lisimiku) që pasoi planet e Aleksandrit të Madh sipas të cilit flladi i detit do të depërtonte në çdo rrugë.
4. Ishte gjithashtu një qytet i lirë për shkak se kishte ndihmuar në tërheqjen e ushtarëve romakë pas disfatës së tyre me Mithradatët.
5. Ishte një qendër adhurimi e perëndeshës Roma (195 para Krishtit) dhe e adhurimit të perandorit. Aty u ndërta tempulli i parë i perandorit Tiberius (26 pas Krishtit).
6. Ishte një qendër fetare me adhurim të Cybeles dhe të panteonit të Homerit. Kishte madje edhe një traditë sipas së cilës Homeri kishte lindur atje. Tempujt e saj të shumtë gjendeshin në Akropolis të quajtur Pagos me një rrugë të artë midis Tempullit të Zeusit dhe të Cybeles.
7. Kishte një popullatë të madhe aktive kundër hebrenjve të krishterë.
8. Ishte një qytet në të cilin Polycarp (Gjoni dishepulli i apostullit) u martirizua në vitin 155 pas Krishtit.

C. Pergama

1. Ishte një qytet i madh i pasur dhe kryeqyteti i Azisë së Vogël (që prej vitit 282 para Krishtit), edhe pse jo i pozicionuar në një rrugë të madhe tregtare.
2. Mburrej për librarinë më të madhe në botën romake jashtë Aleksandrisë, në Egjipt. Kishte mbi 200,000 fletë pergamene!
3. Velumi* u shpik këtu. Ai bëhej prej lëkurave të kafshëve të cilat përdoreshin për të shkruar. Kjo mënyrë shkrimi u zhvillua për shkak se Aleksandria, në Egjipt, refuzonte t'iu shiste atyre kallama papirusash. Kjo për shkak se mbreti i tyre, Eumenes II (197-159 para Krishtit) ishte përpjekur që të punësonte bibliotekaren e Aleksandrisë, Aristophanes [Aristofani]. Kur mbreti Ptolemian, Epiphanes [Epifani] (205-182 para Krishtit) i Aleksandrisë e zbuloi, ai arrestoi bibliotekaren dhe vendosi embargo mbi papiruset nga Pergama. Kishte një rivalitet të vërtetë midis këtyre dy qendrave mësimore. Antoni më vonë dërgoi bibliotekën e Pergamës tek Aleksandria si një dhuratë për Kleopatrën.
4. Ishte vendi i doktor Galenit dhe qendra e arteve të shërimit të Asclepios. Madje thuhej se Asclepios ishte një "perëndi Pergame". Simboli për këtë perëndi ishte gjarpri.
5. Gjithashtu kishte një tempull për Romën dhe për perandorin August (29 pas Krishtit) dhe ishte një qendër administrative (neokopros) e kultit të perandorit. Besnikëria e saj ndaj Romës ishte e mirënjohur.

* Pergamena të hollë të bëra fillimisht prej lëkurës së një viçi. (Shënim i përkthyesit)

6. Ishte gjithashtu e njohur për adhurimin dhe mbrojtjen e saj ndan panteonit grek. Kishte një tempull gjigand për Zeusin në Akropolis i cili mund të shihte të gjithë qytetin. Kishte një formë si një fron (dmth, fronti i Satanit).

D. Tiatira

1. Ishte një qytet më i vogël i orientuar ndaj tregtisë. Ka shumë të dhëna për esnafet e saj të shumëta dhe lulëzuese të tregtisë, secila me perëndinë e vet mbrojtëse. Ndodhej në një rrugë të madhe midis Pergamës dhe Sardës e cila vazhdonte tek Filadelfia dhe Laodicea. Ishte e famshme për produktet e saj të leshta. Lidia (shih Vep. Apost. 16:14), një shitëse e copave të purpurta, ishte nga ky qytet.
2. Ishte zgjeruar prej Seleucus Nicateo, i cili vendosi ushtarët e tij maqedonas këtu.
3. Kishte disa tempuj ndaj perëndive lokale
 - a. Tyrimnos (Apollo) – perëndia e diellit
 - b. Artemis (Diana) – perëndia e dashurisë
 - c. Sibyl Sambathe – një fallxhore vendase

E. Sarda

1. Ishte një qytet antik i madh dhe i pasur. Për vite me radhë ishte kryeqyteti i pasur i perandorisë Lidiane për shkak të pozicionit të saj ushtarak mjaft të mirë, 460 metra mbi një mamuze mali. Ajo përmendet tek regjistrimet persiane për shkak të Cyrus (Sirit) të Madh të zënë rob në këtë qytet. Ajo gjithashtu përmendet tek Obad. 1:20. Kishte rënë mjaft në ditët e Gjonit.
2. Njihej për produktet e veta të leshta të ngjyrosura. Proçesi u shpik këtu, këtë pretendonin banorët.
3. Ishte qendra e adhurimit të Cybele, perëndeshës mëmë. Rrënojat e tempullit janë ende të dukshme në Akropolis. Tepria e këtij adhurimi ishte e njohur dhe për të ardhur keq në të gjithë perandorinë romake.

F. Filadelfia

1. Ndodhej në një pllajë dhe mbrohej nga uji. Kjo e bënte atë me një pozicion ushtarak tejet të dëshirueshëm. Ishte qyteti më i ri prej të shtatë qyteteve. U themelua nga Attalus II [Atalusi] (159-138 para Krishtit).
2. Ndodhej në një rrugë kryesore tregtie për në Sardë dhe kishte lulëzuar.
3. Ndodhej në një zonë të mirë bujqësore, sidomos për rrushin. Perëndia Bacchus [Baki], ose Dionysus [Dionisi], ishte një nga perënditë e saj kryesore. Ishte gjithashtu një zonë aktive sizmike dhe u shkatërrua nga tërmeti i madh në vitin 17 pas Krishtit, i cili gjithashtu shkatërroi dhe dhjetë qytete të tjera të mëdha në këtë zonë. Megjithatë, tronditjet pas ndodhisë vazhduan në këtë zonë dhe e gjithë popullata u zhvendos tek fshatrat përreth.
4. Ishte gjithashtu një qendër për kultin e perandorit (siç ishin Smirna dhe Pergama) i cili ishte me shumë mundësi burimi i persekutimit më të madh të kishave në provinca.
5. Ishte një qendër kryesore e kulturës helenistike dhe e eksportonte ndikimin e saj në mënyrë agresive. Dukej se ishte themeluar për këtë qëllim tek kufiri midis Misias, Lidias dhe Prigias.

G. Laodicea në lumin Lici

1. Ishte një nga tre qytetet në luginën e lumit Lici (qytetet e tjera ishin Kolosi dhe Hierapolis). Kishat u themeluan në secilin nga këto tre qytete, me shumë mundësi nga i konvertuari i Palit, Epaphras [Epafri] (shih Kol. 1:17; 4:12-13).
2. U themelua nga sunduesi Seleucid, Antioku II, i cili i vuri emrin e bashkëshortes së tij, Laodice, në vitin 250 para Krishtit. Gjendej në një zonë të mbrojtshme ushtarake si Filadelfia.

3. Ndodhej në një zonë kryesore tregtie lindje/perëndim. Njihej si një qendër bankare.
4. Ndodhej në një rajon bujqësor dhe blegtoral, sidomos i përshtatshëm për rritjen e deleve të zeza për të cilat u bë i famshëm në të gjithë botën. Ishte një prodhues në masë i veshjeve të jashtme të zeza të quajtura “*trimeta*”.
5. Kishte një popullatë shumë të madhe hebraike.
6. Sikurse Pergama, ishte një qendër e adhurimit të perëndisë së shërimit Asclepios. Qyteti ishte vendndodhja e një shkolle mjekësore e cila njihej për balsamin e saj të veshit dhe të syrit.

STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 2:1

¹ “Engjëllit të kishës në Efes shkruaji: këtë thotë ai që mban të shtatë yjet në të djathtë të tij dhe që ecën në mes të shtatë shandanëve prej ari.

2:1 “engjëlli” Termi hebraik dhe grek për engjëll ka domethënie lajmëtar. Ai gjithashtu mund t’i referohet:

1. Pastorit (shih Mal. 2:7)
 2. Engjëllit të kishës (shih Danieli 10)
 3. Frymës apo karakterit unik të kishave individuale
- E njëjta frazë bën hyrjen tek çdo letër (shih Zbu. 2:1, 8, 12, 18; 3:1, 14).

▣ **“kisha”** Kjo fjalë greke e përbërë *ekklesia* është një kombinim i dy termave në greqisht “jashtë prej” dhe “të thërrasësh”. Përdorej në Septuagint për të përkthyer fjalën hebraike, *qahal*, ose “asambleja e Izraelit”. Të krishterët e hershëm e përdornin atë për t’iu drejtuar vetes së tyre sepse

1. Ata e shihnin vetveten si populli i Perëndisë, si Izraeli
2. Ata e shihnin vetveten si të thirrur hyjesisht nga Perëndia si për shpëtim ashtu edhe për shërbesë

Shih Tema të veçanta tek Zbu. 1:4

▣ **“Ai që mban të shtatë yjet”** Ky është një përshkrim i Jezusit i marrë nga Zbu. 1:16. Këta shtatë yje iu referohen kishave (shih 1:20). Termi “mban” (koha e tashme aktive) tregon për një kapje të fortë dhe të sigurtë (shih Gjoni 10:28). Asgjë dhe askush nuk mund t’i ndajë këto kisha nga Jezusi (shih Rom. 8:31-39) përveç refuzimit të vetë atyre për t’u penduar dhe për ta ndjekur Atë! Vetëm mosbesimi mund të ndajë.

▣ **“në të djathtë të Tij”** Kjo është një metaforë antropomorfike (që flet për Perëndinë në terma fizikë) për fuqinë dhe për autoritetin (shih Zbu. 1:16,17,20; 2:1; 5:1,7).

▣ **“që ecën në mes”** Kjo është një metaforë antropomorfike e përdorur tek Zan. 3:8 si një simbol i pranisë së Perëndisë me njerëzimin (shih Lev. 26:12).

SPECIAL TOPIC: GOD DESCRIBED AS A HUMAN (anthropomorphic language) [TEMA TË VEÇANTA: PERËNDIA I PËRSHKRUAR SI NJERI (gjuha antropomorfike)]

▣ **“të shtatë shandanëve prej ari”** Kjo nuk i referohet Menorës së Tabernakullit, por është një simbol tjetër për shtatë kishat (shih Zbu. 1:12-13).

▣ **“thotë”** Fjalët e fundit të Jezusit ndaj kishës së Tij nuk janë Mate. 28:18-20 apo Vep. Apost. 1:7-11, por Zbulesa 2-3.

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 2:2-7

² Unë i njoh veprat e tua, mundin tënd dhe durimin tënd edhe se ti s`mund t`i durosh të këqijtë; ti i vure në provë ata që pretendojnë se janë apostuj dhe nuk janë dhe i gjete gënjeshtarë. ³ Ti ke duruar, ke qëndrueshmëri dhe për hir të emrit tim je munduar pa u lodhur. ⁴ Por kam diçka kundër teje, sepse dashurinë tënde të parën e le. ⁵ Kujtohu, pra, se nga ke rënë, pendohu, dhe bëj veprat e para; në mos do të vi së shpejti te ti dhe do ta luaj shandanin tënd nga vendi i vet, nëse nuk pendohesh. ⁶ Por ti ke këtë, që i urren veprat e Nikolaitëve, që i urrej edhe unë. ⁷ Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që u thotë Fryma kishave: kujt fiton do t`i jap të hajë nga pema e jetës, që është në mes të parajsës së Perëndisë`.

2:2 “Unë i njoh” Forma është në dëftore aktive pjesore të *oida*, por përkthehet në të tashmen. Jezusi sheh, kupton dhe kujdeset për kishat e Tij. Shqetësimi i Tij përfshin edhe pranim edhe disiplinim (që është një formë dashurie prindërore). E njëjta frazë përsëritet në të gjitha shtatë letrat (shih Zbu. 2:2,4,13,19; 3:1,8,15).

Rrethanat e Dhjatës së Vjetër për këtë term nënkuptojnë një marrëdhënie intime e personale (shih Zan. 4:1; Jer. 1:5).

SPECIAL TOPIC: KNOW (USING MOSTLY DEUTERONOMY AS A PARADIGM) [TEMA TË VEÇANTA: NJOH (DUKE PËRDORUR MË SË SHUMTI LIGJIN E PËRTËRIRË SI NJË PARADIGMË)]

▣ **“veprat e tua, mundin tënd”** Kjo ishte një kishë aktive, por ata kishin harruar prioritetin e marrëdhënies me Krishtin (shih Zbu. 2:4). Shumë gjëra të mira iu kishin vjedhur atyre më të mirën (shih Gal. 3:1).

▣ **“durimin tënd”** Ky term nënkupton një këmbëngulje të vullnetshme, aktive dhe të qëndrueshme. Kjo është një temë kryesore e librit (shih Zbu. 1:9; 2:2,3,19; 3:10; 13:10; 14:12). Durimi duhet të balancohet me sigurinë (shih Zbu. 2:7,11,17,26; 3:5,11-12,21). Pjesa më e madhe e të vërtetave biblike prezantohen në dyshe dialektike, në dukje paradoksale. Të dyja janë po njësoj të vërteta, por asnjëra nuk është e vërtetë e vetme. Shpëtimi është një pendim dhe besim fillestar i ndjekur nga një stil jetese pendimi, besimi, bindje, shërbese dhe qëndrueshmëri! Shih Tema të veçanta më poshtë:

SPECIAL TOPIC: PERSEVERANCE [TEMA TË VEÇANTA: DURIMI]

NASB	“njerëzit e këqij”
NKJV	“ata që janë të këqij”
NRSV	“keqbërësit”
TEV	“njerëzit e këqij”
NJB	“njerëzit mashtrues”

Kjo në të vërtetë do të thotë *kakous* (*kakos*), fjalë e cila shpesh përdoret për “njerëzit e këqij”. Sinonimi *ponçros* mund të përdoret për të keqen (neuter) ose për njerëzit e këqij dhe në fund të fundit edhe për të ligun (mashkullore, shih Mate. 5:37; 13:38; Gjoni 17:15). Konteksti dhe përdorimi konfirmojnë që ky tekst duhet t`iu referohet “njerëzve të këqij” (shih Rom. 2:9; 13:4) në kishë (mësuesit e rremë) ose ndoshta në komunitet. *Kakos* përdoret vetëm dy herë tek Zbulesa, këtu dhe Zbu. 16:2, ku përdoret për të përshkruar rezultatet e “enës së zemërimit të Perëndisë” (dmth lëndimet).

▣ **“ti i vure në provë”** Ky term grek (*peirazō*) do të thoshte të vije në provë me qëllime të mira apo të këqija (në pjesën më të madhe) (shih Zbu. 2:2,10; 3:10). Termi i lidhur me këtë (*peirasmos*) nënkuptonte të testojë duke pasur ndërmend shkatërrimin. Ekuilibri gjendet tek 1 Gjoni 4:1 ku besimtarët duhet të vënë në provë (*dokimazō*)

duke pasur ndërmend miratimin e atyre që pretendojnë se flasin për Perëndinë. Thirrja për besimtarët që të ekzaminojnë ata që pretendojnë se flasin për Perëndinë gjendet në të dy Dhjatat (shih Ligji i Përt. 13:1-5; 18:22; Mate. 7:15-23; 1 Gjoni 4:1-6).

Në Dhjatën e Re gjendet një tension i lidhur me besimtarët teksa gjykojnë njëri-tjetrin në mënyrë kritike (shih Mate. 7:1-5). Megjithatë, të krishterët janë thirrur për të vlerësuar njëri-tjetrin për rolet e drejtuesve (shih Mate. 7:5,6,15; 1 Kor. 5:1-12; 1 Timot. 3; 1 Gjoni 4:1-6). Qëndrimi dhe motivi janë kyç për vlerësimin e duhur (shih Gal. 6:1; Rom. 2:1-11; 14:1-23; Jakob 4:11-12).

SPECIAL TOPIC: GREEK TERMS FOR "TESTING" AND THEIR CONNOTATIONS [TEMA TË VEÇANTA: TERMA GREK PËR "VËNIE NË PROVË" DHE NËNKUPTIMET E TYRE]

▣ **“ata që pretendojnë se janë apostuj”** Ky përdorim i termit “apostuj” nuk i referohet Të Dymbëdhjetëve, por përdorimit më të gjerë të termit (shih Veprat 14:14; Rom. 16:7; 1 Kor. 15:7; Gal. 1:19; Efe. 4:11; 1 Thes. 2:6). Dhjata e Re shpesh i drejtohet temës së apostujve apo mësuesve të rremë (shih Mate. 7:15-16; 24:24; Veprat e Apo. 20:29; 2 Kor. 11:13-15; 1 Gjoni 4:1 dhe përgjatë letrave pastorale). Kjo kishë i kishte identifikuar këta apostuj të rremë dhe i kishte refuzuar ata.

2:3 Kjo kishë ishte besnike në mes të rrethanave të vështira, edhe persekutimit. Ata nuk e kishin refuzuar Krishtin apo ishin lodhur teksa bënë të mirën (shih Gal. 6:9; Heb. 12:3; Jakob 5:7-8). Shih shënimin tek Zbu. 2:7.

2:4

NASB, NKJV	“ti ke lënë dashurinë tënde të parë”
NRSV	“ti ke braktisur dashurinë që kishe në fillim”
TEV	“ti nuk më do tani sikurse më doje në fillim”
NJB	“ti ke më pak dashuri tani se sa në fillim”

Ka pasur teori të ndryshme se çfarë nënkupton kjo.

1. Përkthimet TEV dhe Charles Williams [Carls Uilliams] supozojnë se do të thotë dashuri për Krishtin.
2. James Moffatt [Xhejms Mofat] supozon se do të thotë dashuri për njëri-tjetrin.
3. Hershell Hobbs [Hershell Hobs] në komentarin e tij supozon se do të thotë dashuri për të humburit.
4. J.B. Phillips [Xhej Bi Phillips] në përkthimin e tij i kombinon të gjitha këto të mësipërmet.
5. Disa mendojnë se lidhet me problemin e besimtarëve të gjeneratës së dytë (shih Gjyqtarët 2:7-10).
6. Disa e shohin atë si një kishë pa dashuri me një ortodokësi të ftohtë (shih 1 Korintasve 13).

2:5 “kujtohu” Kjo formë në urdhërore e tashme aktive do të thotë “mbaj gjithmonë mend”. Besimtarët shpesh paralajmërohen për të kujtuar kushtet e tyre të mëparshme në mëkat dhe pozicionin e tyre të ri në hirin dhe mëshirat e Perëndisë përmes Krishtit.

▣ **“se nga ke rënë”** Kjo është një formë treguese e tashme aktive. Lënia e “dashurisë së tyre të parë” ishte bërë një rrethanë e vendosur tanimë e shpërfilljes!

▣ **“pendohu dhe bëj veprat e para”** Këto janë në formën urdhërore aktive aoriste. Vini re se e tërë kisha thirret për të bërë një pendesë vendimtare (shih 2 Kron. 7:14) dhe për t’u bërë aktive në dashurinë e saj për Krishtin, për njëri-tjetrin dhe për të humburit.

Pendesa është thelbësore për një marrëdhënie besimi me Perëndinë (shih Mate. 3:2; 4:17; Mark 1:15; 6:12; Luka 13:3,5; Veprat e Apo. 2:38; 3:19; 20:21). Termi hebraik do të thoshte një ndryshim në veprime, ndërsa termi në greqisht do të thoshte një ndryshim në mendësi. Pendesa është një gatishmëri për të ndryshuar nga një ekzistencë

e vetë-qëndëruar në një jetë të informuar dhe të drejtuar nga Perëndia. Kjo kërkon një ndryshim nga prioriteti dhe skllavëria e vetvetes. Në thelb, ky është një qëndrim i ri, një botëkuptim i ri, një mjeshër i ri. Pendesa është vullneti i Perëndisë për çdo fëmi të rënë të Adamit, i krijuar në imazhin e Tij (shih Ezek. 18:21,23,32 dhe 2 Pjet. 3:9).

Në pasazhin e Dhjatës së Re, i cili i reflekton në mënyrën më të mirë termat e ndryshëm të greqishtes për pendesë është 2 Kor 7:8-12.

1. *lupç*, “vajtim” ose “pikëllim” Zbu. 2:8 (dy herë), Zbu. 2:9 (tre herë), Zbu. 2:10 (dy herë), Zbu. 2:11
2. *metamelomai*, “kujdes i mëpasshëm” Zbu. 2:8 (dy herë), Zbu. 2:9
3. *metanoëō*, “pendesë”, “mendim i mëvonshëm”, Zbu. 2:9, 10

Kontrasti ekziston midis një pendese të rreme (*metamelomai*, shih Judën tek Mate. 27:3 dhe Esaun tek Heb. 12:16-17) dhe një pendese të vërtetë (*metanoëō*, shih Pjetrin tek Gjoni 21:15-23; Mate. 26:75; Mark 14:72; Luka 22:62).

Pendesa e vërtetë është teologjikisht e lidhur me:

1. Predikimin e Jezusit mbi kushtet e Besëlidhjes së Re (shih Mate. 4:17; Mark 1:15; Luka 13:3,5)
2. Predikimet apostolike tek Veprat e Apostujve (*kerygma*, shih Veprat e Apo. 3:16,19; 20:21)
3. Dhurata sovraane e Perëndisë (shih Veprat e Apo. 5:31; 11:18 dhe 2 Tim. 2:25)
4. Fundi (shih 2 Pjet. 3:9)

Pendesa nuk është fakultative.

▣ **“në mos do të vi së shpejti te ti”** Kjo është një temë e njohur në këtë libër; Krishti do të vijë së shpejti (shih Zbu. 1:2,3; 2: 5,16; 25; 3:3,11). Në Dhjatën e Vjetër ardhja e Perëndisë mund të sillte bekim ose gjykim. Në këtë kontekst Krishti do të vinte të disiplinonte kishën e Tij (shih 1 Pjet. 4:17)! Prandaj, ka një orientim të përkohshëm, ashtu sikurse eskatologjik.

▣ **“dhe do ta luaj shandanin tënd nga vendi i vet”** Shandani simbolizon të gjithë kishën. Kjo mund të ketë përfshirë heqjen e pranisë dhe bekimeve të Krishtit. I gjithë kongregacioni nuk po ndeshet me braktisje, por me humbjen e shërbesës së tyre efektive. Kjo gjithashtu vlen edhe për kishat e Pergamës (shih Zbu. 2:16), Tiatirës (shih Zbu. 2:22-23), Sardës (shih Zbu. 3:3) dhe Laodicesë (shih Zbu. 3:19). Është e mundur që secila prej këtyre kishave ishte e prekur nga një tip i rremë i mësimdhënies Nikolaitane e cila promovonte kompromis me kulturën pagane.

2:6 “që ti i urren veprat e Nikolaitëve” Ka shumë spekulime se kush janë këta Nikolaitë dhe se çfarë besonin ata. I vetmi burim biblik që kemi është Zbu. 2:6, 14-15. Spekulimi nisi herët në kishë rreth vitit 180 pas Krishtit kur Irenaeus [Ireneasi] dhe Hippolitus [Hipoliti] supozonin se këta ishin ndjekës të një prej “shtatë” të zgjedhurve në Veprat e Apostujve 6:5 të quajtur Nicolas [Nikolas]. Kjo është plotësisht e pabazuar. Irenaeus [Ireneasi] në librin e tij, *Contra-heresies* [Kundër heresive], 3:11:7, supozon se ata ishin ndjekës të gnosticizmit cirean të shekullit të dytë. Eusebius [Eusebi], në librin e tij, *Ecclesiastical History* [Historia ekleziastike], 3:29:1, thotë se ky sekt specifik nuk zgjati shumë.

Në Zbu. 2:14-15, mësimet e Balaam-it dhe të mësuesve të Nikolaitëve janë të ngjashme. Ekziston një lidhje e mundshme etimologjike midis emrave të tyre në greqisht, do të thotë “pushtues” dhe “popull” (shumë të ngjashme me kuptimin e emrit Nikodemus). Ajo që është e dukshme është se të dy i nxisnin besimtarët për të marrë pjesë në praktika adhurimi pagane të cilat përfshinin edhe aktivitete rituale seksuale. Në këtë sens Nikolaitët dhe Balaamitët (shih Num. 25:1-9; 31:16-18) janë shumë të ngjashëm me mësimet e Jezabelit (shih 2:20).

2:7 “kush ka veshë, le të dëgjojë atë që u thotë Fryma kishave” Ky paralajmërim përsëritet përgjatë letrave ndaj shtatë kishave (shih Zbu. 2:7,11,17,29; 3:6,13,22). Ishte një frazë që vinte nga fjalët e Jezusit (shih Mate.

11:15; 13:9,43). E vërteta frymore duhet të përgjigjet me mendje dhe me duar. Kjo është e ngjashme me termin hebraik *shema*, “dëgjo dhe bëj” (shih Ligji i Përt. 5:1; 6:4; 9:1; 20:3; 27:9-10).

▣ **“kishat”** Shih Tema të Veçanta tek Zbu. 1:4.

▣ **“kujt fiton”** Ekziston një theks i vazhdueshëm teologjik mbi këmbënguljen e besimtarëve (shih Zbu. 2:7,11,17,25-26; 3:4-5,11-12,21). Është prova e eksperiencës së një konvertimi të vërtetë (shih Mate. 24:13; Gal. 6:9)! Jonathan Edwards [Xhonatan Eduards] thotë: “Një provë e sigurtë e zgjedhjes është se njeriu qëndron fort deri në fund.” W.T. Conner [Dabëllju Ti Koner] ka thënë: “Shëptimi i një njeriu të zgjedhur për shpëtim është i sigurtë nga gjithë përjetësia në mendjen dhe në qëllimin e Perëndisë, por kushtëzohet nga besimi, dhe një besim që qëndron dhe fiton.” Shih Tema të Veçanta tek Zbu. 2:2.

▣ **“do t’i jap të hajë nga pema e jetës, që është në mes të parajsës së Perëndisë”** Ky është një aludim ndaj pemës në Kopështin e Edenit (shih Zan. 2:9). Ashtu sikurse filloi me njerëzit në marrëdhënie me Perëndinë dhe me kafshët në kopësht, po kështu Bibla mbaron në të njëjtën mënyrë (shih Isa. 11:6-9; Zbu. 22:2,14,19). Termi “parajsë” ishte një fjalë persiane për kopështin e bukur me mure të një fisniku, term i cili përdorej në Septuagint për të përkthyer Kopështin e Edenit (shih Ezek. 28:13; 31:8). Është një nga referencat e shumta ndaj periudhës mesianike i cili gjendet përgjatë letrave ndaj shtatë kishave.

Termi “parajsë” përdoret në dy kuptime: (1) tek Luka 23:4 mund t’i referohet pjesës së drejtë të *Sheolit/Hades* (shih Tema të Veçanta tek Zbu. 1:8). Jezusi i thotë vjedhësit të penduar se ai do të ishte me Të atë ditë atje (Jezusi nuk u kthye në qiell për 40 ditë, shih Gjoni 20:17) dhe (2) tek 2 Kor. 12:3 i referohet pranisë së Perëndisë, vendit të fronit qiellor të Perëndisë (“qielli i tretë”).

Qëllimi i Perëndisë për njerëzimin, i krijuar në imazhin dhe shëmbëlltyrën e Tij (Zan.1:26-27), ka qënë gjithnjë jeta e përjetshme. Rënia e Zanafillës 3 dhe pjesa tjetër e Biblës dokumentojnë përkushtimin e Perëndisë ndaj shpengimit të njerëzimit dhe marrëdhënies së përjetshme me Të. Kjo botë e rënë, ky hendek në marrëdhënien e plotë, nuk ishin dëshira e Perëndisë, por turpi i njerëzimit. Perëndia do të restauroj krijimin për qëllimet e Tij.

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 2:8-11

⁸“Dhe engjëllit të kishës në Smirnë, shkruaji: këtë thotë i pari dhe i fundit, që qe i vdekur dhe kthehej në jetë. ⁹Unë i njoh veprat e tua, dhe shtrëngimin e varfërinë (por ti je i pasur) dhe blasfeminë e atyre që e quajnë veten Judenj, por nuk janë, por janë një sinagogë e Satanit. ¹⁰Mos ki frikë nga ato për të cilat do të vuash; ja, djalli do të hedhë disa prej jush në burg, që të provoheni, dhe ju do të keni shtrengim për dhjetë ditë. Ji besnik deri në vdekje dhe unë do të të jap kurorën e jetës. ¹¹Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që Fryma u thotë kishave: kush fiton nuk do të preket nga vdekja e dytë”.

2:8 “i pari dhe i fundit” Ky është një nga titujt e përsëritur të Jezusit i gjendur tek Zbu. 1:17 dhe 22:13.

Fillimisht ai i referohet YHWH (shih Isa. 41:4; 44:6; 48:12). Është sinonim me shprehjen “Unë jam Alfa dhe Omega” (shih Zbu. 1:8; 21:6; 27:13) dhe “fillimin dhe fundin” (shih Zbu. 21:6; 22:13). Shih shënime të plota tek Zbu. 1:8.

▣ **“që qe i vdekur dhe kthehej në jetë”** Kjo mund të ketë qënë një shuplakë për natyrën e kultit të Cybele, nënës perëndeshë. Shumë nga fetë antike të pjellorisë e bazonin pikëpamjen e tyre në ciklet e personifikuara të natyrës, vdekje dimri dhe ringjallje pranëverë. Në kontekst kjo lidhet teologjikisht me 1:18; 5:6, ku Jezusi është qengji që u vra por që tani është i gjallë. Ajo thekson vdekjen zëvendësuese një-herë-e-përgjithmonë (të papërsëritshme) të Jezusit dhe ringjalljen e Tij (shih Heb. 7:27; 9:12,28; 10:10).

2:9 “unë i njoh veprat e tua, dhe shtrëngimin e varfërinë” Këto janë dy fjalë shumë të fuqishme greke. Ato janë të rëndësishme sepse qyteti i Smirnës ishte shumë i pasur. Fakti që kisha ishte e varfër duket të nënkuptojë persekutim ekonomik. Kjo është teologjikisht e rëndësishme se në librin e Zbulesës besimtarët vuajnë në “fatkeqësi” nga jobesimtarët dhe i ligu, por jobesimtarët vuajnë “zemërimin e Perëndisë”. Shih shënimin e plotë tek Zbu. 7:14. Besimtarët janë gjithnjë të mbrojtur (të vulosur, shih Tema të Veçanta tek Zbu. 7:2) nga gjykimi hyjnor.

SPECIAL TOPIC: TRIBULATION [TEMA TË VEÇANTA: TRAZIRA]

▣ **“(por ti je i pasur)”** Besimtarët nuk mund të gjykojnë qëndrimin e tyre në Krishtin me standarte të botës (shih Mate. 6:33).

NASB, NKJV “blasfemi”
NRSV, NJB “shpifje”
TEV “gjëra të këqija të thëna kundër teje”

Kjo në të vërtetë është termi “blasfemi”, i cili në Dhjatën e Vjetër nënkuptonte “të ofendosh” dhe zakonisht përdorej në lidhje me sulmet verbale mbi YHWH (shih Lev. 24:13-23). Dy herë në Dhjatën e Vjetër termi “i bekuar” (*barak*) përdoret në sensin e blasfemisë (shih 1 Mbre. 21:10,13). Në kontekst këta fetarë hebraikë pretendojnë se e njohin Perëndinë (“bekojnë Perëndinë”), por në të vërtetë nuk e njohin (shih Mate. 7:21-23).

▣ **“që e quajnë veten Judenj, por nuk janë”** Një shprehje e ngjashme përdoret në Zbu. 3:9; aty është e dukshme që ata janë hebrenj për nga rraca të cilët pretendojnë se janë populli i Perëndisë por në të vërtetë nuk janë (shih Gjoni 8:44; Rom. 2:28-29; Gal. 3:29; 6:16). Nga Veprat e Apostujve dhe letra drejtuar Galatasve ne e dimë se hebrenjtë shkaktuan kundërshtim të madh ndaj proklamitës së ungjillit (shih Veprat e Apost. 13:50; 14:2, 5, 19; 17:5).

Zbulesa 2:13 sugjeron se kjo i referohet kulteve lokale të adhurimit ndaj perandorit të quajtur Concilia [Konsilia] i cili kërkonte që të Krishterët ta thërrisnin Cezarin “Zot” dhe t’i digjinin atij temjan një herë në vit.

▣ **“një sinagogë e Satanit”** Gjoni pa botën në një kontrast të fuqishëm, Perëndia kundër Satanit. Satani (shih [SPECIAL TOPIC: SATAN](#) [TEMA TË VEÇANTA: SATANI] tek Zbu. 12:3) përmendet shpesh në libër (shih 2:9,13; 3:9; 12:9,10; 20:2,7). Ai shpif për besimtarët dhe fuqizon persekutorët e tyre. Ky konflikt apo dualizëm në botën frymore karakterizon letërsinë apokaliptike. Ekziston një betejë për kontrollin e zemrave dhe të mendjeve të fëmijëve të Adamit.

2:10 “Mos ki frikë” Kjo është një urdhërore e tashme pasive ose e mesme me parashtesë negative e cila zakonisht nënkupton që të ndalosh një veprim që tanimë është në proces e sipër. Këto kisha kishin frikë. Persekutimi ishte një shenjë e shpëtimit të tyre dhe bekimeve të Perëndisë (shih Mate. 5:10-12).

▣ **“ja, djalli do të hedhë disa prej jush në burg”** Pas drejtuesve të këqij njerëzorë qëndron një fuqi personale mbinatyrore e të ligut (shih Efes. 6:10-19).

Termi Satan është një titull dhe përshkrim i Dhjatës së Vjetër. Detyra e tij ishte që të ofronte një alternative rebele, të vetë-qendëruar dhe me anë të kësaj t’i akuzonte ata kur ata binin në tundim (shih Zanafilla 3; Jobi 1-2; Zakaria 3). Ndodh një zhvillim i së keqes në Dhjatën e Vjetër. Satani u krijua si një shërbëtor dhe u bë një armik (shih *An Old Testament Theology* [Një Teologji e Dhjatës së Vjetër] nga A. B. Davidson [Ej Bi Dejvidson] fq. 300-306).

Është me siguri një supozim që gjuha figurative e lartë e Isaias 14, e cila në mënyrë të drejtëpërdrejtë i referohet mbretit arrogant të Babilonisë, dhe Ezekieli 28, i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë i referohet mbretit krenar të Tirës, në fund të fundit identifikon krenarinë dhe rënien frymore të Satanit. Gjuha e Ezekielit 28 merret nga një përshkrim i Kopështit të Edenit. Është e vështirë të pranosh një përshkrim të një mbreti pagan, njerëzor, historik në terma engjëllor të marra nga Kopështi i Edenit (shih Zanafilla 3). Megjithatë, Ezekieli bën të njëjtën gjë me mbretin e Egjiptit në kapitullin 31. Ai përshkruhet si një pemë e madhe në kopështin e Edenit.

Të gjithë besimtarët dëshirojnë shumë me tepër informacion, sidomos mbi origjinat e Perëndisë, engjëjve, së keqes etj. Ne duhet të bëjmë kujdes për të mos kthyer përshkrimet metaforike dhe profetike në teologji dogmatike. Një pjesë e madhe e teologjisë moderne vjen nga tekste të izoluara figurative të përzjera me koncepte moderne, si teologjike ashtu edhe letrare (Dante dhe Milton).

Në Dhjatën e Re ai quhet djalli (shih Zbu. 12:9,12; 20:2,10), i cili është një term i përbërë grek i cili do të thotë të “hedhësh tej”, “të vrasësh”, ose “të fillosh akuzat kundër”. Kjo sërish reflekton detyrën e tij për të akuzuar dhe për të tunduar. Këto terma janë sinonime në Zbulesë (shih Zbu. 12:9; 20:2). Shih [SPECIAL TOPIC: PERSONAL EVIL](#) [TEMA TË VEÇANTA: E KEQJA PERSONALE] tek Zbu. 12:9.

▣ **“që të provoheni”** Ky term përdoret në dy kuptime: (1) besimtarët provohen që të tregojnë besimin e tyre të vërtetë dhe të bëhen më të fortë (shih Zbu. 2:10; Veprat e Apo. 14:27; Rom. 5:3-4; 8:17-19; Heb. 5:8; Jakob 1:2-4; 1 Pjet. 4:12-19) dhe (2) jobesimtarët provohen për të treguar mosbesimin e tyre dhe gjykimin e merituar (shih Zbu. 3:10). Në Zbulesë sprovat e të krishterëve quhen “fatkeqësi” (shih Tema të veçanta tek Zbu. 2:9), ndërkohë që jobesimtarët i nënshtrohen “zemërimit të Perëndisë”.

Kishte dy terma në greqisht të përkthyer “test”, “sprovë” ose “tundim”. Njëri nënkuptonte “të testosh me një pikëpamje drejt shkatërrimit” (*peirasmos, peirasmō*). Termat e tjerë (*dokimos, dokimazo*) nënkuptonin “të testosh me një pikëpamje drejt miratimit”. Djalli tundon që të shkatërrojë; Perëndia sprovon që të forcojë (shih 1Thes. 2:4; 1 Pjet. 1:7; Zan. 22:1; Eksod. 16:4; 20:20; Ligji i Përt. 8:2,16; 13:3; Gjyqt. 2:22; 2 Kron. 32:31). Shih Tema të veçanta tek Zbu. 2:2.

▣ **“dhjetë ditë”** Ka pasur shumë spekulim mbi frazën “dhjetë ditë”:

1. Disa thonë se i referohet një përiudhe vërtetë dhjetë ditore të persekutimit në qytetin e Smirnës në ditët e Gjonit
2. Të tjerë thonë se për shkak se numri dhjetë është numri i plotësisë, thjesht nënkupton një numër të plotë ditësh persekutimi
3. Disa thonë se i referohet një periudhe të paspecifikuar persekutimi

Lajmi i mirë është që ka një kufi. Persekutimi do të përfundojë!

Megjithatë, në një libër apokaliptik kurrë nuk je i sigurtë nëse numrat janë figurativë apo të vërtetë. Nëse numri përdoret shpesh në Dhjatën e Vjetër dhe në literaturën ndërbiblike apokaliptike me një kuptim simbolik, atëherë me shumë mundësi është figurativ. Numrat simbolikë të përdorur më shpesh janë 3, 4, 6, 7, 10, 12 dhe shumëfishët e tyre (shih Tema të veçanta tek Zbu. 1:4).

▣ **“ji besnik deri në vdekje”** Kjo është një formë urdhërore e tashme e mesme ose pasive (dëshmuse) e cila thekson nevojën e besimtarit për të vazhduar në besim edhe nëse kjo do të thotë vdekje fizike (shih Mate. 2:13; 12:11; 10:22; 24:13; Luka 12:4; Gal. 6:9). Disa besimtarë u vranë dhe vriten. Ky është paradoksi i sovranitetit të Perëndisë dhe eksperiencia jonë në një botë të rënë.

▣ **“dhe unë do të të jap kurorën e jetës”** Kjo ishte kurora e jetës e quajtur “*stephanos*” (shih 1 Kor. 9:25). Ishte shpërblimi i martirëve të krishterë. Ne mësojmë nga libri *Ecclesiastical History* [Historia e Kishës], 4:15 i

Eusebiusit [Eusebit] se kishte shumë martirë, përfshirë peshkopin Polycarp [Polikarp] të Smirëns. Gjithashtu ka edhe kurora (shpërblime) të tjera të përmendura në Dhjatën e Re (shih 2 Tim. 4:8; Jakobi:12; 1 Pjet. 5:4; Zbu. 3:11).

Gjoni përdor termin për jetën, *zoç*, për t'iu referuar jetës së përjetshme, jetës së ringjalljes (shih Gjoni 1:4; 3:15,36; 4:14,36; 5:24,26,29,39,40; 6:27,33,35,40,47,48,51,53,54,63,68; 8:12; 10:10,28; 11:25; 12:25,50; 14:6; 17:2,3; 20:31; Zbu. 2:7,10; 3:5; 13:8; 17:8; 20:12,15; 21:6,27; 22:1,2,14,17,19). Jeta e vërtetë është shumë më tepër se ekzistenca fizike!

SPECIAL TOPIC: DEGREES OF REWARDS AND PUNISHMENT [TEMA TË VEÇANTA: SHKALLË SHPËRBLIMI DHE DËNIMI]

2:11 “kush fiton” Ky është gjithashtu një paralajmërim i përsëritur për besnikët (shih Zbu. 2:7,17,26; 3:5,12,21; 21:7). Me shumë mundësi është një theks mbi këmbënguljen (shih Tema të veçanta tek Zbu. 2:2).

▣ **“nuk do të preket nga vdekja e dytë”** Kjo është një formë konstruktive dyfish mohuese me lidhore aoriste pasive e cila tregon perkujdesin e sigurtë të Perëndisë për ata që martirizohen (shih Zbu. 12:11). “Vdekja e dytë” i referohet ferrit (shih Tema të veçanta: tek Zbu. 1:18) ose ndarjes së përjetshme nga marrëdhënia me Perëndinë (shih Zbu. 20:6,14; 21:8).

▣ **“kush ka veshë, le të dëgjojë”** Ky është një paralajmërim i përsëritur për vëmendje dhe dallim frymor (shih Zbu. 2:7,11,17,29; 3:6,13,22; 13:9).

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 2:12-17

¹² “Dhe engjëllit të kishës në Pergam, shkruaj: Këto gjëra thotë ai që ka shpatën e mprehtë me dy tehtë: ¹³ Unë i di veprat e tua dhe ku banon, atje ku është froni i Satanit; dhe ti mbahesh fort tek emri im dhe nuk e mohove besimin në mua, edhe në ato ditë kur Antipa, dëshmitari im, besnik, u vra midis jush, atje ku banon Satani. ¹⁴ Por kam disa gjëra kundër teje: sepse ke aty disa që mbajnë mësimin e Balaamit, i cili e mësoi Balakun t' u vërë një gurë pengese përpara bjive të Izraelit që të hanë flijime idhujsh dhe të kurvërojnë. ¹⁵ Kështu ti ke edhe disa që mbajnë mësimin e Nikolaitëve, të cilën gjë e urrej. ¹⁶ Pendohu, përndryshe do të vij së shpejti te ti dhe do të luftoj kundër tyre me shpatën e gojës sime. ¹⁷ Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që Fryma u thotë kishave: kujt fiton do t' i jap të hajë nga mana që është fshehur; dhe do t' i jap një gur të bardhë, dhe mbi gur është shkruar një emër i ri, të cilin s' e njeh askush, përveç atij që e merr”.

2:12 “Ai që ka shpatën e mprehtë me dy tehtë” Kjo është e njëjta reference ndaj Jezusit të lavdëruar që gjendet tek Zbu. 1:16. Ishte një metaforë e Dhjatës së Vjetër për YHWH (shih. Isa. 11:4; 49:2). Ajo përdoret në Dhjatën e Re për fuqinë depërtuese të fjalës së Perëndisë (shih Zbu. 2:16; 2 Thes. 2:8; Heb. 4:12).

2:13 “unë e di ku banon” “Banim” në Dhjatën e Vjetër nënkuptonte “të jetoje në mënyrë të përherëshme”. Këta besimtarë përballëshin me presion të fuqishëm nga qeveria vendase dhe nga djalli. Jezusi i njihte ata dhe e dinte situatën e tyre të rrezikshme. Ai ishte atje me ta.

▣ **“atje ku është froni i Satanit”** Ka pasur disa interpretime të mundshme për këtë frazë:

1. Mund t' i referohet një froni të madh të Zeusit i cili ndodhej në Pergam.
2. Mund t' i referohej perëndisë së shërimit, Asclepios, simboli i të cilit ishte një gjarpër.

3. Duket se i gjithë qyteti i ngjante një froni gjigand për shkak të Akropolisit i cili qëndronte qindra metra mbi vetë qytetin.
4. Mund të ketë qënë një reference ndaj Concilia [Konsilias], organizatës vendase për të promovuar adhurimin e perandorit, i cili ishte shumë i fuqishëm në Pergam.

Për shkak të kontekstit historik, ose numri 1. ose numri 4. duken më të përshtatshmit.

▣ **“ti mbahesh fort tek emri im”** Kjo është një formë treguese e tashme aktive. Ajo tregon rëndësinë e emrit si të përfaqësonte karakterin e një personi. Besimtarët besojnë me anë të thirrjes së emrit të Tij (shih Gjoni 1:12; 3:18; Rom. 10:9-13) dhe adhurojnë duke thirrur emrin e Tij (shih Zan. 4:26; 12:8; 26:25) dhe këmbëngulin me anë të thirrjes ndaj emrit të Tij (shih Gjoni 17:11-12).

SPECIAL TOPIC: THE NAME OF THE LORD [TEMA TË VEÇANTA: EMRI I ZOTIT]

▣ **“dhe nuk e mohove besimin në mua”** Kjo është një formë treguese aoriste e mesme (dëshmuese). Gjatë këtyre shekujve të parë të krishtërimit, edhe sot në disa shoqëri, ka pasur një tundim të vërtetë për të ruajtur pasurinë apo jetën e vet personit duke mohuar besimin në Krisht gjatë sprovave fizike apo gjyqësore. Kisha gjithnjë ka pasur vështirësi se si t’i trajtonte këta femohues.

SPECIAL TOPIC: FAITH (PISTIS [noun], PISTEUŌ, [verb], PISTOS [adjective]) [TEMA TË VEÇANTA: BESIM (PISTIS – emër, PISTEUŌ – folje), PISTOS – mbiemër]

▣ **“Antipa, dëshmitari im”** Ne nuk dimë asgjë për këtë njeri. Titulli që i është dhënë atij është i njëjti me atë të përdorur për Krishtin në Zbu. 5:1. Termi “dëshmitar” mund të nënkuptojë “martir” (shih 11:3; 17:6). Tertuliani tha se Antipa u poq në një furrë derri[†], por kjo ishte një traditë e mëvonshme.

2:14 “por kam disa gjëra kundër teje” Jezusi kishte nga një pohim negativ për gjashtë nga shtatë kishat. Jetesa e drejtë në disa zona nuk e përlligj mëkatin në zona të tjera!

▣ **“sepse ke aty disa që mbajnë mësimin e Balaamit”** Balaami ishte një profet i Perëndisë (shih Num. 24:2) i cili u mashtrua për të ndihmuar në kompromisin e popullit të Izraelit (shih Num. 22-25 dhe 31:16). Ai u dënua edhe në Dhjatën e Vjetër edhe në Dhjatën e Re (shih Num. 31:16; 2 Pjet. 2:15; Juda 11). Ekziston mundësia që emri Balaam në hebraisht të kishte kuptim “pushtues i popullit” dhe emri Nikolaitë të ketë pasur të njëjtin kuptim në greqisht (Nikodemusi i Gjonit 3 gjithashtu kishte një kuptim të ngjashëm). Kjo do t’i identifikonte këta dy grupe me praktikatat e tyre imorale (shih Jezabel, 2:20).

▣ **“i cili e mësoi Balakun t’u vërë një gurë pengese përpara bijve të Izraelit”** Sugjerimi i Balaamit ndaj Balakut, mbretit të Moabit, ishte që të përfshinte bijtë e Izraelit në adhurim fertiliteti ndaj Ba’al (shih Num. 25:1-3). Kishte një tundim kulturor të vazhdueshëm ndaj praktikave të adhurimit seksual të paganëve të shekullit të parë.

SPECIAL TOPIC: ISRAEL (THE NAME) [TEMA TË VEÇANTA: IZRAELI (EMRI)]

[†] Një nga format e torturave të përdorura nga romakët ishte vendosja e të dënuarit brenda një demi të bronzit dhe ndezja e një zjarri poshtë tij. (Shënim i përkthyesit)

▣ **“që të hanë flijime idhujsh dhe të kurvërojnë”** Këto dy mëkate përfshinin praktika pagane të adhurimit (shih Num. 25:1-3 dhe 31:16). Jo vetëm kishte vakte pagane ku ushqimi iu sakrifikohej idhujve (shih 1 Kor. 8:1-13), por shpesh imoraliteti seksual ishte një praktikë adhurimi normale dhe e pritshëm në këto mbledhje pagane. Aktiviteti njerëzor seksual supozohej se nënkuptonte të siguronte shëndetin dhe pjellorinë e tufave, të korrave dhe të shoqërisë.

2:15 “ti ke edhe disa që mbajnë mësimin e Nikolaitëve” Për shkak të ngjashmërisë së mësimëve të Balaam-it, Nikolaitët (shih 2:6) dhe Jezabeli (shih 2:20), të tre këto i referohen praktikave pagane dhe idhujtare të adhurimit. Besimtarët nuk duhet t’iu referohen apo të bëjnë kompromis me kulturat pagane.

2:16 “pendohu” Shih shënimin tek Zbu. 2:5.

▣ **“përndryshe do të vij së shpejti te ti dhe do të luftoj kundër tyre me shpatën e gojës sime”** Kjo është një formë urdhërore aoriste aktive. Ekziston një theks i vazhdueshëm ndaj pendesës (shih Zbu. 2:5,16,22; 3:3,19). Ardhja mund t’i referohej një gjykimi të përkohshëm kundër kishës ose Ardhjes së Dytë të Krishtit për të gjykuar botën. Është e rëndësishme që e gjithë kisha të thirret për t’u penduar (shih Zbu. 3:20; 2 Kro. 7:14) për shkak të mëkatit të disave; nëse nuk e bënin, pasojat do të ishin disiplinim korporativ! Shih Tema të veçanta: Rikthimi i shpejtë tek Zbu. 1:2.

2:17 “do t’i jap të hajë nga mana që është fshehur” Mana ishte sigurimi i mbinatyrshëm i Perëndisë për bijtë e Izraelit gjatë Periudhës së Endjes në Shkretëtirë (shih Eksodi 16:14-15,31; Psal. 78:17-33, veçanërisht Zbu. 2:24). Ka pasur disa teori të propozuara për të interpretuar këtë frazë kriptike:

1. Mund t’i referohej Arkës së Besëlidhjes që u soll nga vendi i fshehur nga Jeremia nga Mali Nebo (shih II Maccabees [Makabeu II] 2:4-8) sepse përmbante një ene me mana (shih Eksod. 16:32-34; Heb. 9:4).
2. Mund t’i referohej ushqimit të epokës së re të drejtësisë (shih II Baruch [Baruku II] 29:8).

Referenca e saktë është e pasigurtë por ishte qartazi një aludim ndaj epokës së re të Frymës të inaguruar nga Krishti. Disa madje kanë mbrojtur idenë se për shkak të Gjonit 6:31-35, mana e fshehur i referohet Vetë Krishtit. Ky është një shembull i mirë i vështirësisë në interpretim të detajeve specifike të këtij libri, të cilin dëgjuesi i asaj kohe e kuptonte, por që referenca e saktë e saj është humbur.

▣ **“dhe do t’i jap një gur të bardhë”** Ky gur, i quajtur gjithashtu *Tessera*, kishte shumë përdorime në Lindjen e Afërme Antike.

1. Ai mund të përdorej si një biletë për bankete të veçanta
2. Ai mund të përdorej për të votuar për shfajësim nga një juri
3. Ai mund të përdorej si një simbol i fitores për një atlet
4. Ai mund të përdorej për të treguar lirinë e një skllavi.

Në këtë kontekst, pika 1. duket të jetë më e përshtatshme, duke iu referuar Banketit Mesianik (një temë e zakonshme në literaturën hebraike apokaliptike).

▣ **“dhe mbi gur është shkruar një emër i ri, të cilin s’e njeh askush, përveç atij që e merr”** Ky emër i ri duket se është simbol për Epokën e Re ose për një titull për Mesian (shih Isa. 56:5; 62:2; 65:15; shih [SPECIAL TOPIC: MESSIAH](#) [TEMA TË VEÇANTA: MESIA] tek Zbu. 1:1). Ky emër i ri përdoret shpesh në librin e Zbulesës (shih Zbu. 3:12; 14:1; 19:12,13,16; 22:4).

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 2:18-29

¹⁸ **“Edhe engjëllit të kishës në Tiatirë shkruajti: Këto gjëra thotë Biri i Perëndisë, ai që ka sytë si flakë**

zjarri dhe këmbët e tij janë të ngjashme me bronz të shkëlqyeshëm.¹⁹ Unë i njoh veprat e tua, dashurinë tënde, besimin tënd, shërbimin tënd, durimin tënd dhe di që veprat e tua të fundit janë më të shumta se të parat.²⁰ Por kam disa gjëra kundër teje, sepse ti e lejon gruan Jezabel, që e quan veten profeteshë, të mësojë dhe t'i mashtrorë shërbëtorët e mi të kurvërojnë dhe të hanë gjëra të flijiuara idhujve.²¹ Dhe i dhashë kohë që të pendohet për kurvërinë e saj, por ajo nuk u pendua.²² Ja, unë e flakë atë në një shtrat *vuajtjesh*, dhe ata që kurvërojnë me të, në shtrëngim të madh, po nuk u penduan për veprat e tyre;²³ Dhe do t'i godas me vdekje bijtë e saj; dhe të gjitha kishat do të njohin se unë jam ai që heton mendjet dhe zemrat; dhe do t'i jap gjithsecilit nga ju sipas veprave të veta.²⁴ Por juve dhe të tjerëve që janë në Tiatirë, që nuk kanë këtë doktrinë dhe nuk i kanë njohur thellësisht e Satanit, siç e quajnë ata, unë them: nuk do të vë barrë tjetër mbi ju;²⁵ por mbajeni fort atë që keni, derisa të vij.²⁶ Dhe kujt fiton dhe i ruan deri në fund veprat e mia, **DO T'I JAP PUSHTET MBI KOMBET;** **DHE AI DO T'I QEVERISË ATA ME NJË SHUFËR HEKURI DHE ATA DO TË THYHEN SI ENË ARGJILE,** sikurse mora edhe unë pushtet prej Atit tim;²⁸ dhe unë do t'i jap atij yllin e mëngjesit.²⁹ Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që Fryma u thotë kishave”.

2:18 “Biri i Perëndisë” ishte shumë e zakonshme t'i referohesh Jezusit si “Bir”. Titulli më i zakonshëm që përdor këtë metaforë ishte “Biri i njeriut”, i cili ishte titulli i vetë-zgjedhur i Jezusit. Termi tjetër ishte “Biri i Perëndisë” i cili ishte përcaktimi i zakonshëm për Jezusin në shkrimet e Gjonit (shih Gjoni 1:34,49; 5:25; 9:35; 10:36; 11:4,27; 19:7; 20:31; 1 Gjonit 3:8; 4:15; 5:5,10,12,13,20). Një përdorim i tretë i fjalës “bir” gjendet tek letra e Hebrenjve (shih Heb. 1:2; 3:6; 5:8; 7:28). Ai është një anëtar i plotë i familjes me Atin. Kjo nuk është një nga frazat përshkruese nga kapitulli 1. Ky term, ashtu sikurse termi “i lindur prej virgjëreshës”, u përdorën gjerësisht nga autorët e Dhjatës së Re me shumë mundësi për shkak të keqkuptimit të dëgjuesve paganë, të cilët menjëherë i lidhnin këto terma me përdorimet e tyre në panteonet pagane. Perënditë dhe perëndeshat homerike shpesh ishin seksualisht aktivë me njerëzit duke prodhuar breza të veçantë.

SPECIAL TOPIC: THE SON OF GOD [TEMA TË VEÇANTA: BIRI I PERËNDISË]

▣ **“ai që ka sytë si flakë zjarri dhe këmbët e tij janë të ngjashme me bronz të shkëlqyeshëm”** Ky ishte një titull tjetër për Jezusin i marrë nga Zbu. 1:14,15. Ky është një aludim ndaj Danielit 10:6 duke treguar origjinën qiellore të Jezusit. Është e mundur që ai përdorej i lidhur me Tiatirën për shkak se ky qytet ishte i njohur për enët e ushqimit prej bronxi.

2:19 Ky varg përbën pranimin e Jezusit për shërbesën e besimtarëve në Tiatirë. Ata ishin aktivë në punën e mbretërisë dhe po bëheshin edhe më aktivë. Megjithatë, ky pranim nuk e justifikonte heresinë e Zbu. 2:20.

2:20 “Por kam këtë kundër teje, sepse ti e lejon gruan Jezabel, që e quan veten profeteshë” Ky është një aludim për Jezabelën e 1 Mbret. 16:31-33; 2 Mbret. 9:21-22. Alexandrinus (MSS A) shton “Ju” përpara Jezabel, që nënkupton se ajo mund të ketë qënë bashkëshortja e pastorit të kësaj kishe ose një drejtuese aktive e kishës. Por ky është një spekulim. Mësimet e saj (shih Zbu. 2:20c) ishin të ngjashme me ato të Balaamëve në Zbu. 2:14b dhe të Nikolaitëve në Zbu. 2:15.

Jezabel nuk u refuzua për shkak se ajo ishte një profeteshë grua. Ka shumë shembuj të grave drejtuese të perëndishme.

1. Miriam, Eksod. 15:20
2. Debora, Gjyqtarët 4:4
3. Huldah, 2 Mbret. 22:14
4. Ana, Luka 2:36

5. Vajzat e Filipit, Veprat e Apostujve 21:9
6. Fibi, Romakëve 16:1

SPECIAL TOPIC: WOMEN IN THE BIBLE [TEMA TË VEÇANTA: GRA NË BIBËL]

2:21 Mëshira dhe durimi i Perëndisë ashtu sikurse dhe drejtësia e Tij janë të dukshme tek Zbu. 2:21-23 (shih Rom. 2:5).

2:22 “Ja, unë e flakë atë në një shtrat vuajtjesh” Kjo është një sarkazëm e lidhur me shtratin e saj të tradhëtisë bashkëshortore (mësimdhëniet mbi imoralitetin).

▣ **“shtëngim të madh”** Shih [SPECIAL TOPIC: TRIBULATION](#) [TEMA TË VEÇANTA: TRAZIRA] tek Zbu. 2:9 dhe fundin e madh të kohërave tek Zbu. 7:14.

▣ **“nëse nuk pendohen për veprat e tyre”** Kjo është një kushtore e klasës së tretë, e cila i referohet veprimeve të mundshme në të ardhmen por me një element kontigjence.

2:23 “dhe do t’i godas me vdekje bijtë e saj” Kjo nuk i referohet fëmijëve të vërtetë, por ndjekësve të saj (shih Zbu. 2:22; 2 Gjonit 1:1).

▣ **“dhe të gjitha kishat do të njohin”** Kjo tregon se shtatë letrat duhej të lexoheshin dhe e vërteta e tyre të aplikoheshin nga të gjitha kishat, atëherë dhe tani. Për “kishën” shih Tema të veçanta tek Zbu. 1:4.

▣ **“Unë jam Ai që heton mendjet dhe zemrat”** Bibla pranon se Perëndia i njeh motivet dhe mendimet e të gjithë njerëzve (shih Ps. 7:9, 26:2; 39:1; Pro. 24:12; Jer. 11:20; 17:10; Luka 16:15; Veprat e Apo. 1:24; Heb. 4:12-13; 8:27).

SPECIAL TOPIC: THE HEART [TEMA TË VEÇANTA: ZEMRA]

▣ **“dhe do t’i jap gjithsecilit nga ju sipas veprave të veta”** Kjo e vërtetë frymore gjendet kaq qartazi në Galatasit 6:7. Ne korrim atë që mbjellim. Ky parim nuk nënkupton një shpëtim me anë të përpjekjeve njerëzore (shih Efes. 2:8-9), por se ata që kanë takuar Perëndinë në Krishtin do të jetojnë jetë të perëndishme, të dashura dhe shërbyese (shih 3:12; Mate. 25:1-46; Efes. 2:10).

Ky është një parim frymor. Perëndia është moral dhe etik dhe po kështu është dhe krijimi i Tij. Njerëzit thyejnë vetë standartet e Perëndisë. Ne korrim atë që mbjellim. Kjo është e vërtetë për besimtarët (por nuk ndikon mbi shpëtimin) dhe jobesimtarët (shih Job 34:11; Ps. 28:4; 62:12; Pro. 24:12; Predi. 12:14; Jer. 17:10; 32:19; Mate. 16:27; 25:31-46; Rom. 2:6; 14:12; 1 Kor. 3:8; 2 Kor. 5:10; Gal. 6:7-10; 1 Tim. 4:14; 1 Pjet. 1:17; Zbu. 2:23; 20:12; 22:12).

2:24 “thellësit e Satanit” Ka disa teori të lidhura me këtë frazë. Ato mund t’i referohen

1. Një fraze kapëse të Jezabel dhe ndjekësve të saj
2. Theksi i mësuesve të rremë gnostikë ndaj njohurisë
3. Riteve iniciuese të feve të misterit në Perandorinë Romake
4. Në një mënyrë antithetike, ndaj “thellësirave të Perëndisë” (shih Rom. 11:33; 1 Kor. 2:10; Efe. 3:18)

▣ **“nuk do të vë barrë tjetër mbi ju”** Ky është një afirmim i besimtarëve të vërtetë në qytetin e Tiatirës. Ata kanë një besim aktiv dhe agresiv (shih Zbu. 2:19).

2:25 “mbajeni fort atë që keni, derisa të vij” Ndjekësit e e Krishtit duhet të qëndrojnë fort (shih Zbu. 2:20) në mes të persekutimit, heresisë dhe apatisë. Ky është një urdhërim (formë aoriste aktive imperative). Jezusi është rrugës, Ai do të vijë së shpejti (shih Zbu. 2:16, 22:7,20). Këto janë shpresa dhe inkurajimi i çdo brezi të krishterësh.

2:26-27 Ky është një aludim ndaj Psalmeve 2:8-9, ndoshta me Isa. 30:14 dhe Jer. 19:11 gjithashtu. Jezusi është mbreti Mesianik. Mbretëria e Tij po vjen në fuqi dhe konsumim mbarëbotëror. Do t’ia vlejë gjithçka kur ndjekësit e Tij të shohin Atë!

2:26 “kombet” Përdorimi i këtij termi nga Dhjata e Vjetër nënkupton se ai i referohet atyre jashtë besëlidhjes së YHWH (përrjashtim bën 7:9). Kjo bëhet një mënyrë për t’iu referuar njerëzve të paperëndishëm dhe të këqij (shih Zbu. 2:26; 5:9; 10:11; 11:2,9,18; 12:5; 13:7; 14:6,8; 16:19; 17:15; 18:3,23; 19:15; 20:8).

2:27 “sikurse mora dhe unë pushtet prej Atit tim” Jezusit tanimë i është dhënë i gjithë autoriteti (shih Psalmet 2; Mate. 28:18; Fil. 2: 9-11). Mbretëria e Jezusit ishte e pranishme por jo e konsumuar. Citimi nga Dhjata e Vjetër në vargun 27 është nga Psalmi 2:8 i cili fillimisht i referohej Mesias (shih Zbu. 12:5; 19:15), por aty ai përdoret për besimtarët të cilët vendosin besimin e tyre në Jezus Krishtin. Ata sundojnë me Të. Shih Tema të veçanta tek Zbu. 5:10.

2:28 “dhe unë do t’i jap atij yllin e mëngjesit” Ka pasur disa interpretime të mundshme për këtë frazë:

1. I referohej një metafore për Krishtin (shih Zbu. 22:16)
2. I referohej një marrëdhënie dhe njohjeje intime me Krishtin (shih 2 Pjet. 1:19)
3. I referohej ringjalljes (shih Dan. 12:3)
4. I referohej Mesias ushtarak të përmendur te Num. 24:17
5. I referohej gëzimit të popullit të Perëndisë (shih Jobi 38:7)
6. I referohej një fraze të përdorur për Satanin tek Isa. 14:12, por tani për Krishtin

2:29 Shih shënimin tek Zbu. 2:7.

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 3:1-6

¹ “Dhe engjëllit të kishës në Sardë shkruaji: këto gjëra thotë ai që ka të shtatë Frymërat e Perëndisë dhe të shtatë yjet. Unë i di veprat e tua; ti ke emrin se jeton, por je i vdekur. ² Ji syçelë dhe forco mbetjen e gjërave që gati po vdesin, sepse nuk i gjeta të përkryera veprat e tua përpara Perëndisë tim. ³ Kujto, pra, atë që more dhe dëgjove, dhe ruaje edhe pendohu. Po të mos rri sh zguar, unë do të vij te ti si vjedhës, dhe nuk do të dish në ç’orë do të vij te ti. ⁴ Por ke disa veta në Sardë, që nuk i ndotën petkat e tyre; edhe do të ecin me mua të veshur në të bardha, sepse janë të denjë. ⁵ Kush fiton do të vishet me rroba të bardha dhe unë nuk do ta fshij emrin e tij nga libri i jetës, por do të rrëfej emrin e tij përpara Atit tim dhe para engjëjve të tij. ⁶ Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që Fryma u thotë kishave”.

3:1 “kishë” Shih Tema të veçanta tek Zbu. 1:4.

▣ **“Ai që ka të shtatë Frymërat e Perëndisë dhe shtatë yjet”** Kjo frazë është një tjetër aludim ndaj Krishtit të perlëvdur (shih Zbu. 1:4,16,20). Shtatë yjet i referohen kishave dhe drejtuesve të saj në Zbu. 1:20; shtatë frymërat mund të jenë një metaforë e lidhur sepse tek Zbu. 4:5 ato lidhen me shtatë shandanët, të cilët gjithashtu përmenden tek Zbu. 1:20 duke iu referuar kishave. Këto shtatë frymëra të Perëndisë gjithashtu përmenden tek Zbu. 5:6 si pjesë e përshkrimit të qengjtit. Shih Tema të veçanta: Shtatë Frymërat tek Zbu. 1:4.

▣ **“Unë i di veprat e tua”** Jezusi ishte i ndërgjegjshëm për pikat e forta dhe dobësitë e kishave të Tij (shih Zbu. 2:2,19; 3:1,8,15).

NASB, NKJV	“se ti ke emër që je e gjallë”
NRSV	“se ti ke emër për të qënurit e gjallë”
TEV	“se ti ke një reputacion për të qënurit e gjallë”
NJB	“se si ti supozohesh se jeton”

Kjo ishte një zbuluesë shkatërruese. Ata mendonin se ishin drejt me Perëndinë, duke e kënaqur Atë frymërisht (shih Isa. 29:13; Rom. 2:19-20; Kol. 2:16-23; 2 Tim. 3:5), por nuk ishte kështu!

3:2

NASB, NRSV, TEV, NJB	“Zgjoju”
NKJV	“Ji syçelë”

Kjo është një formë urdhërore në kohën e tashme të mesme (deponente) me një pjesore të tashme aktive, fjalë për fjalë “ji vazhdimisht duke vëzhguar”. Kjo është e para nga pesë urdhëroret e gjetura në vargjet 2 dhe 3. Jezusi urdhëron kishën e Tij që të jetë syçelë.

NASB, NKJV	“forco gjërat që mbeten”
NRSV	“forco atë që mbetet”
TEV	“forco atë që ende ke”
NJB	“ver vendosmëri në atë pak fuqi që ende të ka mbetur”

Kjo është një formë urdhërore aoriste aktive. Ata duhet të vepronin tani dhe të vazhdonin të vepronin për të ruajtur atë që mbetet nga besimi i tyre që po vdiste.

▣ **“sepse nuk i gjeta të përkryera veprat e tua përpara Perëndisë tim”** Folja e parë është në formën treguese aktive të përkryer. Ata mund të jenë dukur frymorë (shih Isa. 29:13), por ata ishin më shumë si njerëzit fetarë të përmendur tek Mate. 7:21-23 dhe Kol. 2:16-23. Termi “të plotësuar”[‡] është pjesore pasive e përkryer duke nënkuptuar “e pjekur, e përsosur, e pajisur për detyrën e përcaktuar”. Ata nuk e kishin lejuar Perëndinë që të plotësonte atë që besimi kishte nisur (shih Fil. 1:6).

3:3 “Kujto, pra, atë që more dhe dëgjove” Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme e ndjekur nga një formë urdhërore aktive e përkryer dhe nga një urdhërore aoriste aktive. Kjo lidhet me ungjillin të cilin ata e kishin dëgjuar dhe vazhdonin ta merrnin. Krishtërimi nuk është vetëm një vendim, por është një marrëdhënie stili jetese. Ajo përfshin të besosh një mesazh dhe të marrësh një person. Ajo rezulton në një jetë të ndryshuar dhe në ndryshim prej pendese (urdhërore aoriste aktive, Zbu. 3:3b) dhe prej bindjeje (urdhërore aktive e tashme, Zbu. 3:3b).

▣ **“ruaje”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme e cila është një urdhërim i vazhdueshëm.

[‡] Versioni në shqip është “të përkryera”. (Shënim i përkthyesit)

▣ **“pendohu”** Kjo është një formë urdhërore aktive aoriste e cila nënkupton një pendesë të plotë. Shih shënimin tek Zbu. 2:5.

▣ **“Po të mos rrish zgjuar”** Kjo është një fjali kushtore e klasës së tretë si tek 2:22. Veprimi është i mundur, i kushtëzuar ndaj përgjigjes së tyre ndaj urdhërimeve të Jezusit, por jo i sigurtë.

▣ **“Unë do të vij si vjedhës”** Kjo shpesh përdoret për Ardhjen e Dytë (shih Mate. 24:43-44; Luka 12:39-40; 1 Thesa. 5:2,4; 2 Pjet. 3:10; Zbu. 16:15). Megjithatë, në këtë kontekst ajo duket se i referohet një gjykimi të përkohshëm të kësaj kishe.

3:4 “ke disa veta në Sardë, që nuk i ndotën petkat e tyre” Veshja dhe heqja e rrobave përdoret si një metaforë e jetës së krishterë (shih Efes. 4:22,24,25,31; Kol. 3:8,10,12,14; Heb. 12:1; Jako. 1:21; 1 Pjet. 2:1). Disa besimtarë nuk ishin kompromentuar me kulturën pagane.

▣ **“ata do të ecin me mua të veshur në të bardha”** Veshja e bardhë përdoret si një simbol i pastërtisë ose i fitores tek Zbu. 3:4,5,18; 6:11; 7:9,13-14; 19:14. Termi “ecë” përdoret shpesh si një metaforë e jetës së krishterë (shih Zbu. 3:5; 21:24; 1 Gjonit 1:6,7; 2:6,11; 3 Gjonit 3-4).

3:5 “kush fiton” Katër gjëra do t’i jepen atij që fiton.

1. Ata do të ecin me Mesian, Zbu. 3:4
2. Ata do të vishen me të bardha
3. Emrat e tyre nuk do të fshihen kurrë nga libri i jetës
4. Mesia do t’i njoh ata si të vetët në praninë e Atit dhe të engjëjve të Tij

Shih Tema të veçanta mbi Këmbënguljen tek Zbu. 2:2.

▣ **“unë nuk do ta fshij emrin e tij nga libri i jetës”** Kjo është një formë mohore e dyfishtë. Kur qytetarët vdesin, emrat e tyre fshiheshin nga listat e qytetit të tyre por Perëndia nuk do t’i fshijë kurrë besimtarët nga listat e Tij. Kjo frazë metaforike “libri i jetës” gjithashtu gjendet tek Zbu. 20:12-15, ku dy libra përmenden:

1. Libri i jetës i cili përbëhet nga emrat e popullit të Perëndisë (shih Eksod. 32:32-33; Ps. 69:28; Isa. 4:3; Dan. 12:1; Luka 10:20; Fil. 4:3; Heb. 12:23; Zbu. 13:8; 17:8; 20:12,15; 21:27)
2. Libri i veprave apo kujtimeve të cilat regjistrojnë veprat si të të këqijëve ashtu edhe të të drejtëve (shih Ps. 56:8, 139:16; Isa. 65:6; Mal. 3:16). Për “libër” shih shënimet tek Zbu. 5:1.

▣ **“do të rrëfej emrin e tij përpara Atit tim dhe përpara engjëjve të Tij”** Ndërsa besimtarët rrëfejnë Krishtin (“i thërrasin emrit të Tij”, shih Rom. 10:9-13), Ai gjithashtu i rrëfen ata përpara Atit (shih Mate. 10:32; Luka 12:8).

“Rrëfej” është një term grek *exomologeō*. Ai përdoret në tre kuptime:

1. Për të rrëfyer publikisht mëkatet ndaj Perëndisë dhe ndaj të tjerëve që ishin të pranishëm (shih Mat. 3:6; Mark 1:5; Veprat e Apo. 19:18; Jak. 5:16)
2. Për të rrëfyer publikisht besimin në Krishtin (shih Fil. 2:1; dhe ndoshta Rom. 14:11)
3. Për të lavdëruar Perëndinë publikisht (shih Mate. 11:25; Luka 10:21; Rom. 14:11 {Isa. 45:23}; 15:9 [Ps. 18:49])

Termi grek që lidhet me të *homologeō* përdoret në mënyra të ngjashme:

1. Për të pranuar mëkatet (shih 1 Gjonit 1:9)
2. Për të pranuar besimin në Krishtin (shih Mate. 10:32; Luka 10:32; Gjoni 9:22 [negativisht, Gjoni 1:20; 12:42])
3. Për të pranuar një besim në diçka (shih Veprat e Apo. 23:8; 24:14; Heb. 11:13)

SPECIAL TOPIC: CONFESSION [TEMA TË VEÇANTA: RRËFIMI]

3:6 Shih shënimin tek Zbu. 2:7.

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 3:7-13

⁷ “Dhe engjëllit të kishës së Filadelfisë shkruaji: këtë thotë i Shenjti, i Vërteti, ai që ka çelësin e Davidit, ai që hap dhe askush nuk mbyll; dhe mbyll dhe askush nuk hap.” ⁸ Unë njoh veprat e tua; ja, të vura përpara një derë të hapur që asnjëri nuk mund ta mbyllë; sepse ke pak forcë, dhe e ruajte fjalën time edhe nuk mohove emrin tim. ⁹ Ja, unë do të dorëzoh disa nga sinagoga e Satanit, që e quajnë veten Judenj, dhe nuk janë, por gënjejnë; ja, unë do t’i bëj të vijnë dhe të bien përmbys përpara këmbëve të tua, dhe do të njohin se unë të kam dashur. ¹⁰ Sepse e ruajte fjalën e durimit tim, edhe unë do të të ruaj ty nga ora e sprovës që do të vij mbi gjithë botën, për të provuar ata që banojnë mbi dhe. ¹¹ Ja, unë vij shpejt; mbaje fort atë që ke, që të mos të marrë ndokush kurorën tënde. ¹² Kush fiton do ta bëj shtyllë në tempullin e Perëndisë tim, dhe ai nuk do të dalë më përjashta; dhe do të shkruaj mbi të emrin e Perëndisë tim, dhe emrin e qytetit të Perëndisë tim, të Jeruzalemit të ri, që zbret nga qielli nga Perëndia im, dhe emrin tim të ri. ¹³ Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që Fryma u thotë kishave”.

“Ai që është i shenjtë, që është i vërtetë” Vargu 7 është një seri prej katër fjalish përshkruese të bashkërenditura të cilat përshkruajnë Jezusin me titujt për YHWH. “I Shenjtë” përdoret 30 herë tek Isaia për të përshkruar YHWH. Gjoni zakonisht e zëvendësonte termin “i drejtë” (shih Zbu. 15:3; 16:7; 19:2). “I vërtetë” shpesh përdorej për YHWH (shih Isa. 65:16; Jer. 10:10; 1 Gjoni 5:20; Zbu. 15:3; 16:7; 19:2). Dy fjalët e para, “i shenjtë” dhe “i vërtetë” përdoren sërish për Perëndinë tek Zbu. 6:10. Termi “i vërtetë” në greqisht nënkuptonte “i vertetë mbi të rremët”, por në hebraisht ai nënkuptonte “besnik apo i besueshëm”. Jezusi i ka sigurisht të dyja këto attribute (shih Zbu. 3:14; 19:11; 21:5; 22:6).

▣ “çelësin e Davidit” Ky është një aludim ndaj Mesias mbretërore Davidike të 2 Samuelit 7, por veçanërisht të Isa. 22:22, nga ku merret kjo pamje e saktë.

▣ “mbyll dhe askush nuk hap” Kjo i referohet predikimit të ungjillit (shih shënimin tek Zbu. 3:8).

SPECIAL TOPIC: USE OF "DOOR" IN THE NT [TEMA TË VEÇANTA: PËRDORIMI I “DERËS” NË DHJATËN E RE]

3:8 “të vura përpara një derë të hapur që asnjëri nuk mund ta mbyllë” Kjo është një formë treguese aktive e përkryer dhe një pjesore pasive e përkryer. Kjo i referohet ose:

1. Mundësive të predikimit (çelësat, shih Mate.16:19)
2. Hyrjes për në banketin Mesianik (i veshur në të bardha, shih Zbu. 3:4)
3. Një mundësi për shërbesë (shih Veprat e Apo. 14:27; 1 Kor. 16:9; 2 Kor. 2:12; Kol. 4:3)

▣ “sepse ke pak forcë” Kjo është arsyeja e parë nga tre arsyet pse Jezusi hapi një derë të tillë të mrekullueshme mundësie. Kjo është e vetmja nga shtatë kishat tek e cila Jezusi nuk kishte asgjë negative për të thënë.

▣ “dhe e ruajte fjalën Time” koha e foljes (treguese aoriste aktive) nënkuptonte një kohë të veçantë persekutimi apo veprë vendimtare të bindjes. Ata kishin “pak besim”, por e përdornin atë mirë!

▣ **“dhe nuk e mohove emrin Tim”** Kjo mund të ketë qënë një referencë ndaj persekutimit të shkaktuar nga kërkesat e Concilia [Konsilias], mbështetësve lokalë të adhurimit të perandorit (shih Zbu. 2:13).

3:9 “unë do të dorëzoj disa nga sinagoga e Satanit” Kjo mund t’i referohet kundërshtimit hebraik ndaj ungjillit. Kisha, dhe jo hebrenjtë mosbesues, janë populli i vërtetë i Perëndisë.

▣ **“unë do t’i bëj të vijnë dhe të bien përmbys përpara këmbëve të tua”** Ky është një aludim ndaj Isa. 45:14, 49:23; 60:14, i cili fillimisht foli për johebrenjtë që do të vinin tek kombi hebre, por për shkak se të ashtuquajturit hebrenj refuzuan Mesian, ata do të vinin të përluleshin ndaj ketyre johebrenjve besimtarë për t’iu treguar atyre dashurinë e Perëndisë (shih Isa. 43:4,9). Ky është një shembull i mirë se si Dhjata e Re në përgjithësi, dhe Gjoni në veçanti, ka modifikuar profecitë e Dhjatës së Vjetër për sa i përket Izraelit. Gjoni përdor një tekst i cili që në origjinë i shihte johebrenjtë të vinin në një Jeruzalem të restauruar për të adhuruar YHWH, por në një epokë të re të drejtësisë ky imazh gjeo-politik zgjerohet për të përfshirë një botë besimtare (Hebrenj dhe Johebrenj) tek të cilët vijnë hebrenjtë jobesimtarë dhe përulen! Ky universalizim i Izraelit dhe Jeruzalemit tregon se Zbulesa, shumë larg nga të provuarit e një plotësimi të drejtëpërdrejtë të profecive të Dhjatës së Vjetër ndaj një kombi hebre, i ka transformuar ato (shih Efes. 2:11-3:13). Ky është “misteri i ungjillit të fshehur nga kohërat”!

3:10

NASB

“Sepse ti e ke ruajtur fjalën e durimit Tim”

NKJV, NJB

“Sepse ti e ke ruajtur urdhërimin Tim për të duruar”

NRSV

“Sepse ti e ke ruajtur fjalën time të qëndrueshmërisë së duruar”

TEV

“Sepse ti e ke ruajtur urdhërimin tim për të duruar”

Kjo mund të jetë një referencë ndaj Gjoni 8:51 ose 17:6. Jezusi nuk po premton që ta ruajë kishën e Tij nga persekutimi sepse në letrat ndaj shtatë kishave persekutimi, madje edhe vdekja, po ndodhnin.

Vargu 10 i referohet një gjykimi mbarë-botëror të Perëndisë ndaj jobesimtarëve. Është thelbësore të dallosh midis “sprovave” që besimtarët durojnë në besim dhe “zemërimit të Perëndisë” që bie mbi një botë mosbesuese.

Interpretuesit ndryshojnë mbi mënyrën se si kisha do të ruhet në këtë gjykim eskatologjik:

1. Disa e shohin kishën si të kalonte përmes saj e mbrojtur nga Perëndia (shih Gjoni 17:15)

2. Të tjerë e shohin këtë si të tregonte drejt një vjedhjeje sekrete të besimtarëve përpara kësaj periudhe

Unë preferoj të parën (1.). Populli i Perëndisë nuk u kursye ndaj persekutimit dhe vdekjes gjatë shekujve të parë në një kulturë greko-romake apo gjatë persekutimit dhe vdekjes të vazhdueshme ndërsa ungjilli përhapej, dhe as nuk do të kursehen nga dhimbjet e lindjes së kohëve të fundit në Epokën e Re. Persekutimi gjithmonë e ka pastruar dhe forcuar kishën!

Bashkimi i kapitujve 2-3, në të cilin Kisha përjeton persekutim, ndiqet nga uniteti i vërtetë i qiellit, në të cilin Kisha e martirizuar lutet për hakëmarrje. Ky “zemërimi i Perëndisë” jepet në hapa të vështirësisë (vulat - 1/4, trumpetat - 1/3, enët – shkatërrim i plotë), çdo fazë jepej për qëllimin e të thirrurit të të humburve për shpëtim. Zemërimi përfundimtar i Perëndisë, vdekja e dyte, liqeni i zjarrit (shih Zbulesën 20), nuk janë më për shpëtim, por janë plotësisht dënuese.

Kisha e persekutuar bëhet kisha fitimtare dhe jobesimtarët që persekutojnë përjetojnë persekutim! Perëndia ka gjithçka nën kontroll! Shih Tema të veçanta: Durimi tek Zbu. 2:2.

▣ **“për të provuar ata që banojnë mbi dhe”** Kjo frazë përdoret në mënyrë të përsëritur për t’iu referuar një qëndrimi të vendosur rebelimi nga jobesimtarët (shih Zbu. 6:10; 18:13; 1:10; 12:12; 13:8, 12, 14; 17:8). Perëndia dëshiron që ata të pendohen dhe të besojnë (shih 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9), por ata nuk do ta bëjnë, edhe në mes të gjykimeve që zgjerohen të vulave, trumpetave dhe enëve. Shih Tema të veçanta: Terma grek për sprovë tek Zbu. 2:2.

3:11 “unë vij shpejt” Ky është një theks i vazhdueshëm mbi ardhjen e menjëherëshme të Zotit (shih Zbu. 1:1, 3; 2:16; 22:7,12,20). Kisha e hershme priste një rikthim të menjëhershëm të Zotit. Kjo është shpresa e çdo brezi të krishterësh. Shih Tema të veçanta: Rikthim i Shpejtë tek Zbu. 1:3.

▣ **“mbaje fort atë që ke”** Kjo është një kohë urdhërore aktive e tashme që nënkupton “të vazhdosh të mbahesh fort” si një formë urdhërore aktive aoriste e Zbu. 2:25 e fokusuar në një veprim vendimtar të mbajtjes fort (shih Tema të veçanta tek Zbu. 2:2). Ndërsa besimtarët mbahen fort tek Perëndia, Ai do t’i mbajë fort ata (shih Gal. 6:9). Kjo është marrëdhënia e besëlidhjes së sovranitetit të Perëndisë dhe përgjigjes së urdhëruar të njerëzimit! Shpëtimi është një vendim fillestar i pendesës dhe besimit (shih Mark 1:15; Veprat e Apo. 3:16,19; 20:21) i ndjekur nga një stil jetese pendese dhe besimi, bindjeje, shërbese dhe durimi. Të gjithë këta elementë janë të nevojshëm për krishtërim të pjekur.

▣ **“kurorë”** Kjo është një referencë tjetër ndaj kurorës *stephanos* të përmendur në Zbu. 2:10. Ishte një shpërblim për besnikërinë.

3:12 “kush fiton” Shih shënimi tek 2:2.

▣ **“do ta bëj shtyllë në tempullin e Perëndisë Tim”** Filadelfia ishte një zonë tërmetesh; metafora e shtyllës përcillte konceptin e qëndrueshmërisë. Emrat e qytetarëve të spikatur shkruheshin tek shtyllat e tempujve në Filadelfi. Termi “tempull” këtu është një term (*naos*) nga folja “të banosh” dhe përdorej për vendin ku prania e vetë Perëndisë banonte. Besimtarëve që fitojnë nuk do t’ju duhet kurrë të lënë praninë e Perëndisë (shih Ps. 23:6; 27:4-6).

Kjo mund të jetë një metaforë sepse qartazi nuk do të ketë asnjë tempull në epokën e re (shih 21:22).

▣ **“do të shkruaj mbi të emrin e Perëndisë Tim”** Vër re përsëritjet e pesë-fishta të “Tim” në Zbu. 3:12. Ky është një pranim i mrekullueshëm i intimitetit me Perëndinë. Emri simbolizonte pronësi (shih 7:3; 14:1; 22:4).

▣ **“Jeruzalemi i ri... emri i ri”** Zbulesa prek profecitë e Isaias.

1. Gjërat e reja, Isa. 42:9; 43:19; 48:6 (Zbu. 21:5)
2. Kënga e re, Isa. 42:10 (Zbu. 5:9; 14:3)
3. Emri i ri, Isa. 62:2; 65:15 (Zbu. 2:17)
4. Qielli i ri dhe toka e re, Isa. 65:17; 66:22 (Zbu. 3:12; 21:1).

Qyteti i ri qiellor, Jeruzalemi, gjithashtu profetizohet tek Isaia 40:2,9; 41:27; 44:20,28; 52:1,2,9; 62:1,6,7; 65:18,19; 66:10,13,20 (Zbu. 21:2,10). Ai është një metaforë për praninë e Perëndisë në mes të popullit të Tij.

Profecitë e Dhjatës së Vjetër janë universalizuar. Jeruzalemi i ri nuk është një qytet në Palestinë, por premtimi i një epoke të re drejtësie.

3:13 Shih shënimin tek Zbu. 2:6.

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 3:14-22

¹⁴ “Dhe engjëllit të kishës në Laodice shkruaji: këtë thotë Amen, Dëshmitari besnik dhe i vërtetë, Fillimi i krijesës së Perëndisë. ¹⁵ Unë njoh veprat e tua, që ti nuk je as i ftohtë as i ngrohtë. Do të doja të ishe i ftohtë ose i ngrohtë! ¹⁶ Por, mbasi je kështu i vakët, dhe as i ftohtë e as i ngrohtë, unë do të të vjell nga goja ime. ¹⁷ Sepse ti thua: "Unë jam i pasur, u pasurova dhe s'kam nevojë për asgjë"; edhe nuk e di se ti je qyqar e mjeran, i varfër, i verbër dhe i zhveshur. ¹⁸ Të këshilloj të blesh nga unë ar të kulluar në zjarr që të

bëhesh i pasur; edhe petka të bardhë që të vishesh dhe të mos duket turpi i lakuriqësisë sate; edhe vajos sytë e tu me kolir, që të shohësh. ¹⁹ Unë të gjithë ata që i dua i qortoq dhe i ndëshkoj; prandaj ji i zellshëm dhe pendohu. ²⁰ Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën, unë do të hyj tek ai dhe do të ha darkë me të dhe ai me mua. ²¹ Kujt fiton do t'i jap të ulet me mua mbi fronin tim, sikurse edhe unë fitova dhe u ula me Atin tim mbi fronin e tij. ²² Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që u thotë Fryma kishave”.

3:14 “Ameni” Ky është një aludim ndaj një titulli të YHWH, “Perëndia i Amenit”, tek Isa. 65:16. Termi “Amen” është një formë e fjalës së Dhjatës së Vjetër për “besoj” ose “besim” (shih Zan. 15:16; Hab. 2:4). Ai zakonisht thekson besnikërinë (shih 1:6; 2 Kor. 1:20). Shih Tema të veçanta tek Zbu. 1:6.

▣ **“Dëshmitari besnik dhe i vërtetë”** Kjo mund të jetë një frazë tjetër nga kapitulli 1 (shih Zbu. 1:5). Në Septuagint të dy këta mbiemra përdoren për t’iu referuar YHWH. Është e mundur që *emeth*, i cili është termi hebraik për fjalën “besim” apo “besoj, përktheh si *pistos* (besnik) dhe *alētheia* (e vërtetë). Këta dy terma grek përdoren shpesh tek Zbulesa për Jezusin (shih Zbu. 3:14; 19:11; 21:5; 22:6).

NASB, NKJV	“Fillimi i krijimit të Perëndisë”
NRSV	“origjina e krijimit të Perëndisë”
TEV	“origjina e gjithçkaje që Perëndia ka krijuar”
NJB	“Parimi i krijimit të Perëndisë”

Ky është një aludim ndaj të dyjave Zan. 1:1 dhe Gjoni 1:1. Termat “fillimi” (hebraisht, *bereshith*) dhe “origjin” (greqisht, *archē*) kanë dy kuptime: (1) fillim ose (2) origjin, burim.

Kjo frazë është përdorur në kontroversinë Ariane / Athanasiane (Trinitariane) të shekullit të katërt dhe është një aludim ndaj Prov. 8:22-31. Urtësia ishte krijimi i parë i YHWH dhe përmes krijimit u krijua gjithçka tjetër. Kjo është me shumë mundësi origjina e përdorimit të Gjoni për fjalën “*logos*” në Ungjillin e tij (shih Gjoni 1:1). Ky është një nga pasazhet më të fuqishme mbi para-ekzistencën e Krishtit (shih Gjoni 1:1; 8:57-58; 2 Kor. 8:4; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17), dhe gjithashtu i Krishtit që është agjenti i Atit në krijim (shih Gjoni 1:3; 1 Kor. 8:16; Kol. 1:15,18; Heb. 1:2).

SPECIAL TOPIC: ARCHĒ [TEMA TË VEÇANTA: ARCHĒ]

3:15 “ti nuk je as i ftohtë as i ngrohtë” Kjo mund të jetë një aludim ndaj ujit të vakët që njerëzit e këtij qyteti duhej të pinin për shkak të burimeve të nxehta lokale të ujit. Një referencë e ngjashme bëhet kundër kishës së Sardës (shih 3:1).

3:16 “Unë do të të vjell nga goja ime” Paralajmërimet e Zbu. 2:5; 3:3,16,17 janë shokuese kur kupton se ato i adresohen kishave të dukshme të shekullit të parë. Kjo nuk ka të bëjë me humbjen e shpëtimit, por me humbjen e shërbesës efektive (shih Zbu. 3:19; Heb. 12:5-13).

3:17 “Sepse ti thua: ‘Unë jam i pasur, u pasurova dhe s’kam nevojë për asgjë’” Vargjet 17 dhe 18 janë aludime historike ndaj Laodicesë si një qendër bankare, një qendër për leshin e ngjyrosur dhe një qendër për balsam sysh. Tragjedia e begatisë së tyre ishte se ata mendonin se kishin kaq shume kur në fakt kishin kaq pak (shih 3:1).

SPECIAL TOPIC: WEALTH [Tema të veçanta: Pasuria]

3:18 “të blesh nga Unë” Ky mund të jetë një aludim ndaj Isa. 55:1-3, ku oferta e Perëndisë për shpëtim ishte falas, por e përshkruar si një kosto.

▣ **“petka të bardhë”** Shih shënimin tek Zbu. 3:4.

▣ **“që të mos duket turpi i lakuriqësisë sate”** Në Dhjatën e Vjetër lakuriqësia ishte një shenjë disfate, gjykimi dhe varfërie.

3:19 “Unë i qortoj” Ky term grek *elegchō* përdoret në sensin e “eksponoj dhe në këtë mënyre shëroj ose korrigjoj” (shih Gjoni 3:20; Efes. 5:11-14).

▣ **“dhe i ndëshkoj”** Të ndëshkohesh apo disiplinohesh nga Perëndia është një shenjë që ne jemi anëtarë të familjes së Tij (shih Job 5:17; Pro. 3:12; Ps. 94:12; Heb. 12:6).

▣ **“ji i zellshëm”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Kjo vjen nga e njëjta rrënjë fjale si “i nxehtë” apo “që zjen” (*zestos*) e përdorur në Zbu. 3:15-16. Të njohësh dhe t’i shërbesh Perëndisë duhet të jetë një pasion dhe stil jetese i zjarrtë.

▣ **“dhe pendohu”** Kjo është një formë urdhërore aktive aoriste. Ka një këmbëngulje të përsëritur përgjatë këtyre shtatë letrave që të krishterët, jo thjesht jobesimtarët, duhet të pendohen dhe të rikthehen tek Krishti për pjekuri, stabilitet dhe gëzim (shih Zbu. 2:5, 16, 22; 3:3, 19). Pendesa është një stil jetese, jo thjesht një veprim fillestar!

3:20 “Unë qëndroj te dera dhe trokas” Kjo është një formë treguese aktive e përkryer. “Unë qëndroj dhe vazhdoj të qëndroj tek dera” e ndjekur nga një formë treguese aktive e përkryer “dhe vazhdoj të trokas”. Edhe pse kjo kishë nuk merr asnjë fjalë lavdërimi, ajo prapëseprapë merr një ftesë të ngrohtë. Kjo nuk është një ftesë për të’u bërë i krishterë, por është një ftesë për anëtarët e kishës që të rikthehen tek marrëdhënia jetësore me Krishtin. Ky varg shpesh përdoret jashtë kontekstit për t’iu referuar ungjillizimit. Metafora e “derës” përdoret në Ungjijt (shih Mark 13:28-29; Luka 12:36) si një mënyrë për t’iu referuar afërsisë së ardhjes së Krishtit. Shih Tema të veçanta: Dera tek Zbu. 3:7.

▣ **“nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën”** Kjo është një fjali kushtore e klasës së tretë që nënkupton veprim të mundur por jo të sigurtë. Në shumë pjesë të botës, trokitja shoqërohet me një përhëndetje verbale. Vini re elementin e vullnetshëm; personi / kisha duhet të përgjigjet dhe të hapë derën. Ky është aspekti i besëlidhjes së të gjitha marrëdhënieve të Perëndisë me njerëzit. Ai merr iniciativën, Ai e vendos planin, por njerëzit duhet të përgjigjen. Gjithashtu, vini re se përgjigja nuk është thjesht fillestare por e vazhdueshme. Shpëtimi nuk është një produkt, por është një marrëdhënie stili jetese. Ajo ka ngritjet dhe uljet e veta, por marrëdhënia ekzistenciale është e sigurtë!

▣ **“unë do të hyj tek ai dhe do të ha darkë me të dhe ai me mua”** Ky është një aludim ndaj ofrimit të paqes (shih Levetiku 3 dhe 7), një kohë marrëdhënieje ku Perëndia në mënyrë simbolike hante me personin që jepte ofrimin. Të tjerët e shohin këtë si një referencë ndaj banketit eskatologjik Mesianik. Termi i përdorur këtu për vaktin është ai që përdoret për vaktin në fund të ditës, i cili ishte koha më e madhe e marrëdhënieve dhe shoqërimit familjar. Në Lindje ngrënia ka qënë gjithnjë një shenjë besëlidhjeje, miqësie dhe marrëdhënieje.

3:21 “do t’i jap të të ulet me Mua mbi fronin Tim” Kjo është një pamje e fuqishme e marrëdhënies dhe përfshirjes intime. Ka shumë aludime në Dhjatën e Re ndaj sundimit të besimtarëve me Krishtin (shih Zbu. 2:26, 27; Luka 22:30; Mate. 19:28; 1 Kor. 6:2 dhe në vazhdim; 2 Tim 2:12; Zbu. 20:4). Zbulesa 22:5 nënkupton sundimin e përjetshëm të të krishterëve me Krishtin. Shih Tema të veçanta mbi Sundimin në Mbretërinë e Perëndisë tek Zbu. 5:10.

▣ **“sikurse edhe unë fitova dhe u ula me Atin tim mbi fronin e Tij”** Është e mrekullueshme të dish se Jezusi tanimë ka fituar mbi botën (shih Gjoni 16:33; Efes. 1:21-22) dhe se Ai tanimë është ulur në dorën e djathtë të Atit (shih Efes. 1:20; 1 Gjonit 2:1 dhe Zbu. 22:1) dhe se Ai dëshiron që ne t’i bashkohemi Atij në fitoren e Tij!

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse profecia e Gjonit e fundit të kohërave fillon me një letër ndaj shtatë (dhe vetëm shtatë) kishave në Azinë e Vogël?
2. Pse fillon secila nga letrat me një përshkrim të Krishtit nga kapitulli 1?
3. Si lidhen këto letra me kishën sot?
4. Si i interpretoni këto paralajmërime të fuqishme të drejtuara këtyre kishave?
5. Si lidhet doktrina e “një herë i shpëtuar, gjithmonë i shpëtuar” me paralajmërimet dhe thirrjen për durim në këto letra?
6. Pse nuk është vargu 3:20 një premtim shpëtimi?
7. Si lidhet njësia tjetër letrare me këto letra drejtuar shtatë kishave? A do t’i kursejë Perëndia besimtarët e kohëve të fundit nga persekutimi, por jo besimtarët e shekullit të parë?

ZBULESA 4 – 5

NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Adhurimi Qiellor	Dhoma e Fronit të Qiellor	Vizionet e lavdisë së Perëndisë dhe të Qengjit	Adhurimi në Qiell	Perëndia i beson të Ardhmen e Botës Qengjit
4:1-6a	4:1-11	4:1-6a	4:1-6a	4:1-11
4:6b-11		4:6b-11	4:6-8 4:9-11	
Dorëshkrimi dhe Qengji	Qengji merr dorëshkrimin		Dorëshkrimi dhe Qengji	
5:1-14	5:1-7	5:1-5	5:1-5	5:1-5
	Qëngji është i denjë	5:6-10	5:6-10	5:6-10
	5:8-14	5:11-14	5:11-14	5:11-14

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[A Guide to Good Bible Reading](#)” [Një guidë për një lexim të mirë të Biblës])

DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. Këta dy kapituj formojnë një njësi letrare; kapitulli 4 tregon Perëndinë si Krijuesi (nënkuptimi i *Elohim*, Perëndia si krijues, sigures dhe mbajtës i gjithë jetës, shih Psalm 104) dhe kapitulli 5 tregon Qengjin e Perëndisë (Jezusi) si Shpengues (nënkuptimi i YHWH, Perëndia si Shpëtimtar, Shpengues dhe Perëndia

besëlidhje-bërës, shih Psalmi 103). Konteksti më i madh letrar vazhdon përgjatë hapjes së shtatë vulave. Megjithatë, këto vula në vetvete nisin në kapitullin 6 dhe vazhdojnë përgjatë kapitullit 8:1.

- B. Kapitulli 4 formon një temë qëndrore (lavdia dhe sundimi i sigurtë i YHWH) i librit të Zbulesës. Kjo skenë e fronit qiellor i përngjan tabernakullit qiellor të Hebrejve 8 dhe 9. Ky motiv (lavdia qiellore e Perëndisë) formon qellimin qëndror të misticizmit të hershëm hebraik.
- C. Libri i Zbulesës nuk tregon së pari se si dhe kur do të jetë Ardhja e Dytë; ai flet së pari për sovranitetin e Perëndisë në historinë njerëzore. Këta dy kapituj janë thelbësorë në të kuptuarit e pjesës tjetër të librit dhe qëllimit të tij!
- D. Është e dukshme nga këta dy kapituj se Gjoni po përdorte gjuhën apokaliptike për të përshkruar të vërteta shpirtërore. Gjoni përdorte imazhet nga pasazhe apokaliptike të Dhjatës së Vjetër, veçanërisht Ezekieli, kapitujt 1 dhe 10; gjithashtu 2:9,10; Danieli 4; 7:13-14 dhe gjithashtu referenca të panumërta ndaj shkrimeve hebraike apokaliptike të shkruara midis dy Dhjatave, si I Enoch [Eunuku I]. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë është ekstremisht e papërshtatshme të bësh me doemos Zbulesën një kornizë interpretative të drejtëpërdrejtë dhe plotësisht historike, sidomos kur ne vendosim në të me patjetër ndodhitë e ditëve tona, kulturën tonë, vendndodhjen tonë gjeografike në detajet e një libri apokaliptik antik. Kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë se Zbulesa nuk është e vërtetë. Ajo nuk ka pasur për qëllim që të interpretohej si një rrëfim historik; një model më i përshtatshëm hermeneutik mund të jenë shëmbëlltyrat e Jezusit (shih Fee [Fi] e Stuart [Stjuart], *How To Read The Bible For All Its Worth* [Si Ta Lexosh Biblën Për Gjithçka Që Ajo Vlen], faqe 256)!

STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 4:1-11

¹ Pas këtyre gjërave, pashë dhe ja, një derë u hap në qiell dhe zëri i parë që kisha dëgjuar të fliste me mua si bori, tha: “Ngjitu këtu dhe do të të tregoj gjërat që duhet të ndodhin pas këtyre gjërave.” ² Dhe menjëherë erdha në frymë; dhe ja, një fron ishte në qiell dhe mbi fron rrinte një i ulur. ³ Dhe ai që ishte ulur nga pamja i ngjante një guri diaspri dhe sardi; dhe rreth fronit ishte një ylber që i ngjante smeraldit. ⁴ Dhe rreth e qark fronit ishin njëzet e katër frone, dhe mbi frone pashë ndenjor njëzet e katër pleq të veshur me petka të bardha; dhe mbi kryet e tyre kishin kurora: ⁵ dhe nga fronti shpërthenin vetëtimat, bubullima dhe zëra; dhe përpara fronit ishin shtatë llamba të ndezura, që janë të shtatë Frymërat e Perëndisë. ⁶ Dhe përpara fronit ishte si një det i qelqtë që i ngjante kristalit, dhe në mes të fronit dhe përreth fronit katër kafshë, që ishin plot me sy përpara dhe prapa. ⁷ Qenia e parë e gjallë ishte e ngjashme me një luan, edhe qenia e dytë e gjallë e ngjashme me një viç, edhe qenia e tretë e gjallë kishte fytyrë si të njeriut, edhe e katërta ishte e ngjashme me një shqiponjë në fluturim. ⁸ Edhe të katër qeniet e gjalla kishin secila nga gjashtë krahë për qark, edhe përbrenda ishin plot me sy; dhe nuk pushojnë kurrë, as ditë as natë, duke thënë: “I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti Perëndi, i Plotfuqishmi, që ishte, që është dhe që do të vijë!” ⁹ Sa herë që qeniet e gjalla i japin lavdi, nder e të falenderim atij që rri ulur mbi fron, atij që rron në shekuj të shekujve, ¹⁰ të njëzet e katër pleq bien përmbys përpara atij që rri mbi fron dhe adhurojnë atë që jeton në shekuj të shekujve dhe i hedhin kurorat e tyre përpara fronit, duke thënë: ¹¹ “Ti je i denjë, o Zot, të marrësh lavdinë, nderimin dhe fuqinë, sepse ti i krijove të gjitha gjërat, dhe nëpërmjet vullnetit tënd ekzistojnë dhe u krijuan.”

4:1

NASB, NKJV “pas këtyre gjërave pashë”

NRSV “pas kësaj pashë”

TEV “në këtë moment pata një vizion tjetër dhe pashë”

NJB “më pas, në vizionin tim, pashë”

Kjo formulë gramatikore, me një variacion të vogël, gjithashtu gjendet tek Zbu. 7:1,9; 15:5; 18:1 dhe ndoshta edhe tek Zbu. 19:1. Kjo është një seri vizionesh. Vizionet më të shumta profetike të Dhjatës së Vjetër ishin të kushtëzuar me besëlidhje, duke theksuar pjesën “nëse... atëherë” të besëlidhjes së Perëndisë me Izraelin. Besimi aktual i Izraelit përcaktonte fatin e tij të ardhshëm. Kjo gjithashtu është e vërtetë për vizionet e Gjonit në Zbulesë.

1. Fjalët e Jezusit ndaj shtatë kishave janë kushtëzuese. Përgjigja e tyre ndaj paralajmërimit të tij përcaktonte të ardhmen e tyre.
2. Gjykimet e vulave dhe të trumpetave janë gjithashtu kushtëzuese. Perëndia dëshiron që jobesimtarët të pendohen dhe të kthehen tek Ai.

Sikurse në Dhjatën e Vjetër, plani universal shpengues i Perëndisë (shih Zan. 3:15; 15:12-2; 17:1-8, dhe gjithashtu vëre Vep. e Apost. 2:23; 3:18; 4:28; 13:29) është i pakushtëzuar, i bazuar në premtimet e Tij por gjithashtu i kushtëzuar (shih Zan. 12:1; Zbulesën 2-3) ndaj përgjigjes njerëzore ndaj besëlidhjes. Ky plan universal shpengues zbulohet në skenat qiellore të kapitujve 4 dhe 5.

SPECIAL TOPIC: YHWH'S ETERNAL REDEMPTIVE PLAN [TEMA TË VEÇANTA: PLANI I PËRJETSHËM SHPENGUES I YHWH]

▣ **“një derë qëndron e hapur në qiell”*** Kjo është një pjesore pasive e përkryer, duke nënkuptuar që dera ishte e hapur nga hyjësia (zëri pasiv) dhe qëndronte e hapur (koha e përkryer). Kjo është një mënyrë tjetër për të shprehur zbuluesën e Perëndisë ndaj njerëzimit për Vetën e Tij. Është shumë e ngjashme me Zbu. 19:11; Ezek. 1:1; Mate. 3:16; Gjoni 1:51 dhe Vep. e Apost. 7:55-56. Shih Tema të Veçanta tek Zbu. 3:7.

Fjala “qiell” përdoret më shumë se 50 herë në shkrimet e Gjonit dhe gjithmonë në njëjës përveç një herë në Zbu. 12:12. Kuptimi i saktë i këtij ndryshimi, nga njëjës në shumës, është teologjikisht i pasigurtë. Rabinët diskutonin nëse kishte tre apo shtatë qiej (shih 2 Kor. 12:2). Gjoni fokusohet në një qiell, aty ku Perëndia banon; Ai zgjedh të na e lejojë ta shohim hapësirën e Tij. Edhe pse ka kaos në tokë, nuk do të ketë kaos në qiell.

SPECIAL TOPIC: THE HEAVENS AND THE THIRD HEAVEN [TEMA TË VEÇANTA: QIEJT DHE QIELLI I TRETË]

▣ **“dhe zëri i parë që kisha dëgjuar të fliste me mua, si bori”** Një zë si një trumpetë / bori përmendet në Zbu. 1:10 (shih shënimin). Në fillim kjo nënkupton Jezusin duke folur, por për shkak se kapitujt 4 & 5 janë një njësi letrare dhe Jezusi nuk prezantohet deri në kapitujt 5:5,9-10,12,13, kjo me shumë mundësi i referohet një engjëlli zbulues (shumë karakteristikë e letërsisë apokaliptike). Zëri i një engjëlli dhe tingulli i një borie janë të lidhura në përshkrimin e Palit për Ardhjen e Dytë (shih 1 Thes. 4:16).

▣ **“ngjitu këtu”** Dispensacionalistët kanë pohuar se ky është rrëmbimi i fshehtë i kishës për shkak të të kuptuarit të tyre presupozacional për librin e Zbulesës (të gjitha profecitë e Dhjatës së Vjetër duhet të përmbushen fjalë-për-fjalë; kisha dhe Izraeli janë tërësisht të ndara; kisha do të vidhet në mënyrë sekrete në qiell në mënyrë që profecitë e Dhjatës së Vjetër të mund të përmbushen në një Izrael tokësor). Shpesh ky interpretim mbështetet nga një argument nga heshtja, duke qënë se fjala “kishë” nuk shfaqet në Zbulesë pas kapitullit 3 (përveçse në Zbu. 22:10). Megjithatë, nuk ka asgjë në këtë tekst që të nënkuptojë se dikush veç Gjonit është thirrur në qiell. Për shkak të “vetëtimave” dhe “bubullimave” në Zbu. 4:5, ky mund të jetë një aludim ndaj Moisiut që u thirr lart (shih Eksod. 19:20,24) në malin Sinai për të marrë zbuluesën e Perëndisë (shih Eksod. 19-20, veçanërisht 19:16,19).

* Versioni në shqip është “një derë u hap në qiell”. (Shënim i përkthyesit)

Gjithashtu, vini re përmendjen e zërit të Perëndisë si një bori e zhurmshme në Eksod. 19:19 (shih Tema të Veçanta: Bori të përdorura në Izrael në Zbu. 1:10).

▣ **“gjërat që duhet të ndodhin pas këtyre gjërave”** Kjo frazë mund të jetë një aludim ndaj Dan. 2:29,45. Nëse është kështu, ajo i referohet ndodhive historike në seri, por jo ndodhive të ardhshme. Zbulesa nuk është gjëra në shekullin e parë dhe gjëra në një shekull të largët në të ardhmen, por janë ndodhitë që:

1. Përsëriten në çdo epokë (shih Mate. 24:4-14)
2. Reflekton të gjithë periudhën midis ardhjes së parë të Krishtit dhe ardhjes së tij të dytë (shtatë njësitë letrare në libër)

Kjo frazë është e ngjashme me 1:1. Fjala dhe vullneti i Perëndisë duhet (*dei*) të realizohen. Këtu elementi kohë (dmth, së shpejti) është lënë jashtë, por qëndron me siguri. Perëndia do të përmbushë planin e Tij shpengues!

4:2 “dhe menjëherë erdha në frymë” Gjoni përshkruhet si të ishte në Frymë në Zbu. 1:10; 17:3 dhe 21:10. Kjo mund të jetë e ngjashme me atë që ndodhi tek Ezekieli tek Ezek. 8:1-4; 11:1, me Jezusin tek Mate. 4:8; me Filipin tek Vep. e Apost. 8:39-40, dhe me Palin tek 2 Kor. 12:1-2.

▣ **“një fron ishte në qiell dhe mbi fron rrinte Një i ulur”** Termi “fron” (*thronos*) përdoret mbi 47 herë në këtë libër. Sundimi i Perëndisë është motivi qëndror i këtij vizioni qiellor (kapitujt 4 & 5). Froni është një mënyrë simbolike dhe apokaliptike për të treguar se YHWH ka nën kontroll të gjithë historinë. Perëndia është një frymë shpirtërore, e përjetshme dhe personale; Ai nuk ulet mbi një fron (shih Tema të Veçanta tek Zbu. 2:1)! Një qëllim i zhanërve të profecisë dhe të shkrimeve apokaliptike është njohuria dhe kontrolli i Perëndisë ndaj ndodhive të ardhshme. E gjithë historia njihet dhe është e qëllimshme (*telos*, shih Mate. 24:14; 1 Kor. 15:24-28). Froni përshkruhet si “po qëndronte.” Kjo kohë e papërkryer mund të ketë dy kuptime: (1) ka qëndruar gjithnjë ose (2) sapo është vendosur. Ky mund të jetë një aludim ndaj Dan. 7:9, “fronët ishin vendosur”.

4:3 “Ai që ishte ulur nga pamja i ngjante” Gjoni nuk do të përshkruajë pamjen e Perëndisë për shkak se në mënyrën e të menduarit hebraik, kjo ishte ekstremisht e papërshtatshme (shih Eksod. 33:17-23; Isa. 6:5). Por ai do të përshkruajë lavdinë e Perëndisë në ngjyrat e tre gurëve të çmuar. Gurët e çmuar gjithashtu përdoren tek Ezek. 28:13 për të përshkruar imazhet qiellore (të Kopështit të Perëndisë).

NASB, NKJV, NRSV, TEV
NJB

“diaspër”
“diamante”

Ngjyra dhe emri i saktë i gurëve të çmuar është shumë i pasigurtë në literaturën antike. Emrat dhe ngjyrat e gurëve të çmuar ndryshojnë nga një shtet në një tjetër dhe nga një periudhë në një tjetër. Diaspri ishte guri i parë i gjendur në parzmoren e Kryepriftit, i cili përmendet tek Eksod. 28:17-21. Ky gur duket se është një gur i pastër. Do të jetë i lidhur me “detin e qelqit” (shih Zbu. 4:6; 15:2; 21:11,18,21). Ai mund t’i jetë referuar diamantit tonë.

NASB, NKJV “sardi”
NRSV, TEV “karnelian”
NJB “rubini”

Sardi ishte një gur i kuq si gjaku. Ishte guri i fundit në parzmoren e Kryepriftit. Mund të jetë një aludim ndaj Perëndisë që është i Pari dhe i Fundit me theksin tek fisi mesianik i Judës (ylberi i smeraldit). Këta dy gurë listohen në shkrimet antike si një përmbledhje e të gjithë gurëve të çmuar.

▣ **“dhe rreth fronit ishte një ylber që i ngjante smeraldit”** Smeraldi ishte guri i Judës në parzmoren e Kryepriiftit. Theksi i ylberit ka qënë mjaft i diskutuar por ka dy teori kryesore.

1. Disa e shohin atë si një aludim ndaj Zan. 9:16, ku ylberi është një simbol i mbrojtjes së Perëndisë, bërë me besëlidhje dhe një shenjë që stuhia ka mbaruar; në mes të gjykimit kishte premtim dhe mëshirë.
2. Të tjerë e lidhin atë me Ezek. 1:28, një simbol i lavdisë së YHWH.

Nëse ylberi është një shenjë gjykimi apo besëlidhje është e pasigurtë, por ai qartazi ishte një ylber i pazakontë sepse ishte në ngjyrë të gjelbër dhe jo thjesht një përthyerje e dritës normale.

4:4 “Dhe rreth e qark fronit ishin njëzet e katër frone” Arsyeja për njëzet e katër fronet është diskutuar mjaft.

1. Disa e shohin atë si të lidhur me rregullin priiftëror aaronik të vendosur nga Davidi tek 1 Kro. 24:7-19
2. Të tjerë e shohin atë si një aludim ndaj këshillit qiellor i cili përmendet tek 1 Mbret. 22:19; Isa. 24:23; Dan. 7:9-10,26
3. Ende të tjerë e shohin atë si një kombinim të dymbëdhjetë fiseve të Izraelit dhe të dymbëdhjetë apostujve, të cilët simbolizojnë popullin e e plotë të Perëndisë (shih Zbu. 21:12,14)

Është befasuese që ky numër nuk shfaqet në literaturën hebraike apokaliptike të shkruar midis dy Dhjatave.

▣ **“ndenjur njëzet e katër pleq”** Gjithashtu ka pasur shumë debat mbi identitetin e këtyre pleqve. Ka dy teori kryesore:

1. Ata përfaqësojnë besimtarët:
 - a. Të përfytyruar si të veshur me petka të bardha (shih 1 Kor. 9:25; 1 Thes. 2:19; 2 Tim. 4:8; Jakob 1:12; 1 Pjet. 5:4)
 - b. Engjëjve kurrë nuk iu thuhet të vendosin kurora dhe të ulen në frone (shih Zbu. 4:4,10)
 - c. Ata janë në listat të cilat veçanërisht përfshijnë engjëjt (shih Zbu. 5:11)
 - d. Zbu. 5:9-10 në Vulgate, Peshitta [Peshita] dhe më pas në Textus Receptus përfshijnë pleqtë në këngët e shpengimit
2. Ata përfaqësojnë engjëjt:
 - a. Engjëjt veshin petka të bardha (shih Mate. 28:3; Gjoni 20:12; Mark 16:5; Vep. e Apost. 1:10; Zbu. 15:6 dhe Dan. 10:5,6)
 - b. Këta pleq gjithnjë identifikohen me krijesa të gjalla si në Zbu. 5:11,14, të cilët duket se listojnë tre lloje të ndryshme rendesh të engjëjve
 - c. Një nga pleqtë vepron si një engjëll zbulues (shih Zbu. 5:5)
 - d. Tek Isa. 24:23 engjëjt e Perëndisë të këshillit qiellor quhen “pleq”
 - e. Prova tekstuale e Zbu. 5:10 nënkupton që plaku nuk përfshin vetveten në këngën e njerëzimit të shpenguar

SPECIAL TOPIC: ELDER [TEMA TË VEÇANTA: PLAK]

▣ **“kurora të arta”** Askund në Bibël nuk thuhet se engjëjt mbajnë kurora (as për engjëllin e fuqishëm tek Danieli 10). Moria e demonëve nga gremina përshkruhen se mbajnë diçka të ngjashme me kurora të arta në Zbu. 9:7.

4:5 “dhe nga fronti shpërthenin vetëtima, bubullima dhe zëra” Kjo është e ngjashme me Eksod. 19:16-19, i cili përshkruan fenomene fizike që rrethojnë praninë e Perëndisë në malin Sinai. Këto fraza tregojnë praninë e Perëndisë (shih Zbu. 11:19) ose gjykimet e Tij (shih Zbu. 8:5; 16:18).

▣ **“shtatë llamba të ndezura”** Këto duket se janë shtatë llamba të ndara (pishtarë), jo një enë me shtatë fitilë (shih Eksod. 25:37; Zak. 4:2). Ato funksionojnë në një mënyrë të ngjashme me të gjithë numrat “shtatë” të tjerët, duke iu referuar vetë pranisë së Perëndisë.

▣ **“që janë të shtatë Frymërat e Perëndisë”** Kjo frazë e ngjashme përdoret në Zbu. 1:4; 3:1 dhe 5:6. Ajo shpesh interpretohet si një referencë ndaj Frymës së Shenjtë bazuar në 1:4, por asnjë nga referencat e tjera nuk e konfirmon këtë interpretim. Kjo frazë duket se barazohet me kishat (shtatë yjet, Zbu. 3:1; shtatë llambat, Zbu. 4:5) ose me gjithëpushtetshmërinë dhe gjithëditurinë e Qengjit (Zbu. 5:6). Shih Tema të Veçanta: Shtatë Frymërat tek Zbu. 1:4.

4:6 “një det i qelqtë që i ngjante kristalit” Ka pasur teori të panumërta për këtë frazë:

1. I referohet enës në Tempull (shih 1 Mbre. 7:23; 2 Kro. 4:2-6)
2. Lidhet me konceptin e detit të kristaltë të gjendur tek Eksod. 24:9-10
3. Është pjesë e karrocës së lëvizshme të fronit të Perëndisë tek Ezek. 1:22,26; 10:1
4. Është një simbol i ndarjes nga shenjtëria e Perëndisë (shih Zbu. 15:2)

Ky det zhvendoset në Zbu. 21:1, duke treguar mallkimin (shih Zanafilla 3) e mëkatit dhe të ndarjes së njerëzimit të cilat janë hequr. Shih shënimin tek Zbu. 21:1.

▣ **“katër kafshë të gjalla”[†]** Këto krijesa të gjalla përshkruhen në Zbu. 4:6-8. Ato janë një kombinim i *kerubinit* të Ezek. 1:5-10 dhe 10:1-17 dhe të *serafinit* të Isa. 6:2,3. Numrat e krahëve dhe të fytyrave ndryshojnë, por ajo është një pamje e përbërë e këtyre njerëzve/kafshëve/engjëjve të cilët rrethojnë fronin e Perëndisë (shih Zbu. 4:6,8,9; 5:6,8,11,14; 6:1,3,5,7; 7:11; 14:3; 15:7; 19:4).

SPECIAL TOPIC: CHERUBIM [TEMA TË VEÇANTA: KERUBIN]

▣ **“plot me sy përpara dhe prapa”** Kjo mund t’i referohet syve të secilës prej katër fytyrave ose mund të jetë një metaforë biblike e prezencës së kudogjendur të Perëndisë (shih Zbu. 4:8; Ezek. 1:18; 10:12).

4:7 “luan... viç... njeri... shqiponjë” Ky është një aludim i dukshëm ndaj Ezek. 1:6,10. Në literaturën rabinike, këta listohen si më të fortët e rendeve të ndryshme të krijimit të Perëndisë. Ireneus [Ireneasi] (pas Krishtit 120-202) përdori katër fytyra të ndryshme për të përshkruar katër shkruesit e Ungjijve (tradita kishtarë më në fund u vendos mbi Gjonin, shqiponjë; Luka, njeri; Marku, ka/viç; Mateu, luan) por kjo gjithashtu është tejet spekulative dhe alegorike. Këto krijesa të përbëra janë simbolike dhe jo të drejtë-për-drejta. Duke e ditur theksin e Dhjatës së Vjetër mbi ruajtjen e rendit të Perëndisë për krijimin, një krijesë e përbërë prej njeriu dhe kafshe do të ishte levitikisht e papastër. Ky nuk është një rrëfim historik i gjërave dhe ndodhive aktuale, por një zhanër tejet simbolik i cili kërkoj të përshkruajë të vërteta përfundimtare dhe shpirtërore; në këtë rast Perëndia si Një që jeton përjetë (vargjet 8,9), Një i Shenjtë (v. 8) dhe krijues i të gjitha gjërave (v.11).

4:8 “i shenjtë, i shenjtë, i shenjtë” Këto krijesa të gjalla përsërisin këngën e *serafinit* tek Isa. 6:2,3. Ky është i pari nga shumë hymne të gjendura në librin e Zbulesës (shih 4:8,11; 5:9-10,12,13; 7:12; 11:17-18; 12:10-12; 15:3-4; 16:5-7; 18:2-8; 19:1-3, 6-7). Shpesh hymnet janë një mënyrë për të interpretuar vizionet. Një simbol tjetër, si deti i qelqtë, funksionon si një superlativë hebraike e shenjtërisë së plotë të Perëndisë.

▣ **“Zoti Perëndi, i Plotfuqishmi”** Këto ishin tre titujt e Dhjatës së Vjetër për Perëndinë (shih Zbu. 1:8):

[†] Version në shqip thotë “katër kafshë”. (Shënimi i përkthyesit)

1. Zoti = YHWH (shih Eksod. 3:14; Psalm 103)
2. Perëndia = *Elohim* (shih Psalm 104)
3. I Plotëfuqishmi = *El Shaddai*, emri patriarkal për Perëndinë (shih Eksod. 6:3)

Shih [SPECIAL TOPIC: NAMES FOR DEITY](#) [TEMA TË VEÇANTA: EMRA PËR HYJËSINË] tek Zbu. 1:8.

▣ **“që ishte, që është dhe që do të vijë”** Kjo frazë është një titull i përsëritur (shih Zbu. 1:4; 4:8; shih shënimin e plotë tek Zbu. 1:4). Kjo është një lojë me emrin e Perëndisë të bazuar në besëlidhjen, YHWH, i cili vjen nga folja “të jesh”. E njëjta tematikë përsëritet tek Zbu. 4:9 dhe 10 në frazën “ndaj Atij që jeton gjithmonë e përgjithmonë” (shih Zbu. 10:6; 15:7).

4:9-11 Kjo është një fjali në greqisht, e cila tregon se adhurimi i plotë i takon Atij i cili ulet në fron dhe jeton përgjithmonë (shih Psalm 47; Dan. 4:34; 12:7). Ky mund të jetë një aludim ndaj pjesëmarrësve engjëllorë të quajtur këshilli qiellor (shih 1 Mbret. 22:19; Jobi 1:6; Dan. 7:10) ose ndaj shprehjes në hebraisht “engjëj të pranisë” (sipas Tobit 12:15).

4:9 “qëniet e gjalla” Këto qenie engjëjllore përmenden shpesh në libër (shih Zbu. 5:6,8,14; 6:1; 7:11; 14:3; 15:7; 19:4).

4:10 “i hedhin kurorat e tyre përpara fronit” Ky është një simbol i pranimit të tyre se Perëndia meriton të gjithë adhurimin dhe nderimin! Cilado qoftë arsyeja që ata kanë kurora, ata e pranojnë se fuqia vinte nga Perëndia!

4:11 “Ti i krijove të gjitha gjërat” Pleqtë dhe krijesat e gjalla lavdërojnë Perëndinë si Krijues, Mbajtës dhe Sigurues i të gjitha gjërave. Ky është një theks teologjik i emrit *Elohim* (shih Zanafilla 1; Jobi 38-41; Psalm 104). Ky kapitull përdor kuptimin teologjik të dy emrave më të përdorur për Perëndinë për të përshkruar veprimet e Tij. Zbulesa progresive e Dhjatës së Re e bën të qartë se Jezusi ishte agjenti i Atit i krijimit (shih Gjoni 1:3; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16 dhe Heb. 1:2).

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 5:1-5

¹ Pastaj pashë në dorën e djathtë të atij që rrinte ulur mbi fron, një libër të shkruar përbrenda dhe përjashta, të vulosur me shtatë vula. ² Dhe pashë një engjëll të fuqishëm, që proklamoi me zë të madh: “Kush është i denjë të hapë librin dhe të zgjidhë vulat e tij?” ³ Po kurrkush, as në qiell, as mbi dhe, as nën dhe, nuk mund të hapte librin e ta shihte atë. ⁴ Edhe unë qaja shumë, sepse s’qe gjetur asnjë i denjë të hapë dhe të lexojë librin, dhe as ta shohë. ⁵ Atëherë një nga pleqtë më tha: “Mos qaj; ja, Luani i fisit të Judës, Rrënja e Davidit, fitoi të hapë librin dhe të zgjidhë të shtatë vulat e tij.”

5:1 “pastaj pashë në dorën e djathtë të Atij që rrinte ulur mbi fron” Një përkthim më i mirë i kësaj fraze do të ishte “mbi dorën e djathtë të Tij” (Peshitta e përkthyer në anglisht nga Lamsa dhe në Biblën e Shtjelluar). Nuk është ideja e Perëndisë që mbahet fort tek libri, por Perëndia e mban atë që të mos e marrë dikush dhe ta hapë. Fraza “dora e djathtë e Tij” është një antropomorfizëm për të përshkruar fuqinë dhe autoritetin e Perëndisë (shih Tema të veçanta tek Zbu. 2:1). Perëndia nuk ka një trup fizik; Ai është një qenie frymore (shih Gjoni 4:24), i pakrijuar dhe i përjetshëm.

▣ **“libër”** Termi grek është “*biblion*” i cili më vonë u përdor për t’iu referuar një kodiku (libri). Pjesa më e madhe e kometatorëve bien dakord që librat nuk u shfaqën deri në shekullin e dytë, kështu që ajo që kemi këtu është një

papirus ose dorëshkrim pergamene (NKJV, NRSV, TEV dhe NJB). Ka disa teori për sa i përket kuptimit të këtij libri.

1. Libri i mallkimeve të gjendur në Ezek. 2:8-10; dhe Zbu. 10:8-11
2. Libri, të cilin njerëzit nuk kanë dëshirë ta lexojnë sepse Perëndia i ka verbëruar ata frymërisht (shih Isa. 29:11; Rom. 11:8-10,25)
3. Ndodhitë e fundit të kohërave (shih Dan. 8:26)
4. Një amanet apo testament i fundit romak, i cili tradicionalisht vulosej me shtatë vula
5. Libri i jetës (shih Dan. 7:10; 12:1), i cili përmendet kaq shpesh në librin e Zbulesës (shih 3:5; 17:8; 20:12,15)
6. Dhjata e Vjetër (shih Kol. 2:14; Efes. 2:15)
7. Tabletat qiellore të I Enoch [Eunuku I] 81:1,2.

Sipas mendimit tim, aspektet numër 1, 2 ose 3 duken se janë më të përshtatshmet; dorëshkrimi është një libër mbi fatin e njerëzimit dhe mbi kulmin e Perëndisë mbi historinë.

▣ **“të shkruar përbrenda dhe përjashta”** Kjo ishte shumë e pazakontë në botën antike për shkak të vështirësisë së shkrimit në pjesën e pasme të papirusit, edhe pse përmendet tek Ezek. 2:8-10 dhe Zakarias 5:3. Ajo simbolizon kontrollin e plotë dhe të kompletuar të Perëndisë mbi historinë dhe mbi fatin njerëzor.

Të dy pjesoret (e shkruar dhe vulosur) që përshkruajnë këtë dorëshkrim janë në formë pasive të përkryer. Forma e parë është një formë gramatikore e veçantë e përdorur për të përshkruar Biblën si e frymëzuar (për shembull, Gjoni 6:45; 8:17; 10:34 etj). Forma e dytë është një mënyrë e të shprehurit se dorëshkrimi ishte i mbrojtur, i ruajtur dhe i rezervuar nga Perëndia.

▣ **“të vulosur me shtatë vula”** Shtatë vulat kanë dy origjina të mundshme.

1. Shtata ishte numri i përsosmërisë nga Zanafilla 1, prandaj, ishte e vulosur në mënyrë të përsosur.
2. Testamentet romake vuloseshin me shtatë vula.

Vulat ishin pika të vogla dylli të cilat përmbanin shenjën e pronarit, të vendosura aty ku libri apo dorëshkrimi do të hapeshin (shih Tema të veçanta tek Zbu. 7:2). Tek Zbu. 6:1-8:1, thyerja e këtyre vulave sillte mallkime mbi tokë, por përmbajtja e dorëshkrimeve nuk zbulohet në këtë njësi letrare. Në fakt, në strukturën e librit, vula e shtatë fillon shtatë trumpetat e cila është vula e shtatë.

5:2 “pashë një engjëll të fuqishëm” Disa studiues shohin një lidhje etimologjike ndaj emrit Gabriel, i cili do të thotë “njeriu i fortë i Perëndisë”. Një engjëll tjetër i fuqishëm përmendet tek Zbu. 10:1 dhe 18:21. Ndërmjetësimi engjëllor është i zakonshëm tek literatura apokaliptike hebraike e shkruar midis dy dhjatave.

▣ **“që proklamoi me zë të madh”** Ai po i drejtohej të gjithë krijimit.

▣ **“Kush është i denjë të hapë librin dhe të zgjidhë vulat e tij?”** Termi “i denjë” është një term tregtar i lidhur me përdorimin e peshores. Ai nënkuptonte “ai i cili i korrespondon”. Vendoset diçka në njërën anë të peshores dhe ajo që vendoset në anën tjetër është e barabartë me të. Mund të përdoret me një kuptim pozitiv ose negativ. Këtu, është vlera e paçmuesme e Shtetit të pamëkatë. Vetëm Jezusi ishte i barabartë me veprën e shpengimit. Vetëm Jezusi ishte i barabartë me detyrën e flijimit. Vetëm Jezusi është i denjë (shih Zbu. 5:7, 9-10,12).

5:3 “Po kurrkush, as në qiell, as mbi dhe, as nën dhe, nuk mund të hape librin e ta shihet atë.” Kjo tregon pamundësinë e plotë të engjëjve apo njerëzve për të bërë vullnetin e Perëndisë! Rebelimi i ka prekur të gjithë ata! Krijimi nuk mund të ndihmojë vetveten! Asnjë nuk është i denjë!

5:4 “Unë nisa të qaja shumë”[‡] Kjo është një formë e foljes në kohën e pakryer, e cila paraqet fillimin e një veprimi apo një veprim të përsëritur në të shkuarën. Kjo do të thotë “të vajtosh me zë të lartë”, që ishte aq karakteristike e Lindjes së Afërme në Antikitë.

5:5 “një nga pleqtë më tha” Këtu gjejmë një nga pleqtë teksa vepron në rolin e një interpretuesi engjëllor, si në librin e Danielit. Shih [SPECIAL TOPIC: ELDER](#) [Tema të Veçanta: Plak] tek Zbu. 4:4.

▣ **“Mos qaj”** Kjo është një formë e tashme urdhërore me një pjesore negative e cila zakonisht nënkuptonte të ndaloje një veprim i cili ishte tanimë në proces e sipër.

▣ **“Luani i fisit të Judës”** Ky është një aludim ndaj Zan. 49:9-10 (shih II Esdras [Ezra II] 12:31,32). Mesia është Luani sundues (mbret) nga fisi i Judës.

▣ **“Rrënja e Davidit”** Ky është një aludim ndaj 2 Samuelit 7 dhe në veçanti Isa. 11:1-10. E njëjta ide e një Mesie mbretërore Davidike mund të gjendet tek Jer. 23:5; 33:5 dhe tek Zbu. 22:16.

▣ **“fitoi”** Kjo është një formë aoriste aktive treguese, e cila nënkupton se ishte një fakt i përmbushur (dmth, Kalvari dhe varri bosh). Vini re se Luani nuk do të sundojë me anë të fuqisë së Tij, por me anë të sakrificës së Tij (shih Zbu. 5:6).

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 5:6-10

⁶ Dhe pashë, në mes të fronit dhe të katër qenieve të gjalla dhe në mes të pleqve, një Qengj si i therur, i cili kishte shtatë brirë dhe shtatë sy, që janë të shtatë Frymërat e Perëndisë, të dërguar në gjithë dheun. ⁷ Ai erdhi dhe mori librin nga dora e djathtë e atij që rrinte mbi fron. ⁸ Dhe, mbasi e mori librin, të katër qeniet e gjalla dhe të njëzet e katër pleqtë ranë përmbys përpara Qengjit, duke pasur secili një qeste dhe disa kupa ari plot me erë të këndshme, të cilat janë lutjet e shenjtorëve. ⁹ Dhe këndonin një këngë të re duke thënë: “Ti je i denjë ta marrësh librin dhe të hapësh vulat e tij, sepse ti u there, dhe me gjakun tënd na bleve te Perëndia nga çdo fis, gjuhë, popull dhe komb, ¹⁰ dhe na bëre mbretër dhe priftër për Perëndinë tonë, dhe do të mbretërojmë mbi dhe.”

5:6 “një Qengj që qëndronte” Ky koncept i një Qengji sakrifikues (dmth, një qengji të vogël, *arnion*) përshkruan pajtimin e deleguar dhe ringjalljen e Jezus Krishtit. Qengji përmendet përmes librit të Zbulesës (shih Zbu. 5:6,8,12,13; 6:1,16; 7:9,10,14,17; 12:11; 13:8; 14:1,4 (dy herë),10; 15:3; 17:14; 19:7,9; 21:9,14,22,23,27; 22:1,3). Metafora sakrifikuese është nga

1. Qengji i Pashkës (Eksodi 12)
2. Një nga qengjat që sakrifikohej çdo ditë në mëngjes dhe në mbremje (vazhduesi, shih Eksodi. 29:38-46; Num. 28:3,6,10,23,31; 29:11,16,19,22,25,28,31,34,38)
3. Qengjin e therur të Isaia 53:7 ose Gjoni 1:7,29

Kjo metaforë përdoret për Jezusin në dy kuptime të veçanta: (a) si një viktimë e pafajshme sakrifikuese dhe (b) si një fitues fitimtar (gjithashtu gjendet në literaturën apokaliptike hebraike, shih I Eunuku 90:9; Dhjata e Jozefit 19:8-9). Në Dhjatën e Re vetëm Gjon Pagëzori në Gjonin 1:29,36 dhe Gjoni tek Zbulesa 5:6,8,12,13; 61:1, i referohen Jezusit si “Qengji” (Pali e pranon këtë, por pa përdorur termin tek 1 Kor. 5:7).

[‡] Versioni në shqip është: “Edhe unë qaja shumë.” (Shënim i përkthyesit).

▣ **“si i therur”** Ai ishte i gjallë por tani jeton. Ringjallja e Mesias kthehet në parodi nga bisha e detit (shih Zbu. 13:3).

▣ **“i cili kishte shtatë brirë dhe shtatë sy”** Termi i parë i referohet fuqisë ose gjithëfuqisë (shih Eksod. 27:2; 29:12; Ligji i Përtë. 33:17; 2 Kron. 18:10; Psa. 112:9; 132:17; Jer. 48:25; Ezek. 29:21; Zak. 1:18-21). Termi i dytë i referohet gjithëdijësisë së Perëndisë (shih Zbu. 4:6,8; Ezek. 1:18; 10:12; Zak. 3:9 dhe 4:10). Ky simbolizëm është i ngjashëm me atë të Dan. 7:13-14.

▣ **“që janë të shtatë Frymërat e Perëndisë”** Shih Tema të Veçanta tek Zbu. 1:4 dhe shënimin tek Zbu. 4:5.

5:8 “Dhe, mbasi e mori librin, të katër qeniet e gjalla dhe të njëzet e katër pleqtë ranë përmbys përpara Qengjit” Kjo tregon adhurimin e Qengjit dhe gjithashtu adhurimin e Perëndisë (shih Zbu. 5:13), e cila është tema qendrore e Zbulesës.

▣ **“dhe disa kupa ari plot me erë të këndshme, të cilat janë lutjet e shenjtorëve”** Engjëjt ishin mbajtës të rregullt të lutjeve ndaj Perëndisë në literaturën hebraike ndërbiblike (shih Tobit 12:15; III Baruku 11). Ideja e aromës që përfaqëson lutjet përdoret disa herë në Shkrime (shih Zbu. 8:3-4; Psa. 141:2; Luka 1:10).

▣ **“shenjtorëve”** Edhe pse fjala “kishë” nuk shfaqet pas kapitullit 3, koncepti i “shenjtorëve” vazhdon përgjatë librit dhe duhet t’i referohet popullit të Perëndisë. Koncepti i besimtarëve si “shenjtorë” është e zakonshme tek Zbulesa (shih Zbu. 8:3-4; 11:18; 13:7,10; 14:12; 16:6; 17:6; 18:20,24; 19:8 dhe 20:9).

SPECIAL TOPIC: SAINTS [TEMA TË VEÇANTA: SHENJTORËT]

5:9-10 Gjendet një variant dorëshkrimi i rëndësishëm grek i cili lidhet me përemrin “ne[§]”. Versioni i Ri i Mbretit Xhejms (NKJV) e ka përemrin “ne” në Zbu. 5:9, “na shpengove ne te Perëndia”, dhe në Zbu. 5:10 “dhe na bëre ne mbretër dhe priftër për Perëndinë tonë^{**}”. Pjesa më e madhe e përkthimeve moderne (NASB, NRSV, TEV, NJB) e heqin pjesën “ne” në të dy këto vargje. Nëse “ne” do të ishte i pranishëm në të dy këto vargje, atëherë vdekja sakrifikuere e Jezusit përfshin njëzetë e katër pleqtë të cilët duket se janë krijesa engjëllore. Askund në Bibël nuk lidhet vdekja e Jezusit me shpengimin engjëllor. Gjithashtu, prania e “ata^{††}” (*autous*) në Zbu. 5:10 e përjashton gramatikisht mundësinë që “ne” të jetë origjinale. Botimi i katërt i Shoqërisë së Bashkuar të Biblës e vlerëson heqjen e dy përemrave në shumës si “të sigurt”.

5:9 “Dhe këndonin një këngë të re” Në Dhjatën e Vjetër ka shumë aludime për këngën e re (shih Psa. 33:3; 40:3; 98:1; 144:9; 149:1 dhe Isa. 42:10). Në çdo ndodhi madhore në Dhjatën e Vjetër, populli i Perëndisë inkurajohej për të kënduar një këngë të re që lavdëronte veprimtarinë e Perëndisë. Kjo është përfundimisht kënga për Perëndinë i cili zbulon Vetveten tek Mesia dhe në veprën shpenguese të Mesias në emër të të gjithë besimtarëve (shih Zbu. 5:9,12,13; 14:3).

Theksi mbi gjëra “të reja” është karakteristikë e epokës së re në Isaian 42-66.

1. “gjëra të reja”, Isa. 42:9
2. “këngë e re”, Isa. 42:10

[§] Versioni në shqip është “na” (duke nënkuptuar “neve na”). (Shënim i përkthyesit)

^{**} Po kështu është edhe versioni në shqip. (Shënim i përkthyesit)

^{††} Versioni në anglisht, ndryshe nga ai në shqip “dhe na bëre mbretër”, është “ti i ke bërë *ata* mbretër” (Shënim i përkthyesit).

3. “bëj diçka të re”, Isa. 43:19
 4. “gjëra të reja”, Isa. 48:6
 5. “emër i ri”, Isa. 62:6
 6. “qiej të rinj dhe tokë e re”, Isa. 65:17; 66:22.
- Tek Zbulesa ka gjithashtu shumë gjëra “të reja”.

1. “Jeruzalemi i ri”, Zbu. 3:12; 21:2
2. “emri i ri”, Zbu. 2:17; 3:12
3. “kënga e re”, Zbu. 5:9,10,12,13; 14:3
4. “qielli i ri dhe toka e re”, Zbu. 21:1

▣ **“Ti je i denjë ta marrësh librin dhe të hapësh vulat e tij”** Kjo këngë e re (Zbu. 5:9-10) është një përshkrim i pesëfishtë i denjësisë së Qengjit.

1. vdekja zëvendësuese (shih Zbu. 5:6,9,12; 13:8; 1 Pjet. 1:18-19)
2. çmimi shpengues i paguar (shih Zbu. 5:9; 14:3-4; Mark 10:45; 1 Kor. 6:19-20; 7:23; 1 Tim. 2:6)
3. njerëz të blerë nga çdo komb (shih Zbu. 5:9; 7:9; 14:6)
4. i bëri besimtarët një mbretëri priftërinjsh (shih Zbu. 1:6; 5:10)
5. ata do të sundojnë me Të (shih Zbu. 3:21; 5:10; 20:4)

▣ **“nga çdo fis, gjuhë, popull dhe komb”** Kjo është një metaforë e përsëritur e universalitetit (shih Zbu. 7:9; 11:9; 13:7; 14:6). Ky mund të jetë një aludim ndaj Dan. 3:4,7.

▣ **“me gjakun tënd bleve te Perëndia”** Kjo është me siguri një referencë ndaj pajtimit të deleguar të Qengjit të Perëndisë. Ky koncept i Jezusit si sakrificë për mëkatin është në qendër të Zbulesës (shih Zbu. 1:5; 5:9,12; 7:14; 12:11; 13:8; 14:4; 15:3; 19:7; 21:9,23; 22:3) dhe gjithashtu në të gjithë Dhjatën e Re (shih Mate. 20:28; 26:28; Mark 10:45; Rom. 3:24-25; 1 Kor. 6:20; 7:23; 2 Kor. 5:21; Gal. 3:13; 4:5; Efes. 1:7; Fili. 2:8; 1 Tim. 2:6; Titit 2:14; Heb. 9:28; dhe 1 Pjet. 1:18-10).

SPECIAL TOPIC: RANSOM/REDEEM [TEMA TË VEÇANTA: SHPENGUES/SHPENGOJ]

5:10 “i bëre ata një mbretëri dhe priftërinj” Ky është një aludim ndaj Eksod. 19:6 dhe Isa. 61:6. Kjo terminologji tani përdoret për Kishën, popullin e ri të Urdhërimit të Madh të Perëndisë (shih Zbu. 1:6; 20:6; 1 Pjet. 2:5,9). Shih shënimin tek Zbu. 1:6.

▣ **“ata do të mbretërojnë mbi dhe”** Disa përkthyes e shohin këtë si një kohë të ardhshme dhe disa e shohin atë si një realitet të tanishëm. Gjendet një variant i një dorëshkrimi grek midis kohës së ardhme në MSS α, P dhe kohës së tashme në MS A (Alexandrinus). Nëse është kohë e tashme, ajo i ngjason Rom. 5:17 dhe Efes. 2:6. Nëse është kohë e ardhme, ajo me shumë mundësi merret me sundimin e popullit të Perëndisë me Krishtin (shih Mat. 19:28; Luka 22:30; 1 Kor. 4:8; 2 Tim. 2:12; Zbu. 3:21; 5:10). Edhe ky sundim i të ardhmes shihet në dy mënyra.

1. Në Zbu. 20:4, 6 duket se i referohet një sundimi mijëvjeçar
2. Në Zbu. 22:5 duket se i referohet një sundimi të përjetshëm (shih Psa. 145:13; Isa. 9:7; Dan. 2:44; 7:14,18,27)
3. Mijëvjeçari me shumë mundësi është një simbol i përjetësisë

Versioni UBS i Biblës i jep kohës së ardhme një vlerësim “A” (i sigurt).

SPECIAL TOPIC: REIGNING IN THE KINGDOM OF GOD [TEMA TË VEÇANTA: SUNDIMI NË MBRETËRINE E PERËNDISË]

VERSIONI SHQIP: ZBULESA 5:11-14

¹¹ Pastaj pashë, dhe dëgjova zërin e shumë engjëjve përqark fronit, qenieve të gjalla dhe pleqve; dhe numri i tyre ishte dhjetë mijëra dhjetë mijërash dhe mijëra mijërash, ¹² që thoshnin me zë të madh: “I denjë është Qengji që u ther, të marrë fuqinë, dhe pasurinë, dhe diturinë, dhe forcën, dhe nderin, dhe lavdinë, dhe bekimin.” ¹³ Edhe dëgjova çdo krijesë që është në qiell, mbi dhe, nën dhe dhe ato që janë në det dhe gjitha gjërat sa janë në to, që thoshnin: “Atij që rri ulur mbi fron dhe Qengjit i qofshin bekimi, nderi, lavdia dhe forca në shekuj të shekujve.” ¹⁴ Dhe të katër qeniet e gjalla thoshnin: “Amen!” Dhe të njëzet e katër pleq ranë përmbys dhe adhuruan atë që rron në shekuj të shekujve.

5:11 “shumë engjëjve” Ky varg liston tre grupe engjëjsh: (1) shumë engjëj (mijëra e mijëra); (2) krijesa të gjalla (katër) ose (3) pleq (njëzetë e katër).

▣ **“numri i tyre ishte dhjetë mijëra dhjetë mijërash dhe mijëra mijërash”** Ky duket se është një aludim ndaj gjykatës qiellore të Dan. 7:10 (shih shënimin tek Zbu. 5:1).

5:12 “Qengji që u ther, të marrë fuqinë” Ky është një pranim i Birit nga qeniet engjëjlore. “U ther” është një kohë pjesore e përkryer pasive (shih Zbu. 5:6; 13:8), e cila nënkupton “u ther në të shkuarën” me shenjat dhe efektet e therjes ende të dukshme. Kur ne të shohim Jezusin, Ai do të ketë ende shenjat e kryqëzimit. Ato janë bërë distinktivi i tij i nderit! Koncepti i kryqit është i nënkuptuar dhe në qendër të Zbulesës. Shih shënimin tek Zbu. 5:9.

Në këtë varg shtatë attribute i jepen Qengjit sipas rendit engjëjlor:

1. Fuqi
2. Pasuri
3. Urtësi
4. Forcë
5. Nder
6. Lavdi
7. Bekime

Këto attribute mund të vijnë nga 1 Kro. 29:10-12, të cilat gjithashtu mund të jenë burimi i Dhjatës së Vjetër për konkluzionin liturgjik për lutjen e Zotit (lutjen shembullore) tek Mate. 6:13 në traditën e dorëshkrimeve greke. Studimi biblik i NASB (faqe 1855) shton shënimin se veçoritë e Perëndisë fillojnë me tre në Zbu. 4:11, pastaj katër në Zbu. 5:13 dhe në fund me shtatë në Zbu. 5:12 dhe 7:12. Kujtoni se literatura apokaliptike është një zhanër tejet i strukturuar i cili përdor shpesh simbolikën e numrave.

5:13 I gjithë krijimi njerëzor i vetëdijshëm (kori më i madh njerëzor i mundshëm), njerëzit (si të gjallë ashtu edhe të vdekur) në Zbu. 5:13 bekojnë Atin dhe Birin me një bekim të katërfishtë (shih Zbu. 5:14; Psa. 103:19-20; Fili. 2:8-11) dhe urdhëri engjëjlor (katër krijesat e gjalla dhe njëzetë e katër pleqtë) duke rrethuar fronin dhe duke shpallur bekime (shih Zbu. 5:14).

5:14 “Amen” Ky është një pranim nga katër engjëjt e froneve (katër krijesat e gjalla). Shih Tema të Veçanta tek Zbu. 1:6.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studim i udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Si përshtaten kapitujt 4 dhe 5 me qëllimin e përgjithshëm të librit?
2. Cili është zhanri letrar i kapitujve 4 dhe 5?
3. Nga cilat burime e merr Gjoni bazën për pamjet?
4. Kush janë pleqtë?
5. A janë krijesat e përshkruara tek Zbu. 4:7-10 kerubinë apo serafinë?
6. Listo titujt e Dhjatës së Vjetër për Mesian të cilët gjenden në kapitullin 5.
7. Listo përshkrimin e pesëfishtë të vlerës së Mesias të gjendur tek Zbu. 5:9 dhe 10.